

**[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Kodin Penal - neni 328(2), 153 (1) 30 KPPK - mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve; - lëndimi i lehtë trupor - ankesat për ndryshimin e dënimit - rrethanat rënduese / lehtësuese në caktimin e dënimit - gjendja faktike]**

*Prokurori i Qarkut i Prizrenit paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren duke bërë pretendimin ankimor se dënimi i shqiptuar nga Gjykata e Qarkut është tejet i butë. Avokati mbrojtës paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren duke bërë pretendimin ankimor se Gjykata e Qarkut kishte bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe kishte shqiptuar dënim të rëndë kundër të akuzuarit. I pandehuri ishte akuzuar për vepër penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve dhe për lëndim të lehtë trupor dhe u dënua me dënim me burg me kohëzgjatje prej 2 vjet e 6 muaj si dhe me dënime financiare shtesë dhe masa të sigurisë.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e Qarkut gjatë shqiptimit të dënimit të duhur kishte vlerësuar gjendjen faktike si dhe gjendjen ligjore mirëpo kishte konsideruar gabimisht rrethanën rrënduese. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e avokatit mbrojtës është e bazuar dhe ndryshoi aktvendimin e kundërshtuar në pjesën për dënim.*

Ap.nr.1/2005

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Zait Xhemajli, kryetar, Miftar Jasiqi dhe Avdi Dinaj, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesionale Mejreme Memaj, procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarit A. K., nga Vërmica, komuna e Prizrenit, për vepra penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 al.2 të KPPK dhe lëndim i rëndë trupor nga neni 153 al.1 pika 3 të të njëjtit kod, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut Prizren dhe ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit av. Durak Jashari, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prizren, P.nr.156/2004 datë 1.11.2004, në seancën e Kolegjit të mbajtur në kuptim të nenit 410 të KPPK, më 26.04.2005, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Me aprovimin e pjesshëm të ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit A. K., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prizren, P.nr.156/2004, datë 1.11.2004, vetëm përkitazi me vendimin për dënimin ashtu që kjo Gjykatë të

akuzuarit për vepër penale lëndim i rëndë trupor nga neni 154 al.1 pika 3 të KPPK, për të cilin është shpallur fajtor i cakton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj dhe duke e marrë si të vërtetuar dënimin e caktuar për vepër penale nga neni 328 al. 2 të KPPK me 8 (tetë) muaj burgim e gjykon me dënim unik burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjetësh në të cilin do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej 14.07.2004.

Ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut refuzohet si e pabazuar.

## A r s y e t i m i

Gjykata e Qarkut Prizren me aktgjykimin P.nr.156/2004 datë 1.11.2004, të akuzuarin A. K. e ka shpallur fajtor për vepra penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 al. 2 të KPPK dhe lëndim i rëndë trupor nga neni 154 al. 1 pika 3 të KPPK dhe pasi i ka caktuar dënimin veç e veç për çdo njëjërën vepër (8 muaj dhe 24 muaj) e ka gjykuar me dënim unik burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj në të cilin ia ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim prej 14.07.2004 e tutje. Ka shqiptuar masën e sigurisë marrjen e revoles të tipit TT kal. 7,62 mm me nr. serik K-133187 si mjet i kryerjes së veprës penale e njëherit e ka obliguar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së Gjykatës dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 200 €. I dëmtuari Sh. P. për realizimin e kërkesës pronëso- juridike është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afat kanë paraqitur ankesë:

- Prokurori Publik i Qarkut Prizren për shkak të vendimit për dënimin me propozim që Gjykata Supreme ta ndryshojë atë dhe të akuzuarit t'i shqiptoj dënim më të ashpër me burgim dhe

- mbrojtësi i të akuzuarit për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimin mbi dënimin me propozim që Gjykata Supreme ta ndryshojë atë ashtu që të akuzuarit t'i shqiptojë dënim më të butë.

Gjykata Supreme e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me nenin 410 të KPPK në të cilën mbrojtësi i të akuzuarit sqaroi disa pretendime nga ankesa dhe ngeli pranë propozimeve të parashtruara në të, ndërkaq Prokurori Publik i Kosovës me parashtrësën PPA.nr.1/2005 datë 27.01.2005, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut kurse ajo e mbrojtësit të të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar. Për seancën është njoftuar edhe i akuzuari i cili ndodhet në paraburgim.

Gjykata Supreme shqyrtoi shkresat e kësaj çështje penale, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 415 të KPPPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore konstatoi se:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit është pjesërisht e bazuar kurse ajo e Prokurorit Publik të Qarkut është e pabazuar.

Përkritazi me gjendjen faktike në këtë çështje penale, nuk rezulton kontestuese se të dëmtuarit Sh. P. nga Ndërmarrja e Pyjeve në Prizren i ishte dhënë pëlqimi për shfrytëzimin e përkohshëm me qira në tokën pyjore në sipërfaqe prej 0.15 ha në vendin e quajtur "Bregu i bures" ngastrada kadastrale KK Vërmicë nr. i parcelës 1107 me pëlqimin për ndërtimin e objektit montazh në të për kohë të caktuar dhe se në mbështetje të kësaj ai ka ndërmarrë veprime për ndërtimin e objektit të përkohshëm. Mirëpo, duke mos u pajtuar me këtë, me pretendim se pronar i kësaj patundshmërie është i akuzuari A. K. andaj pa pëlqimin e tij i dëmtuari nuk mund ta shfrytëzojë atë dhe as të ndërtojë objekt të përkohshëm në të, më 14.07.2004 ka reaguar dhe me nipin e tij dëshmitarin V. K. për ta penguar në ndërtimin e objektit dhe ndaluar në shfrytëzimin e mëtejme të asaj përcjelljeje kanë shkuar ke i dëmtuari dhe me atë rast në mes ka lindur mospajtim për këtë kontest dhe ka ardhur deri te një konflikt verbal në mes tyre gjatë të cilit i akuzuari ka shtënë me revole të cilën e ka bartur pa leje përkatëse dhe me një predhë e ka goditur të dëmtuarin dhe i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore në pjesët e trupit të përshkruara më për së afërmi me mendimin e ekspertit të mjekësisë ligjor Dr. Cenë Morina datë 18 tetor 2004.

Këtë gjendje faktike, nuk e konteston me ankesë as mbrojtësi i të akuzuarit edhe pse aktgjykimin e kundërshton për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Nga ankesa më shumë rezulton se ankuesi pretendon në shkeljen e ligjit penal, përkatësisht cilësimin juridik të veprës për shkak të gjendjes të afektit mendor që ka vepruar i akuzuari i vënë pa fajin e tij në gjendje të tronditjes së rëndë mendore, prandaj në rastin më të pavolitshëm për të akuzuarin veprimet e tij do të mund të cilësoheshin në veprë penale plagosje e rëndë trupore nga neni 154 par. 6 të KPPK e kurrsesi të veprës penale nga neni 154 al. 1 pika 3 siç gabimisht ka vepruar Gjykata e Shkallës së Parë. Mbrojtësi ankuesi duke iu referuar mbrojtjes së të akuzuarit pretendon se i akuzuari ishte pronar i patundshmërisë në të cilën i dëmtuari kishte filluar të ndërtojë një objekt, prandaj duke e pasur të drejtën mbi atë pasuri bashkë me nipin e tij kanë shkuar ditën kritike ke i dëmtuari për t'ia tërënjekur vërejtjen se nuk mund të ndërtojë objekt në pronën e tij pa e pyet atë dhe pa u marrë vesh në mes veti dhe në vend se i dëmtuari ta respektojë këtë, le që nuk ka pranuar të bisedoj por ka filluar ta shajë dhe fyer më të madhe duke e sjellur në gjendje të tronditjes së rëndë mendore dhe për këtë me atë rast i akuzuari ka vepruar duke shtënë me revole ndaj të dëmtuarit Sh. P. Prandaj, veprimet e tij duhet të cilësohen ndryshe e jo siç gabimisht ka konstatuar Gjykata e Shkallës së Parë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme pretendimet e mësipërme

ankimore nuk qëndrojnë.

Në bazë të fletëposedimit nr. 318 me ZK Vërbnicë vërtetohet se ngastrada kadastrale nr. 1187 me kulturë kullosë klasa IV me sipërfaqe prej 0,91,21 ha në vendin e quajtur "Vërmnica-shkrumëza" evidentohet si pasuri shoqërore OP e Pyltarisë "Sharri" Prishtinë. Prandaj, si pronar i kësaj patundshmërie është Ndërmarrja e Pyjeve në Prizren dhe ajo më 22.05.2001 në bazë të kërkesës me shkrim i ka dhënë pëlqimin për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm një pjesë të kësaj pasurie në sipërfaqe prej 0,15 ha qytetarit Sh. P. nga Vërmnica si dhe pëlqimin për ndërtimin e objektit montazh me kusht që ai për një objekt të tillë të sigurojë dokumentacionin komplet nga KK në Prizren e cila do t'i jepte leje të veçantë për ngritjen e objektit në fjalë.

Nga e gjithë kjo rezulton se i akuzuari pa bazë ka pretenduar kinse si pronar i asaj parcele është ai dhe ia ka kontestuar pa bazë shfrytëzimin e parcelës në fjalë të dëmtuarit dhe ka tentuar ta pengojë në ndërtimin e objektit të përkohshëm kurse i dëmtuari me të drejtë në bisedë me të akuzuarin e ka mbrojtur të drejtën e lejuar të tij. Së këndejmi dalin të pabazuara edhe pretendimet ankimore për kinse të drejtën e të akuzuarit për ta mbrojtur patundshmërinë e vet dhe për ta penguar të dëmtuarin në ndërtimin e objektit në fjalë. Duke mos kontestuar se me të akuzuarin A. kanë shëndrruar disa fjalë mos përputhëse përkritazi me pronën dhe të drejtën për ndërtimin e objektit i dëmtuari Sh. ka mohuar në tërësi se e ka sulmuar në çfarëdo mënyre të akuzuarin apo që e ka shajtur atë apo fyer në ndonjë mënyrë të vrazhdë, prandaj Gjykata Supreme i vlerësoi të pabazuara pretendimet ankimore në drejtim të cilësimit juridik të veprës nga neni 154 par. 6 të KPPK, sepse nga shkresat e lëndës nuk del se i akuzuari është vënë në gjendje të tronditjes së rëndë mendore pa fajin e vet nga sulmi apo fyerjet e rënda nga pala e dëmtuar. Tronditja e rëndë mendore konsiderohet gjendja e jashtëzakonshme psikike, me ç'rast kryerësi pa gjykuar në mënyrë kritike kryen krimin, ngase më parë ka qenë i fyer apo i sulmuar nga viktima. Tronditja në kuptim të kësaj dispozite është ajo që prek thellë ndjenjën e dinjitetit të personit, sulmi dhe fyerja duhet të jenë, sipas mënyrës dhe intensitetit të tilla që mund ta sjellin të akuzuarin në gjendje të tronditjes së fortë, pra jo çdo fjalosje, fyerje apo sulm. Ndërsa nga rrjedha e ngjarjes nuk rezulton se i dëmtuari e ka fyer rëndë apo sulmuar të akuzuarin, përkundrazi i akuzuari ka ardhur në vendin e ngjarjes për ta ndaluar të dëmtuarin në punimet e mëtejme të objektit të përkohshëm në pronën shoqërore që kishte siguruar pëlqimin prej pronarit, fakte këto që shpijnë në përfundim se vetëdija e të akuzuarit nuk ishte e ngushtuar por përkundrazi ishte plotësisht i vetëdijshëm për veprimet e tij.

Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e sipërpërmendura si dhe rrethanat dhe arsyet më detajisht të theksuara në aktgjykimin e shkallës së parë, rezulton si i drejtë dhe i ligjshëm konkludimi i gjykatës së shkallës së parë dhe për aplikimin e ligjit penal kundër të akuzuarit dhe për atë e ka shpallur fajtor për veprën penale nga neni 154 al. 1 pika 3 të KPPK dhe neni 328 al. 2 të

të njëjtit kod.

Duke e vlerësuar aktgjykimin e kundërshtuar përkritazi me vendimin për dënimin, Gjykata Supreme vlerëson se Gjykata e Shkallës së Parë drejt i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese në anën e të akuzuarit, ndërsa sa i takon rrethanave të cilat ajo Gjykatë i ka marrë si rënduese siç janë lëndimet e shkaktuara paraqesin rrezikshmëri që i dëmtuari të humb jetën si dhe numri i gjuajtjeve me revole nuk mund të vlerësohen si rrethana të veçanta rënduese meqenëse rrezikshmëria e veprës dhe të shtënave me armë janë elemente të veprës penale. Prandaj, Gjykata Supreme e ndryshoi aktgjykimin e kundërshtuar përkritazi me vendimin për dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke pasur parasysh edhe faktin se i akuzuari është person në moshë tejet të shtyre dhe se me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i parashikuar me ligj.

Për këtë arsye Gjykata Supreme i vlerësoi të pabazuara pretendimet ankimore të Prokurorit Publik të Qarkut përkritazi me vendimin për dënimin.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 421 part. 1 të KPPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË  
Ap.nr. 1/2005, datë 26.04.2005

Procesmbajtësja,  
Mejreme Memaj

Anëtarët e kolegjit,  
Miftar Jasiqi  
Avdi Dinaj

Kryetari i kolegjit,  
Zait Xhemajli

**[Gjykata Supreme - aktvendim mbi Kodin Penal - neni 244(1) KPPK prodhimi i parave të falsifikuara - ankesë për ndryshimin e dënimit]**

*Avokati mbrojtës paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan duke bërë pretendimin ankimor se Gjykata e Qarkut kishte bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe se kishte shkelur kodin penal. I pandehuri është shpallur fajtor për vepër penale të prodhimit të parave të falsifikuara dhe është dënuar me kohëzgjatje prej 8 muaj burgim si dhe me ndëshkime financiare shtesë. Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e Qarkut gjatë shqiptimit të dënimit të duhur kishte vlerësuar të gjitha rrethanat përkatëse lehtësuese të cilat do të kishin ndikim në kohëzgjatjen e dënimit dhe se dënimi i shqiptuar nga Gjykata e Qarkut është llogaritur në mënyrë të duhur për të arritur qëllimin e dënimit të parashikuar me ligj. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e avokatit mbrojtës është e pabazë.*

Ap.nr.4/2005

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Zait Xhemajli, kryetar, Miftar Jasiqi e Doc.dr. Hamdi Podvorica, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesionale Mejreme Memaj, procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarit A. A., nga Bllanca, komuna e Vitisë, për vepër penale falsifikim i parave nga neni 244 par.1 të KPPK, duke vendosur përkritazi me ankesën e të akuzuarit dhe atë të mbrojtësit të tij av. Bajram Kadriu, të paraqitura kundër aktgjykimin të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr.74/2004 datë 23.07.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur më 19.07.2005, mori këtë

**A K T G J Y K I M**

Refuzohen si të pabazuara ankesa e të akuzuarit A. A. dhe ajo e mbrojtësit të tij kurse aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr.74/2004 datë 23.07.2004, vërtetohet.

**A r s y e t i m i**

Gjykata e Qarkut në Gjilan me aktgjykimin P.nr.74/2004 datë 23.07.2004, të akuzuarin A. A. e ka shpallur fajtor për vepra penale falsifikimi i parave nga neni 244 par. 1 të KPPK dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj, në të cilin ia ka llogaritur edhe paraburgimin prej

24.04.2004 gjer më 23.07.2004. E ka obliguar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së Gjykatës dhe paushallin në shumë prej 50 €.

Kundër këtij aktgjykimi kanë paraqitur ankesë: i akuzuari për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkëljes së ligjit penal me propozim që Gjykata Supreme ta ndryshojë atë ashtu që të akuzuarin ta lirojë nga akuza apo ta ndryshojë përkitazi me cilësimin juridik të veprës duke gjetur se në veprimet e tij përmbushen elementët e veprës penale nga neni 244 par.3 të Kodit Penal në fjalë apo ta prishë dhe lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë për rigjykim dhe mbrojtësi i tij av.Bajram Kadriu për shkak të vendimit për dënimin me propozim që Gjykata Supreme të akuzuarit t'i shqiptojë dënim dukshëm më të butë.

Gjykata Supreme në pajtim me dispozitën e nenit 410 të KPPPK e caktoi seancën e kolegjit në të cilën edhe pse i njoftuar me rregull mbrojtësi i të akuzuarit nuk mori pjesë, kurse për të akuzuarin njoftimi është kthyer me konstatim të dërguesit të postës se i njëjti ndodhet në Gjermani. Prokurori Publik i Kosovës gjithashtu nuk mori pjesë në seancë por me parashtrësën PPA.nr.4/2005 datë 25.01.2005, ka propozuar që ankesat të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme i shqyrtoi shkresat e lëndës, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 415 të KPPPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore konstatoi se ankesat nuk janë të bazuara.

I akuzuari me ankesë pretendon se Gjykata e Shkallës së Parë gabimisht ka vërtetuar se i akuzuari me dashje ka vënë në qarkullim banknotën e falsifikuar në shumë prej 500 € kur të njëjtën ia ka dhënë punëtorit në pompën e benzinës "Fisi Petroll" për ta shërbyer me derivate të naftës meqë ai nuk ka qenë në dijeni se banknota në fjalë është e falsifikuar pasi që të njëjtën e kishte marrë ditë më parë nga personi të cilit ia ka shitur një lopë në tregun e bagëtisë në Ferizaj, prandaj është befasuar kur pronari i pompës në fjalë ia ka kthyer atë dhe i ka treguar se ajo është e falsifikuar prandaj nga frika që e njëjta mund t'i gjindet pastaj e ka mëshëfur përfundi karrigës dhe jo nga shkak se ka deshtë që të njëjtën përsëri ta vejë në qarkullim. Prandaj, meqë mungon dashja në rastin konkret nuk ka as vepër penale siç gabimisht ka vepruar Gjykata e Shkallës së Parë thekson më tutje në ankesë i akuzuari. Sido që të jetë i akuzuari konsideron se në rastin konkret edhe për të merret si e vërtetë se i akuzuari e ka ditë se banknota në fjalë është e falsifikuar dhe e ka vënë në qarkullim të njëjtën si të tillë nuk bëhet fjalë për vepër penale nga neni 244 par.1 të ligjit në fjalë, por mund të bëhet eventualisht fjalë për veprën penale nga paragrafi 3 i nenit në fjalë pasi që aty parashihet që "kushdo që e vë në qarkullim parën e falsifikuar, duke e ditur se para e tillë është e falsifikuar ose ka dijeni për prodhimin a qarkullimin e parave të falsifikuara dhe këtë nuk e lajmëron dënohet me gjobë ose me burgim deri në 1 (një) vit", prandaj edhe po të merrej se i akuzuari ka

ditur se para e tillë është e falsifikuar atëherë gjykata e shkallës së parë ka qenë dashur që të njëjtin ta shpallë fajtor për këtë vepër për të cilën është i paraparë edhe dënim më i butë nga vepra për të cilën gabimisht e ka shpallur fajtor në aktgjykimin e kundërshtuar.

Gjykata Supreme konstaton se këto pretendime ankimore nuk janë të bazuara. Nga këto arsye: i akuzuari pronarit të pompës së benzinës në fjalë ia ka ofruar banknotën prej 500 € për ta shërbyer atë me sasi të karburanteve në vleftë prej rreth 60 €, mirëpo menjëherë kur shërbyesi në pompën e benzinës ka vërejtur se banknota në fjalë është e falsifikuar ai në vend që të kërkojë falje prej tij apo sikur të qëndronte ajo se nuk e ka ditur se banknota është e falsifikuar të kërkojë që të sqarohet me të njëjtin para organeve kompetente-policore ai banknotën e ka futur në ulësen e automobilit dhe ka vazhduar qarkullimin së bashku me vëllain e tij kur është zënë nga patrulla e policisë çka vetvetiu tregon se parën e falsifikuar e ka vënë në qarkullim duke ditë më parë që ajo është e falsifikuar, prandaj me të drejtë Gjykata e Shkallës së Parë veprimet e këtylla të të akuzuarit i ka cilësuar si vepër penale nga neni 244 par.1 të KPPPK, kështu që pretendimet ankimore të mbrojtësit janë të pabazuara edhe përkitazi me shkeljen e ligjit penal në dëm të të akuzuarit.

Duke e vlerësuar aktgjykimin e shkallës së parë përkitazi me vendimin për dënimin Gjykata Supreme konstaton se Gjykata e Shkallës së Parë drejt i ka vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin e lartësisë së dënimit dhe i ka peshuar ato kur të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve. Në ankesa të parashtruara nuk potencohet ndonjë rrethanë tjetër e posaçme lehtësuese e cila kishte për të ndikuar që të akuzuarit t'i shqiptohet ndonjë dënim më i butë prandaj i refuzoi ankesat si të pabazuara edhe në këtë drejtim dhe konstatoi se dënimin i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe përgjegjësinë penale të të akuzuarit me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me ligj.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 423 të KPPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Ap.nr. 4/2005, datë 19.07.2005

Procesmbajtësja,  
Majr. MemajAnëtarët e kolegjit,  
Miftar Jasiqi  
Doc.dr.Hamdi PodvoricaKryetari i kolegjit,  
Zait Xhemajli

**[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Kodin Penal- neni 328 (2) KPPK mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paaautorizuar të armëve - ankesa për ndryshimin e dënimit - rrethanat lehtësuese në caktimin e dënimit]**

*Prokurori i Qarkut i Mitrovicës paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë duke bërë pretendimin ankimor se dënimi i Gjykatës së Qarkut ishte tejet i butë për shkak se kishte zmadhuar rrethanat lehtësuese duke mos konsideruar rrezikun e rëndë public që shkaktohet nga vepra penale siç parashihet me nenin 41 të LPJ-së. I pandehuri ishte i akuzuar për veprë penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paaautorizuar të armëve dhe ishte dënuar me gjobë prej 600 euro, si dhe me dënime financiare shtesë dhe të sigurisë. Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e Qarkut gjatë shqiptimit të dënimit të duhur kishte marrë parasysh si rrethanat rënduese ashtu edhe ato lehtësuese dhe se dënimi i Gjykatës së Qarkut është llogaritur në mënyrë të duhur për të arritur qëllimin e dënimit të parashikuar me ligj. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e Prokurorit të Qarkut është e pabazë.*

Ap.nr.16/2005

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Zait Xhemajli, kryetar, Miftar Jasiqi dhe Avdi Dinaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Drita Rexhaj, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit G. N. nga fsh. Gllanasellë komuna e Skenderaj, për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim, ose në shfrytëzim të paaautorizuar të armëve, parashikuar me nenin 328 par.2 të KPPK, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut në Mitrovicë, të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut Mitrovicë, P.nr.74/2001 datë 18.11.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur më 17.5.2005, mori këtë

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Mitrovicë, kurse aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Mitrovicë, P.nr.74/2001 datë 18.11.2004, vërtetohet.

**A r s y e t i m i**

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, me aktgjykimin P.nr.74/2001 datë 18.11.2004, të akuzuarin G. N. e ka shpallur fajtor për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim, ose në shfrytëzim të paaautorizuar të armëve, parashikuar me nenin 328 par. 2 të KPPK, dhe e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) €, të cilën obligohet ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit, me kërcënimin se, në rast të mos pagesës së këtij dënimi në afatin e përmendur, ky do të shndërrohet në dënim burgu, duke ia llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) € për 1 (një) ditë burgim. E ka detyruar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës dhe, në emër të paushallit gjyqësor, shumë prej 70 €. Ndaj të akuzuarit ka shqiptuar masën e sigurisë konfiskimin e revoles "Cërvena Zastava" e kalibrit 7,62 mm, nr. serik 148230 dhe 1 karikatorë me 2 copë fishekë.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka ushtruar Prokurori Publik i Qarkut në Mitrovicë, për shkak të vendimit për dënimin, me propozim që Gjykata Supreme aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë, ashtu që të akuzuarin, për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, ta gjykojë me një dënim më të rëndë.

Prokurori Publik i Kosovës, me shkresën PPA.nr. 16/2005 datë 28.1.2005, propozoi që ankesa e paraqitur të pranohet si e bazuar.

Gjykata Supreme shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 376 par.1 të Ligjit të Procedurës Penale (LPP) dhe, pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në ankesë, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Meqenëse aktgjykimi i kundërshtuar, nuk përmban shkelje qenësore të dispozitave të procedurës penale, e as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit për të cilat Gjykata Supreme në përputhje me dispozitat e nenit 376 të LPP-së kujdeset detyrimisht, edhe pse aktgjykimi nuk kundërshtohet në atë drejtim, e po ashtu edhe gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë, kjo Gjykatë u kufizua vetëm në vlersimin e pretendimeve ankimore përkitazi me vendimin për dënimin.

Në ankesën e vet Prokurori Publik i Qarkut thekson se gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit, nuk i ka vlerësuar të gjitha rrethanat e parapara në nenin 41 të LPJ, si pasojë e së cilës në aktgjykimin e goditur ndaj të akuzuarit G. N. ka shqiptuar dënim tejet të butë tu e marr parasysh peshën e veprës penale që i vihet në barrë të akuzuarit. Rrethanat lehtësuese të cilat janë cek në arsyetimin e aktgjyqimit qëndrojnë por ato nuk janë të natyrës veçanërisht lehtësuese të cilat kishin me arsyetua shqiptimin e një dënimi tejet

të butë, siç është dënimi me gjobë sepse veprat penale, siç është kjo për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, paraqesin një shkallë të lartë të rrezikshmërisë shoqërore, janë në rritje e sipër dhe se i akuzuari ka qenë në dijeni për amnisti, por me gjithë atë armën nuk e ka dorëzuar, Prokurori konsideron se me një dënim të tillë të shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë nuk do të mund të pritej arritja e qëllimit të dënimit për të ndikuar tek i akuzuari që të mos kryejë ndonjë veprë penale të re, prandaj këtij t'i shqiptohet një dënim më i rëndë.

Duke vlerësuar këto pretendime, Gjykata Supreme gjen se gjykata e Shkallës së Parë me rastin e shqiptimit të dënimit, ndaj të akzuarit G. N. në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse i ka vlerësuar të gjitha rrethanat që parashihen me dispozitën e nenit 41 të LPJ-së, për të cilat ka dhënë arsye, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë.

Kësisoj, si rrethana lehtësuese, Gjykata e Shkallës së Parë ka pas parasysh faktin se i akuzuari është njeri familjar, më parë nuk ka qenë i gjykuar, e as që ndaj tij zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale, si dhe sinqeriteti i tij para Gjykatës, ndërsa si rrethana rënduese ka marr rrezikshmërinë shoqërore të veprës dhe se veprat e tilla janë në rritje e sipër. Prandaj, sa u përket rrethanave rënduese të theksuara në ankesën e Prokurorit, kjo Gjykatë konsideron se nuk janë të asaj natyre dhe të asaj shkalle që do të ndikonin në ashpërsimin e dënimit ndaj të akzuarit, sepse rrezikshmëria shoqërore e veprës penale nuk është rrethanë rënduese, por është element qenësor i veprës penale. Andaj, në mungesë të ndonjë rrethane tjetër veçanërisht rënduese e cila nuk parashtrohet në ankesë, vendimi për dënimin edhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe përgjegjësisë penale të akzuarit dhe do të mund të pritej se edhe me këtë lloj dënimi do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i parashikuar me ligj.

Nga çka u tha më lart dhe në përputhje me dispozitat e nenit 384 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË  
Ap.nr. 16/2005, datë 17.5.2005

Procesmbajtësja,  
Drita Rexhaja

Kryetari i kolegjit,  
Zait Xhemajli

**[ Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Kodin Penal, Kodi i Procedurës Penale - neni 317 (2), (1), 23, 316 (1) KPPK - sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së personit zyrtar - ankesë për prishjen e aktgjykimit / ndryshimin e vendimit për dënim - dispozitat e KPK - gjendja ligjore dhe faktike, rrethanat lehtësuese - neni 364 (1) 11), 376, 365 (1) 4); 184 (2), (1), 183 (1) cck; 41 LPJ; 5, 33 LPJ]**

*Avokati mbrojtës i të akzuarit paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë duke bërë pretendimin ankimor se Gjykata e Qarkut në aktvendimin kishte shkelur dispozitat në fuqi të kodit penal dhe të kodit të procedurës penale dhe se kishte bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Të pandehurit ishin akuzuar për veprë penale të sulmit dhe pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare dhe ishin dënuar me dënim me burg me kohëzgjatje të ndryshme si dhe me dënime financiare shitesë. Gjykata Supreme ka vendosur se aktvendimi i Gjykatës së Qarkut është në pajtim me dispozitat e KPK-së dhe se Gjykata kishte vlerësuar në mënyrë të duhur gjendjen faktike dhe se kishte gjetur të gjitha rrethanat lehtësuese dhe se dënimi i Gjykatës së Qarkut ishte llogaritur në mënyrë të duhur për të arritur qëllimin e dënimit të parashikuar me ligj. Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e Qarkut ka vlerësuar gabimisht gjendjen ligjore dhe ka shkelur dispozitat e zbatueshme të KPP-së për shkak se Gjykata e Qarkut nuk ka zbatuar ligjin në të favorshëm për të akzuarin siç parashihet me nenin 2 (2) të KPPK-së dhe ndryshoi aktgjykimin e kundërshtuar në cilësimin juridik të veprës penale. Prandaj, Gjykata Supreme vendosi se ankesa e avokatit mbrojtës është e pabazë.*

Ap.nr.23/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegj i përbërë nga gjyqtarët: Riza Loci, kryetar, Gjuran Dema dhe Avdi Dinaj, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesionalë Mejreme Memaj, procesmbajtëse, në lëndën penale të akzuarve D., A. e M. S. dhe S. Z., për veprën penale sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare në bashkëkryerje, parashikuar nga neni 317 al.2 lidhur me al.1 dhe nenin 23 të KPPK, dhe të akzuarit B. S.i, për veprën penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, parashikuar nga neni 316 al.1 të KPPK, përkritazi me ankesën e mbrojtësit të të akzuarve, avokatit Ramiz Krasniqi nga Prishtina, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prishtinë, P.nr.656/2003 datë 31.05.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur në kuptim të dispozitës së nenit 371 të LPP, më datë 15.3.2005, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Me rastin e ankesës së mbrojtësit të të akuzuarve D. S., A. S., M. S. e B. S. dhe S. Z. dhe sipas detyrës zyrtare, aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prishtinë, P.nr.656/2003, datë 31.05.2004, ndryshohet në dispozitivin nën i vetëm përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale, ashtu që Gjykata Supreme veprimet e të akuzuarve D. S., A. S., M. S. e S. Z., juridikisht i cilëson vepër penale sulm ndaj personit zyrtar në kryerjen e punëve të sigurimit në bashkëekzekutim, parashikuar nga neni 184 al. 2 lidhur me al.1 të LPK dhe nenin 22 të LPJ, kurse veprimet e të akuzuarit B. S. vepër penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare, parashikuar nga neni 183 al.1 të LPK.

Ankesa e mbrojtësit të të akuzuarve D. S., A. S., M. S. e B. S. dhe S. Z., refuzohet si e pabazuar.

## A r s y e t i m i

Me dispozitivin I të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prishtinë, P.nr.656/2003 datë 31.5.2004, janë shpallur fajtorë: i akuzuari D. S. (për veprën penale sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare në bashkëveprim, parashikuar nga neni 317 al.2 lidhur me al.1 të KPPK dhe nenin 23 të KPPK dhe me dispozitivin II, dhe për veprën penale mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 al. 1 të KPPK; të akuzuarit A. e M. S. dhe S. Z., për veprën penale sulm kundër personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare në bashkëveprim, parashikuar nga neni 317 al.2 lidhur me al.1 dhe nenin 23 të KPPK, ndërsa i akuzuari B. S. për veprën penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare, parashikuar nga neni 316 al.1 të KPPK. Të akuzuarit D. S., për veprën penale të përshkruar në dispozitivin nën I, i është caktuar dënimi me 1 (një) vit e 2 (dy) muaj burgim, kurse për veprën penale të përshkruar në dispozitivin nën II, i është caktuar dënim me 6 (gjashtë) muaj burgim dhe është gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 24.9.2003 e tutje. I akuzuari A. S. është dënuar me 10 (dhjetë) muaj burgim, në të cilin i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 6.10.2003 e tutje. I akuzuari M. S. është dënuar me 4 (katër) muaj burgim, kurse i akuzuari B. S. me 3 (tre) muaj burgim, në të cilin u është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 16.5.2003 deri më datë 5.6.2003, ndërkaq i akuzuari S. Z. është dënuar me 4 (katër) muaj burgim. Të akuzuarit janë detyruar që t'i paguajnë solidarisht shpenzimet e procedurës penale dhe secili veç e veç shumën prej nga 100 € në emër të paushallit gjyqësor, në afat prej 15 ditësh, pasi aktgjykimi të marrë formë të prerë.

Kundër këtij aktgjykimi mbrojtësi i të akuzuarve ka paraqitur ankesë në afat ligjor, për shkak të: shkelje qenësore të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që aktgjykimi i goditur të prishet dhe çështja t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim ose të ndryshohet në pikpamje të vendimit për dënim ashtu që të akuzuarve t'u zbuten dënimet e shqiptuara, ndërsa përkitazi me të akuzuarin M. S. aktgjykimi të ndryshohet dhe ai, në mungesë të provave, të lirohet nga akuza ose përkitazi me të aktgjykimi të ndryshohet në pikpamje të vendimit për dënimin, ashtu që t'i shqiptohet gjykim me kusht.

Në ankesë ka propozuar që në kuptim të nenit 317 al.1 të LPP, për seancën të njoftohen ai dhe i akuzuari M. S..

Në seancë mbrojtësi i të akuzuarit pasi sqaroi disa nga pretendimet ankimore, qëndroi në propozimet e bëra në ankesë, kurse i akuzuari M. S. në tërësi pranoi mbrojtjen e mbrojtësit të tij.

- Prokurori Publik i Kosovës, me parashtresën PPA.nr.23/2005 datë 17.2.2005, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarve të refuzohet si e pabazuar. Në seancë nuk mori pjesë edhe pse është njoftuar me rregull.

Gjykata Supreme i shqyrtoi shkresat e lëndës së bashku me aktgjykimin e goditur, të cilin e studioi në kuptim të dispozitës nga neni 376 të LPP dhe, pasi vlerësoi pretendimet ankimore, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i goditur përmban shkelje qenësore të dispozitave të procedurës penale, parashikuar nga neni 364 al.1 pika 11 të LPP.

Dispozitivi i aktgjykimit të goditur është i kuptueshëm. Përshkrimi faktik i veprës penale në dispozitivin nën I i përmban të gjitha veprimet inkriminuese të secilit nga të akuzuarit veç e veç, kurse fakti se veprimet e të akuzuarve D., A. e M. S. dhe S. Z. janë paraqitur në një dispozitiv të bashku me veprimet inkriminuese të të akuzuarit B. S., nuk paraqet shkelje qenësore të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të ndikonin në prishjen e aktgjykimit, për shkak se dispozitivi përmban përshkrimin faktik si për veprën penale sulm ndaj personit zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, ashtu edhe për veprën penale pengim i personit zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare. Aktgjykimi i goditur nuk përmban as shkelje qenësore të dispozitivave të procedurës penale, të cilat kjo Gjykatë, në kuptim të nenit 376 të LPP, i vëren detyrimisht.

Pa bazë pretendohet se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë

gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë.

Me provat e nxjerra në seancën kryesore, sidomos nga deklaratat e dëshmitarëve S. S., M. P. e Q. J., ekspertiza mjekoligjore për të dëmtuarin dëshmitarin S. dhe vështrimi i fotodokumentacionit, Gjykata e Shkallës së Parë ka ardhur në përfundimin e drejtë se ditën kritike, kur dëshmitarët S., M. e Q., në cilësi të personave zyrtarë, si policë të SHPK-ës, kanë ardhur në oborrin e të akuzuarit M. me qëllim që ta legjitimonin të akuzuarin D., për shkak se dyshohej se ai ishte involvuar në kryerjen e një veprë penale, i akuzuari D. jo vetëm që ka refuzuar të identifikohet, por e sulmon fizikisht policin S., me ç'rast i shkakton lëndim të lehtë trupor në formë të gërvishtjeve dhe kafshimit të dorës, lëndime këto më hollësisht të paraqitura në ekspertizën mjekoligjore, pasatj arin t'ia nxjerrë revolen zyrtare dhe të largohet nga vendi i ngjarjes. Me këtë rast të akuzuarit A. dhe M. S. dhe S. Ze. i kanë sharë dhe ofenduar dëshmitarët S., M. dhe Q. e pastaj e kanë sulmuar dëshmitarin S. me grusht në shpinë dhe e kanë shtyrë dëshmitarin Q., ndërsa i akuzuari A. këtij dëshmitari edhe i është kërcënuar, ndërkaq i akuzuari B. S. i ka shtyrë policët dhe i ka penguar në kryerjen e detyrës zyrtare.

Pretendimet ankimore se i akuzuari M. S. ditën kritike nuk ka ndërmarrë asnjë veprim inkriminues, janë të pabazuara. Gjykata e Shkallës së Parë, duke analizuar deklaratën e dëshmitarit S. dhe fotodokumentacionin dhe duke i vlerësuar këto prova, me të drejtë ka ardhur në përfundim të saktë se i akuzuari M., ditën kritike, derisa i akuzuari D. po kacafytej me policët, ai dëshmitarit S. i është hedhur në shpinë dhe e ka goditur me grushte.

Duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, kjo Gjykatë gjen se ligji penal me aktgjykimin e goditur është zbatuar në mënyrë të gabuar, respektivisht aktgjykimi i goditur në dispozitivin nën I përmban shkelje të ligjit penal në kuptim të dispozitës nga neni 365 al.1 pika 4 e LPP, sepse me të është zbatuar ligji që nuk ka mundur të zbatohet, prandaj aktgjykimi i gjykatës së shkallës së bë për shkak se kjo Gjykatë, në kuptim të dispozitës së nenit 2 al.2 të KPPK, ka zbatuar ligjin më të favorshëm për të akuzuarit, sepse vepra penale sulm kundër personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, parashikuar nga neni 317 al.2 lidhur me al.1 të KPPK, për të cilin janë shpallur fajtorë me aktgjykimin e goditur të akuzuarit D., A. e M. S. dhe S. Z., parashikon dënim burgimi prej 6 (gjashtë) muaj deri në 5 (pesë) vjet, kurse për veprën penale sulm ndaj personit zyrtar në kryerjen e punëve të sigurimit nga neni 184 al.2 lidhur me al.1 të LPK, parashikohet dënimi me burgim prej 3 (tre) muaj deri në 5 (pesë) vjet, ndërkaq për veprën penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare, parashikuar nga neni 316 al.1 të KPPK për të cilën është shpallur fajtor B. S., parashikohet dënim me burgim prej 3 (tre) muaj deri në 3 (tri) vjet, kurse për veprën penale pengimi i personit zyrtarë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, parashikuar nga neni 183 al.1 të LPK, parashikohet dënimi me

burgim në kohëzgjatje deri në 3 (tri) vjet, që nënkupton se dispozitat e përmendura nga Ligji Penal i Kosovës, i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprave penale nga ana e të akuzuarve, janë më të favorshme për ta, krahasuar me dispozitat ligjore, sipas të cilave janë shpallur fajtorë ata me aktgjykimin e goditur.

Aktgjykimi i shkallës së parë goditet pa bazë për vendimin për dënimin, i cili pretendohet se është i lartë.

Me rastin e matjes së dënimit, të akuzuarve u janë njohur rrethanat lehtësuese dhe rënduese në pajtim me nenin 41 të LPJ. Pretendimet ankimore se qëllimi i dënimit ndaj të akuzuarit M. S. mund të arrihet edhe me gjykim të kushtëzuar, për shkak se ai është veteran i arsimit, se është i moshës relativisht të vjetër dhe se është në gjendje të dobët shëndetësore, janë të pabazuara. Vepra penale për të cilën janë shpallur fajtorë të akuzuarit përmban rrezikshmëri të lartë shoqërore, ndërsa pretendimet ankimore se i akuzuari M. është në gjendje të dobët shëndetësore nuk provohen me asnjë provë, ashtu siç nuk provohen propozimet ankimore për shqiptim të dënimeve më të buta ndaj të akuzuarve tjerë.

Kjo Gjykatë gjen se vendimi për dënimet e shqiptuara me aktgjykimin e goditur është i drejtë dhe në përputhje me rrezikshmërinë shoqërore dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve dhe mund të pritet se me to do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të dispozitës së nenit 5 dhe 33 të LPJ, i zbatueshëm sipas me Rregullores së UNMIK-ut.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të dispozitës së nenit 387 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË  
Ap.nr. 23/2005, datë 15.3.2005

Procesmbajtësja  
Mejreme Memaj

Kryetari i kolegjit,  
Riza Loci

**[Gjykata Supreme - aktvendim mbi Kodin Penal - neni 328 (2) KPPK/ neni 153 (2) KPPK/ neni 154 (1) KPPK/ neni 23 KPPK - mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve - shkaktimi i lëndimit të lehtë trupor - shkaktimi i lëndimit të rëndë trupor në bashkëpjesëmarrje - ankesë për ndryshimin e dënimit shkelja e Kodit Penal - neni 423 KPPK]**

*Avokatët mbrojtës paraqitën ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren duke bërë pretendimin ankimor se Gjykata e Qarkut në vendimin e vet kishte shkelur dispozitat e kodit penal dhe se kishte bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.*

*I pandehuri S.L. ishte akuzuar për veprë penale të pronësisë, kontrollit, posedimit, dhe shfrytëzimit të paautorizuar të armëve dhe shkaktimit të lëndimit të lehtë trupor dhe ishte dënuar me tre muaj burgim si dhe me ndëshkime financiare shtesë dhe me masa të sigurisë. Të pandehurit S.K. dhe M.M. ishin akuzuar për veprë penale të shkaktimit të lëndimit të rëndë trupor të kryer në bashkëpjesëmarrje dhe ishin shpallur fajtor, ku S.K. ishte dënuar me dënim prej 3 muaj burgim ndërsa M.M. me 2 muaj burgim si dhe me ndëshkime financiare shtesë dhe me masa të sigurisë.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë dhe në kundërshtim me vetvetën dhe gjithashtu nuk ofron fakte të mjaftueshme për faktet vendimtare dhe edhe ato pak arsye të cilat janë dhënë janë të paqarta. Prandaj, Gjykata Supreme vendosi se ankesa e avokatit mbrojtës është e bazuar, prishi aktvendimin e Gjykatës së Qarkut dhe ktheu lëndën Gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.*

Ap.nr.24/2005

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtari: Miftar Jasiqi, kryetar, Zait Xhemajli dhe Avdi Dinaj, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional: Ali Hajdini, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve: S. L. nga fsh. Brrutë KK Dragash, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPPK-së dhe veprës penale lëndime të lehta trupore nga neni 153 par.2 të KPPK-së, kurse të akuzuarit S. K. nga fsh. Kosavë KK Dragash dhe M. M. nga fsh. Bresanë KK Dragash, për shkak të veprës penale lëndime të rënda trupore në bashkëkryerje nga neni 154 par.1 nën par.4, lidhur me nenin 23 të KPPK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit S. L., av.Masar Pirana nga Prizreni dhe ankesës së

përbashkët të të akuzuarve S. K. dhe M. M., të paraqitur përmes av.Ruzhdi Berisha nga Prizreni, e të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Pnr.122/2004 të datës 17.9.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.03.2005, mori këtë:

## A K T V E N D I M

Me aprovimin e ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit S. L. dhe ankesës së të akuzuarve S. K. dhe M. M., prishet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, Pnr.122/2004 i datës 17.09.2004 dhe lënda i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë në rigjykim.

## A r s y e t i m i

Gjykata e Qarkut në Prizren me aktgjykimin Pnr.122/2004 të datës 17.09.2004, të akuzuarin S. L. e ka shpallur fajtor për veprën penale, mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPPK-së dhe e ka gjykuar, për veprën penale të dispozitivit nën I të aktgjykimit dënimit me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj dhe për veprën penale të dispozitivit nën II të aktgjykimit dënimit me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj, ashtu që i ka vërtetuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, kurse të akuzuarit S. K. dhe M. M. i ka shpallur fajtor për veprën penale lëndime të rënda trupore në bashkëkryerje nga neni 154 par.1 nën par.4, lidhur me nenin 23 të KPPK-së dhe i ka gjykuar, të akuzuarin S. K. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, ndërsa të akuzuarin M. M. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj.

Të akuzuarit janë obliguar që të paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së Gjykatës, kurse në emër të paushallit gjyqësor shumë prej nga 50 euro, secili veç e veç, të gjitha në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 328 par.5 lidhur me nenin 60 par.3 të KPPK-së, ndaj të akuzuarit S. L. është shqiptuar dënimi plotësues marja e obligueshme e thikës si mjet për kryerjen e veprës penale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesa kanë ushtruar:

- Mbrojtësi i të akuzuarit S. L., av.Masar Pirana, për shkak të shkeljes qenësore të dispozitave të procedurës penale për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të shklejes së ligjit penal dhe për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata Supreme aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë dhe të akuzuarin S. L. ta liroi nga akuza për të dy veprat penale ose të njëjtin ta prishë dhe çështjen t'ia kthejë Gjykatës së Shkallës së Parë në rigjykim.

- Të akuzuarit S. K. dhe M. M. përmes av.Ruzhdi Berisha, për shkak të shkeljes qenësore të dispozitave të procedurës penale, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të shklejes së ligjit penal dhe për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata Supreme aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë ashtu që të akuzuarit S. K. dhe M. M. t'i liroi nga akuza ose të njëjtin ta prishë dhe çështjen t'ia kthejë Gjykatës së Shkallës së Parë në rigjykim.

Konform dispozitës së nenit 475 të KPPPK-së ka kërkuar që të akuzuarit dhe mbrojtësi të njoftohen për seancën e kolegjit.

Gjykata Supreme, duke vepruar sipas kërkesës, konform dispozitës së nenit 410 të KPPPK-së, mbajti seancën e kolegjit në të cilën u ftuan, të akuzuarit S. K., M. M. dhe S. L. si dhe mbrojtësi i tij, av.Masar Pirana. Në seancë të kolegjit prezantuan i akuzuari S. L. dhe mbrojtësi i tij, av.Masar Pirana, kurse të akuzuarit S. K. dhe M. M. edhe pse të ftuar me rregull nuk prezantuan në seancë.

Në seancën e kolegjit mbrojtësi i të akuzuarit S. L., av.Masar Pirana, pasi sqaroi disa nga pretendimet ankimore, ngeli në tërësi pranë propozimeve të paraqitura në ankesë, kurse i akuzuari S. L. e përkrahi mbrojtjen e mbrojtësit të tij.

Në seancë nuk mori pjesë as Prokurori Publik i Kosovës, por i njëjti me parashtrësën me shkrim, PPA.nr.24/2005 të datës 02.02.2005, ka propozuar që ankesa e të akuzuarve S. K. dhe M. M. dhe ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit S. L., av.Masar Pirana të refuzohen si të pabazuara, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata Supreme i shqyrtoi shkresat e lëndës së bashku me aktgjykimin e ankimuar në kuptim të dispozitave të nenit 415 të KPPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se:

Ankesat janë të bazuara.

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit S. L., av.Masar Pirana dhe të akuzuarit S. K. dhe M. M.i, pretendojnë se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje qenësore të dispozitave të procedurës penale nga neni 403 par.1 pika 12 të KPPPK-së, nga se dispozitivi i tij është i pakuptueshëm, kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin dhe se nuk përmban arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare. Në të vërtetë sipas mbrojtësit, av.Masar Pirana

dispozitivi nën I i aktgjykimit të ankimuar është në kundërshtim me arsyetimin. Ndërsa të akuzuarit S. K. dhe M. M. pretendojnë se dispozitivi nën II dhe nën III i aktgjykimit të ankimuar është i pakuptueshëm dhe kundërthënës në mes veti, sepse nga përshkrimi faktik i veprës penale në dispozitivin nën II dhe nën III të aktgjykimit të ankimuar del se fjala është për të njëjtin ngjarje. Prandaj, sipas të akuzuarve në dispozitivin nën II të aktgjykimit të ankimuar, lidhur me të akuzuarin S. L. thuhet se: "... i del përpara S. K., i cili ishte në shoqëri me M. M. dhe gjatë përlëshjes ... e ka goditur të akuzuarin S. ...". Në kundërshtim me këtë, në dispozitivin nën III të aktgjykimit thuhet se: "... të akuzuarit S. K. dhe M. M., gjatë një përlëshje me të akuzuarin S. L., rëndë e kanë lënduar të njëjtin ...". Andaj nga dispozitivi nuk mund të kuptohet se kush ka sulmuar e kush ka vepruar në mbrojtjen e vetes ose në mbrojtjen e tjetrit. I pa kuptueshëm është edhe dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar, që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës penale, sepse nga kjo pjesë e dispozitivit nuk mund të kuptohet se cili nga të akuzuarit detyrohet për pagimin e shpenzimeve të procedurës penale, apo të gjithë të akuzuarit për këtë detyrohen solidarisht.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje qenësore të dispozitave të procedurës penale nga neni 403 par.1 pika 12 e KPPPK-së, sepse dispozitivi i tij është i pa kuptueshëm, në kundërshtim me vetveten dhe me arsyetimin e aktgjykimit dhe nuk përmban arsye lidhur me faktet vendimtare edhe ato arsye të pakta të dhëna, janë krejtësisht të paqarta, shkelje këto që aktgjykimin e bëjnë të pa qëndrueshëm. Në të vërtetë nga dispozitivi i aktgjykimit, si nga dispozitivi nën II ashtu edhe nga ai nën III i aktgjykimit, nuk mund të kuptohet se cili i akuzuar ka vepruar në sulm e cili në mbrojtje, kurse dispozitivi nën II i aktgjykimit të ankimuar është në kundërshtim me arsyetimin, nga se në të thuhet se i akuzuari S. L., ditën kritike i doli përpara të akuzuarit S. K. i cili ishte në shoqëri me M. M. dhe gjatë përlëshjes me anën e mprehtë të një brisiku dhe me grushta e ka goditur të akuzuarin S., ndërsa nga arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar del se ditën kritike i akuzuari M. e ka goditur me thikë të akuzuarin S. L.. Poashtu aktgjykimi i ankimuar nuk përmban arsye lidhur me faktet vendimtare, kështu ai nuk përmban arsyet lidhur me faktin relevant se me çfarë mjeti u krye vepra penale e lëndimit të rëndë dhe e lëndimit të lehtë trupor, pastaj edhe ato arsye që përmban ato janë plotësisht të paqarta dhe të pa kuptueshme, andaj pretendimet ankimore në këtë drejtim në tërësi janë të bazuara.

Mbrojtësi i të akuzuarit S. L., av.Masar Pirana, pretendon se Gjykata e Shkallës së Parë, në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë e ka vërtetuar edhe gjendjen faktike, sepse nuk ka prova se bomba e dorës ka qenë pronë e të akuzuarit S. L., por të njëjtin ai e mori nga vendi i ngjarjes me qëllim që t'i shmanget ndonjë fatkeqësie më të madhe dhe se bombën e dorës policia e gjeti pasi ai i tregoi policisë se në shtëpinë e tij gjendet një bombë dore të cilën e ka gjetur në vendin e ngjarjes. Poashtu sipas mbrojtësit të të akuzuarit S. L., ai ditën kritike ka qenë i përcjellur nga S. K. dhe M. M. dhe më pastaj ka qenë

edhe i sulmuar nga ata dhe nga personi me emrin H. N., ndërsa brisku i cili është prezantuar në seancë kryesore nuk është i tij dhe se ai ka qenë i pa armatosur, andaj në këtë rast i akuzuari S. L. ka qenë në mbrojtje të nevojshme dhe për këtë shkak ai është dashtë të lirohet nga akuza. Ndërkaq, sipas të akuzuarve S. K. dhe M. M., gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, sepse në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike e ka vërtetuar vetëm në bazë të

Deklaratave të të akuzuarve pa dhënë ndonjë vlerësim dhe analizë të fakteve vendimtare të vërtetuara, saktësia e të cilave mbështetet vetëm në përshkrimin e deklaratave të të akuzuarve. Andaj, këtu edhe qëndron vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, Gjykata e Shkallës së Parë me provat e administruara, në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë e ka vërtetuar edhe gjendjen faktike, sepse si nga dispozitivi nën I, II dhe nën III të aktgjykimit ashtu edhe nga arsyetimi i tij, nuk mund të kuptohet se në rastin konkret kush ishte sulmues e kush ka vepruar në mbrojtje, kështu që në aktgjykimin e ankimuar ekziston dualiteti në kuptimin e fakteve vendimtare të vërtetuara. Poashtu ekziston dyshimi edhe lidhur me saktësinë e faktit vendimtar, se në rastin konkret a është shkaktuar lëndimi i rëndë ose i lehtë trupor me thikë apo me brisk, dyshim ky që për Gjykatën Supreme faktin e tillë e bën të pa qenë. Poashtu në aktgjykimin e ankimuar nuk është vërtetuar as fakti vendimtar se, bombën e dorës a e gjeti i akuzuari S. në vendin e ngjarjes apo atë ai e kishte poseduar edhe më herët, të cilën e gjeti policia pas një bastisje që bëri në shtëpinë e tij. Së fundit Gjykata e Shkallës së Parë e ka vërtetuar gjendjen faktike duke i përshkruar deklaratat e të akuzuarve pa dhënë ndonjë vlerësim dhe analizë të provave të administruara, se për çfarë arsyesh e ka marrë si të provuar një fakt. Prandaj, pretendimet ankimore në këtë drejtim poashtu janë të bazuara.

Si rezultat i gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë, aktgjykimi i ankimuar përmban edhe shkelje të ligjit penal. Siç rezulton nga arsyetimi i aktgjykimit dhe nga shkresat e lëndës, në këtë rast nuk mund të kuptohet si cili i akuzuar cilat veprime inkriminuese i ka realizuar për të cilat është shpallur fajtor. Prandaj, përfundimet e Gjykatës së Shkallës së Parë në aktgjykimin e ankimuar lidhur me aplikimin e ligjit penal nuk mund të qëndrojnë, kështu që edhe pretendimet ankimore në këtë drejtim janë plotësisht të bazuara.

Gjykata e Shkallës së Parë duhet që në rigjykim edhe një herë t'i administroi të gjitha provat, secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku, të vlerësoi mbrojtjen e të akuzuarve, e veçanërisht në mënyrë të kurtë të përshkruajë veprimet inkriminuese të secilit prej të akuzuarve, duke

përshkruar saktësisht se cili prej tyre e inicioi sulmin, në ç'mënyrë dhe me çfarë mjeti, e më pastaj se çka dhe si vepruan të akuzuarit e tjerë.

Gjykata e Shkallës së Parë në rigjykim, do të duhej të administroi si provë edhe dëgjimin e policit apo të policëve, në cilësinë e dëshmitarit, për të vërtetuar faktin se, SHPK-ja a e bëri bastisjen në shtëpinë e të akuzuarit S. L., me ç'rast e gjeti bombën e dorës, si rezultat i hetimeve të zhvilluara në këtë drejtim apo bastisjen e bëri si rezultat i kallzimit që e bëri vetë i akuzuari S. L., gjatë kohës sa ishte i shtrirë në spital dhe në fund pasi të vlerësoi secilën provë veç e veç dhe në lidhje me njëra tjetrën dhe të gjitha së bashku me pretendimet ankimore, t'i evitoi të gjitha shkeljet e paraqitura në këtë aktvendim dhe duke e zbatuar drejtë ligjin penal, të marrë vendim të ligjshëm dhe të drejtë në këtë çështje.

Andaj, nga sa u tha më lart, konform dispozitës së nenit 424 të KPPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
Ap.nr.24/05, datë 08.03.2005

Procesmbajtësi,  
Ali Hajdini

Kryetari i kolegjit,  
Miftar Jasiqi

**[Gjykata Supreme - aktvendim mbi Kodin Penal - neni 328 (2) KPPK mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve - ankesë për ndryshimin e dënimit]**

*Avokati mbrojtës paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren duke bërë pretendimin ankimor se Gjykata e Qarkut kishte bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. I pandehuri është shpallur fajtor për vepër penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve dhe është dënuar me dënim me kohëzgjatje prej dy vjet burgim i cili nuk do të mbahet nëse i akuzuari nuk kryen vepër penale të re brenda dy vjetëve.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë, në kundërshtim me vetveten dhe gjithashtu nuk jep fakte të mjaftueshme përkitazi me faktet vendimtare dhe madje edhe ato arsye që ishin dhënë ishin të paqarta. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e avokatit mbrojtës është e bazuar.*

Ap.nr.30/2005

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Zait Xhemajli, kryetar, Miftar Jasiqi e Doc.dr. Hamdi Podvorica, anëtarë, me bashkëpunëtoresh profesionale Mejreme Memaj, procesmbajtëse, në çështjen penale të të akzuarit F. B., nga Billusha, komuna e Prizrenit, për vepër penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve parashikuar nga neni 328 par.2 të KPPK, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të të akzuarit av. Nexhat Elshani, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, P.nr.207/2003 datë 5.11.2004, në seancën e mbajtur më 19.07.2005, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Me rastin e ankesës së mbrojtësit të të akzuarit F. B. e kryesisht, aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, P.nr.207/2003 datë 5.11.2004 ndryshohet vetëm për sanksionin penal ashtu që Gjykata Supreme të akzuarit për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor ia merr si të vërtetuar dënimin me gjobë të shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë në shumë prej 500 € të cilën është i detyruar ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit e në rast se të njëjtën shumë nuk e paguan brenda afatit të caktuar, Gjykata ka për të vendosur që për çdo 15 € do t'i llogaritet një ditë burgim.

**A r s y e t i m i**

Gjykata e Qarkut në Prizren me aktgjykimin P.nr.207/2003 datë 5.11.2004, të akzuarin F. B. e ka shpallur fajtor për veprën penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPPK dhe e ka gjykuar me kusht ashtu që ia ka vërtetuar dënimin me burgim prej 1 (një) viti i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 2 (dy) vitesh nuk do të kryen vepër të re penale dhe me gjobë si dënim plotësues në shumë prej 500 € të cilën është i detyruar ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e në rast se të njëjtën shumë nuk e paguan brenda afatit të caktuar gjykata do të vendosë që për çdo 15 € t'ia llogarit një ditë burgim. Ndaj të akzuarit ka shqiptuar edhe masën e sigurisë sekuestrimin e sprejit të llojit "nato" CS GAS-SILLIARDE. Të dëmtuarit M. K., V. Sh. dhe D. K. për realizimin e kërkesës pronëso- juridike i ka udhëzuar në kontest civil. Të akzuarin e ka obliguar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 100 €.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të akzuarit për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin me propozim që Gjykata Supreme ta ndryshojë atë, ashtu që të akzuarin për mungesë të provave ta lirojë nga akuza ose ta prishë dhe lëndën t'ia kthejë Gjykatës së Shkallës së Parë në rigjykim.

Prokurori Publik i Kosovës me parashtrësën me shkrim PPA.nr.30/2005 datë 2.02.2005, ka propozuar që ankesa të refuzohet si e pabazuar kurse aktgjykimi i shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata Supreme i shqyrtoi shkresat e lëndës, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 376 të LPP dhe pas vlerësimit të thënieve në ankesë dhe detyrimisht konstatoi se aktgjykimi duhet ndryshuar përkitazi me sanksionin penal dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke mos kontestuar faktin se i akuzuari ditën kritike e ka përdorur sprejin ndaj të dëmtuarve ashtu siç ka konstatuar Gjykata e Shkallës së Parë mbrojtësi në ankesë përkitazi me gjendjen faktike pretendon se i akuzuari në rastin konkret ka vepruar në suaza të mbrojtjes ekstreme ngase para se ta përdorë sprejin në fjalë ka qenë i kërcënuar nga i dëmtuari M. K. me fjalët se "Apet ke ardhur a", prandaj duke u friguar se menjëherë pas këtyre fjalëve do të pësojë sulm i akuzuari me qëllim që ta menjanojë prej vetes atë sulm ose rrezikun e hapur të atëçashëm duke mos mundur ta mënjanojë në ndonjë mënyrë tjetër ka vepruar me sprej duke i shkaktuar të dëmtuarve një të keqe e cila në asnjë mënyrë nuk është më e madhe se ajo që i kanosej të akzuarit, prandaj veprimet e tij nuk paraqesin vepër penale dhe është dashur të lirohet nga akuza e jo të gjykohet siç gabimisht ka vepruar Gjykata e Shkallës së Parë

me aktgjykimin e kundërshtuar.

Gjykata Supreme konstaton se këto pretendime ankimore nuk janë të bazuara. Nga dëshmitë e dëshmitarëve të dëmtuar M. K., V. Sh. dhe D. K. në mënyrë të qartë dhe bindëse vërtetohet se asnjëri prej këtyre nuk kanë ndërmarrë ndonjë sulm ndaj të akuzuarit siç pa bazë pretendon ankesa e as që fjalët që përmenden në ankesë të kenë pasur karakter kërcënues që do ta imponojshin të akuzuarin që për tu mbrojtur ta përdorë sprejin siç ka vepruar ai në momentin kritik, prandaj në rastin konkret me asnjë mënyrë nuk përmbushen elementët e nevojës ekstreme në kuptim të nenit 10 të LPJ, përkatësisht nenit 9 të KPPK.

Ndërkaq duke e shqyrtuar aktgjykimin e shkallës së parë përkritazi me vendimin për dënimin Gjykata Supreme konstaton se në rastin konkret Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka mundur që ndaj të akuzurit të shqiptojë dënime komulative me burgim dhe gjobë për veprën penale në fjalë ngase sipas përkufizimit ligjor të nenit 328 par.2 të KPPK ndaj kryesit parashifet dënimi me gjobë deri në 7.500 € ose me burgim prej 1 (një) deri në 8 (tetë) vjet e fo të dyja bashkë siç ka vepruar gabimisht Gjykata e Shkallës së Parë, prandaj me aplikimin e drejtë të kësaj dispozite Gjykata Supreme detyrimisht e ndryshoi aktgjykimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Ndërkaq pretendimet ankimore të mbrojtësit për një dënim edhe më të butë i vlerësoi si të pabazuara ngase konstatoi se dënimi me gjobë në shumën prej 500 € paraqitet i nevojshëm për t'u arritur qëllimi i dënimin i paraparë me ligj.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 421 part. 1 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË  
Ap.nr.30/2005, datë 19.07.2005

Procesmbajtësja,  
Mejreme Memaj

Kryetari i kolegjit,  
Zait Xhemajli

**[Gjykata Supreme - aktvendim mbi Kodin Penal - neni 328 (2) KPPK mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve - ankesë për shkak të vërtetimit gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike - neni 415 KPPK]**

*Prokurori i Qarkut në Prizren paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren duke bërë pretendimin ankimor se Gjykata e Qarkut kishte bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. I pandehuri është akuzuar për për veprën penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve dhe ishte liruar nga Gjykata e Qarkut në Prizren. Gjykata Supreme ka vendosur se i pandehuri nuk kishte kryer veprën penale, se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë ishte i drejtë dhe i ligjshëm dhe se Gjykata e Qarkut kishte bërë vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e prokurorit të qarkut është e bazuar.*

Ap.nr.36/2005

#### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Zait Xhemajli, kryetar, Miftar Jasiqi dhe Zait Xhemajli, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Drita Rexhaj, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit Z. P., nga fsh. Dragobil, komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim, ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, parashikuar me nenin 328 par.2 të KPPK, duke vendosur përkritazi me ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prizren, P.nr.172/2004, datë 25.11.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur më 31.5.2005, mori këtë

#### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren, kurse aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, P.nr.172/2004, datë 25.11.2004, vërtetohet.

#### A r s y e t i m i

Gjykata e Qarkut Prizren, me aktgjykimin P.nr.172/2004, datë 25.11.2004, të akuzuarin Z. P., në kuptim të nenit 390 par.2 të KPPK, lidhur me nenin 18 të KPPK e ka liruar nga akuzat, për veprën penale mbajtja në

pronësi, në kontroll, në posedim, ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, parashikuar me nenin 328 par. 2 të KPPK.

Shpenzimet procedurale penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të Gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor, ankesë ka ushtruar Prokurori Publik i Qarkut në Prizren, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike neni 402 par.1 pika 3 lidhur me nenin 405 të KPPK, me propozim që Gjykata Supreme aktgjykimin e ankimuar ta prishë dhe lëndën ta kthejë në rigjykim ose të bie aktgjykim dënues.

Përgjigje në ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren, ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit Iskender Muzbeg, avokat në Prizren, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, aktgjykimin e kundërshtuar ta vërtetoj ndërsa, ankesën e PPQ në Prizren ta refuzoi.

Prokurori Publik i Kosovës, me shkresën PPA.nr.36/2005 datë 10.02.2005, propozoi që ankesa e paraqitur të pranohet si e bazuar.

Gjykata Supreme i shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e ankimuar konform dispozitës së nenit 415 të KPPK dhe, pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Meqenëse aktgjykimi i kundërshtuar, nuk përmban shkelje qenësore të dispozitave të procedurës penale, në dëm të akuzuarit për të cilat Gjykata Supreme në përputhje me dispozitat e nenit 376 të LPP-së kujdeset detyrimisht, kjo Gjykatë u kufizua në vlerësimin e pretendimeve tjera ankimore.

Përkritazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar ose jo i plotë i gjendjes faktike, në ankesë theksohet se Gjykata e Shkallës së Parë gjatë administrimit të provave nuk i ka vlerësuar drejt dhe në mënyrë të plotë të gjitha provat, por në rastin konkret Gjykata e Shkallës së Parë e ka marrë parasysh deklaratën e të akuzuarit, ku sipas tij që të sigurohet leja së pari duhet të sigurohet arma e pastaj të aplikohet për leje, prandaj konsiderojmë se kjo bie në kundërshtim të plotë me Urdhëresën Administrative 2003/1, neni 2 pika 2.1, ku precizohet se Policia e UNMIK-ut, është organi i vetëm përgjegjës që administron regjistrimin e armëve të gjuetisë dhe të rekreacionit në Kosovë.

Nga shkresat e lëndës, në këtë çështje juridiko-penale, rezulton se Z. P. është anëtar i Shoqatës së Gjuetarëve "Dreri" në Malishevë. Ka qenë i interesuar për marrjen e lejes së armës por me shpjegimin që i është dhënë në Njësitin e armëve në Malishevë ka kuptuar se së pari duhet të sigurohet arma e pastaj të regjistrohet dhe të jepet leja për të njëjtën, njëherit iu ka besuar

udhëzimeve të tyre se mundë të jetë në posedim të armës derisa të sigurojë të njëjtën edhe pa lejen e organit kompetent. Po ashtu nga foto dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, vërtetohet se arma e gjuetisë në momentin e transportit ishte e demontuar tërësisht.

Prandaj edhe sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, ekzistojnë elementet të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale, sepse është fakt notorë se të interesuarve për leje të armëve në Kosovë së pari u jepet sqarime se më parë duhet të sigurojnë armën e pastaj të paraqesin për regjistrimin dhe leje tek organi kompetent, se arma i është gjetur e demontuar plotësisht dhe jo e gatshme për veprim, po ashtu edhe fakti se ai ishte gjuetar i regjistruar, posedonte Librezën e Antarësisë nga Federata e Gjuetarëve të Kosovës.

Kjo gjendje faktike vërtetohet me mbrojtjen e të akuzuarit, në listën mbi marrjen e sendeve, me foto dokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës si dhe fakte dhe rrethana të vërtetuara në shqyrtimin kryesorë.

Po ashtu me nenin 11 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/7, për Autorizimin e Posedimit të Armëve në Kosovë, pos tjerash është parashikuar që posedimi i armëve të gjuetisë dhe rekreacionit do të rregullohet me rregullores të posaçme. Nga informata e më vonshme e cila konsiderohet pjesë e rregullores së përmendur pushkët e gjuetisë mundë të mbahen pa leje apo pa çertifikatë për armë gjuetie derisa të furnizohen me lejen përkatëse.

Duke pas parasysh këto rrethana dhe rrethanat e arsyt tjera të shpjeguara më hollësisht në aktgjykimin e shkallës së parë, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, rezulton i njëjti konkludim se i akuzuari nuk është kryes i kësaj veprë penale, se aktgjykimi i shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, se në mënyrë të drejtë është vërtetuar gjendja faktike.

Nga këto arsye, pretendimet ankimore të Prokurorit Publik të Qarkut se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nuk mund të pranohen.

Nga sa u tha më lart dhe në përputhje me dispozitat e nenit 420 par.1 pika 2 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ap.nr.36/2005, datë 31.5.2005

Procesmbajtësja,  
Drita Rexhaj

Kryetari i kolegjit,  
Zait Xhemajli

**[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Kodin Penal - neni 328 (2) KPPK mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim të paautorizuar të armëve ankesë për ndryshimin e dënimit - gjendja faktike, kualifikimi juridik - neni 390 (1) KPPPK, shtojca a e rregullores së UNMIK-ut 2001/7, urdhëresa administrative e UNMIK-ut nr. 2003/1, rregullorja e UNMIK-ut 2001/7]**

*Prokurori i Qarkut paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë duke bërë pretendimin ankimor se Gjykata e Qarkut ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe ka shkelur kodin penal.*

*I pandehuri është akuzuar për marrja në pronësi, kontroll, posedim, dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve dhe ishte liruar nga Gjykata e Qarkut.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e Qarkut kishte vlerësuar drejtë gjendjen faktike dhe kishte vlerësuar në mënyrë të duhur kriteret e nevojshme për lirimin e të akuzuarit siç parashihet me nenin 390 të KPPPK-së. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e prokurorit të qarkut është e pabazë.*

Ap.nr.45/2005

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Krasniqi, kryetar, Gjuran Dema dhe Riza Loci, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesionale Minire Xhambazi, procesmbajtëse, në lëndën penale të të akuzuarit R. Z., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim, ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga nenin 328 par.2 të KPPK, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut në Prishtinë, paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P.nr.452/2004 datë 7.12.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur më 22.03.2005, mori këtë

## A K T G J Y K I M

Ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Prishtinë refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjyqimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P.nr.452/2004 datë 7.12.2004, vërtetohet.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykata e Qarkut në Prishtinë, P.nr.452/2004 datë 7.12.2004, i akuzuari R. Z. në kuptim të dispozitës nga neni 390 par.1 të KPPPK është liruar nga akuza, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim, ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPPK. Shpenzimet procedurale bien në barrë të mjeteve buxhetore të Gjykatës, kurse pushka e gjuetisë nr. 110408 model "Sansilmas" TS 870 TM i kthehet të akuzuarit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka paraqitur ankesë Prokurori Publik i Qarkut në Prishtinë, për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që aktgjyqimi i ankimuar të priset dhe çështja t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim.

Prokurori Publik i Kosovës, me parashtresën PPA.nr.45/2005 datë 9.02.2005, ka propozuar që ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Prishtinë të pranohet si e bazuar. Në seancë nuk mori pjesë edhe pse është njoftuar me rregull.

Gjykata Supreme i shqyrtoi shkresat e lëndës së bashku me aktgjykimin e ankimuar të cilin e studioi në kuptim të dispozitës nga neni 415 të KPPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet ankimore, gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Aktgjyqimi i ankimuar nuk përmban shkelje qenësore të dispozitave të procedurës penale për të cilat kjo Gjykatë në bazë të nenit 415 të KPPPK, kujdeset detyrimisht.

Pa bazë ankimohet aktgjyqimi i Gjykatës së Shkallës së Parë se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë.

Nga mbrojtja e të akuzuarit, vërtetimit për marrjen e pushkës së gjuetisë dhe çertifikatës së Shoqatës së Gjuetarëve në Ferizaj datë 12.12.2001, me aktgjykimin e ankimuar gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe me te ligji penal është zbatuar në mënyrë të drejtë. Drejt ka vepruar Gjykata e Shkallës së Parë kur të akuzuarin e ka liruar nga akuza në kuptim të dispozitës së nga neni 390 par.1 të KPPK. Nga provat e nxjerrura, rrjedh se të akuzuarit në pompën e benzinës pronar i së cilës është ai, më datë 15.04.2002 i është marrë pushka dy tytëshe e gjuetisë me shënime më të hollësishme si në dispozitivin e aktgjyqimit të ankimuar, për të cilën ka poseduar çertifikatë nga Shoqata e Gjuetarëve në Ferizaj.

Pretendimet ankimore se i akuzuari është dashur të paraqet kërkesë pranë organeve kompetente që t'i lejohet e drejta për mbajtje të pushkës së

gjuetisë, janë të pabazuara. Nga shtojca A e Rregullores nr.2001/7 për posedimin e autorizimit të armëve në Kosovë dhe informata për pronarët e armëve të gjuetisë, pos tjerash rrjedhë se: "Armët të cilat definoohen si armë gjuetie mund të mbahen legalisht pa leje apo certifikatë për armë gjuetie", prandaj, mbajtja e pushkës së gjuetisë nga ana e të akuzuarit në kohën kur i është marrë ajo, nuk paraqet vepër penale. Urdhëresa administrative e UNMIK-ut nr. 2003/1, për zbatimin e Rregullores nr. 2001/7, Për autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë ka hyr në fuqi më datë 17.01.2003, kurse neni 7 dhe 8 i kësaj urdhërese më datë 1 maj 2003, respektivisht kjo urdhëresë nuk ka efekt retroaktiv. Duke zbatuar në mënyrë të drejtë shtojcën A të Rregullores nr. 2001/7 dhe informatën për pronarët e armëve të gjuetisë si pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje, Gjykata e Shkallës së Parë drejt ka zbatuar ligjin penal kur ka gjetur se veprimet e të akuzuarit nuk paraqesin vepër penale për të cilën ai ka qenë i akuzuar dhe drejt ka vendosur kur të akuzuarin në kuptim të nenit 390 par.1 të KPPPK e ka liruar nga akuza.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të dispozitës nga neni 423 të KPPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ap.nr. 45/2005, datë 23.03.2005

Procesmbajtësja,  
Minire Xhambazi

Kryetari i kolegjit,  
Agim Krasniqi

Anëtarët e kolegjit gjyqtarët:  
Gjuran Dema  
Riza Loci

**[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Kodin Penal - nenet 317 (2), 328 (2) KPPK - sulmi kundër personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare, mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve - ankesa për prishjen e aktgjykimit - dispozitat e procedurës penale - gjendja faktike dhe ligjore - vendimi për dënim - neni 403 (1) 12) KPPPK, 64 KPPK]**

*Avokati mbrojtës paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë duke bërë pretendimin ankimor se Gjykata e Qarkut në aktvendimin vet ka shkelur dispozitat e kodit penal dhe të procedurës penale dhe se ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.*

*I pandehuri është akuzuar për sulm të personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare dhe për marrje në pronësi, kontroll, posedim, dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve dhe ishte shpallur fajtor dhe dënuar me 10 muaj burgim dhe me ndëshkime shtesë financiare.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e Qarkut i ishte përmbajtur dispozitave në fuqi të procedurës penale dhe kishte bërë vërtetimin e duhur të gjendjes faktike dhe të gjendjes ligjore. Gjykata Supreme ka vendosur se vendimi për dënim vlerëson në mënyrë të drejtë rrethanat rënduese dhe lehtësuese siç parashihet me nenin 64 të KPPK-së. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e avokatit mbrojtës është e pazabë.*

Ap.nr.47/2005

#### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Miftar Jasiqi, kryetar, Zait Xhemajli e Avdi Dinaj, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mejreme Memaj, procesmbajtëse, në lëndën penale ndaj të akuzuarit F. S., nga Prishtina, për veprat penale sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 317 al.2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), dhe veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 al.1 të KPPK, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prishtinë, P.nr. 283/2004 datë 18.10.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur më 19.04.2005, mori këtë

#### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit F. S. ndërsa aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prishtinë, P.nr. 283/2004 datë 18.10.2004, vërtetohet.

#### A r s y e t i m i

Gjykata e Qarkut Prishtinë me aktgjykimin P.nr.283/2004 datë 18.10.2004, të akuzuarit F. S. dhe L. B. i ka shpallur fajtor për veprën penale të kryer në bashkëveprim sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 317 al.2 të KPPK, ndërsa të akuzuarin F. edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 al. 1 të KPPK, i ka gjykuar të akuzuarin F. S. me dënim unik burgu në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve, në të cilin i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 5.04.2004 gjer më 19.07.2004, të akuzuarin L. B.a me dënim burgu në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, në të cilin i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 3.04.2004 gjer më 19.07.2004. Të akuzuarit janë obliguar që t'i paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së Gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç shumën prej 40 €.

Me të njëjtin aktgjykim i akuzuari G. K. është liruar nga akuza për veprën penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 316 al.1 të KPPK.

Kundër pjesës ndëshkuese të këtij aktgjykimi në afat ligjor ka paraqitur ankesë mbrojtësi i të akuzuarit F. S., av. Bajram Tmava, nga Prishtina, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim me propozim që Gjykata Supreme ta aprovojë ankesën ndërsa aktgjykimin e kundërshtuar ta prishë dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim apo ta ndryshojë përkritazi me vendimin për dënim dhe të akuzuarit F. S. t'i shqiptojë dënim më të butë. Ka kërkuar që së bashku me të akuzuarin të njoftohen për seancën e kolegjit.

Sipas kërkesës së mbrojtësit të të akuzuarit e në kuptim të dispozitës së nenit 410 të KPPK-ës, Gjykata Supreme mbajti seancën e kolegjit në të cilën ishte i pranishëm mbrojtësi i të akuzuarit i cili pasi që sqaroi disa nga thëniet në ankesë mbeti në tërësi pranë propozimeve të bëra në të. Edhe pse të njoftuar me rregull nuk ishin të pranishëm i akuzuari F. S. e as Prokurori Publik i Kosovës, mirëpo Prokurori Publik i Kosovës me parashtresën PPA.nr.47/2005 datë 4.02.2005, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimin i kundërshtuar të vërtetohet.

Gjykata Supreme pasi që i shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e kundërshtuar sipas dispozitës së nenit 415 të KPPK, vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit F. S. në ankesë pretendon se aktgjykimin i kundërshtuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse ekzistojnë kundërtënie midis dispozitivit dhe arsytimit të aktgjykimin,

pra aludon në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale parashikuar me nenin 403 par.1 pika 12 të KPPK. Mirëpo në ankesë nuk paraqiten arsyet se ku qëndrojnë këto shkelje ndërsa arsyet e dhëna i referohen vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike.

Por kjo Gjykatë vlerëson se aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 403 par.1 pika 12 të KPPK, sepse dispozitivi i tij është i qartë, nuk ka kundërtënie qoftë me vetveten ose me arsyetimin. Në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftuara faktike dhe juridike të cilat i aprovon edhe kjo Gjykatë, ndërsa gjendja e fakteve dhe konkludimet e Gjykatës së Shkallës së Parë kanë mbështetjen në provat e administruara.

Sa i përket bazës ankimore vërtetimit i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit pretendon se Gjykata e Shkallës së Parë me asnjë provë nuk ka vërtetuar se i akuzuari F. ka kryer veprat penale të përshkuara në dispozitivin e aktgjykimin të kundërshtuar. Pretendon se Gjykata e Shkallës së Parë nuk e ka vërtetuar faktin se i mbrojturi i tij posedonte granatën e dorës ngase nuk është konfiskuar ditën e ngjarjes dhe nuk është gjetur edhe me rastin e bastisjes së shtëpisë. Me tutje pretendon se nuk është vërtetuar se policët të cilët ishin sulmuar ditën e ngjarjes a kishin përpiluar raport me shkrim dhe ky raport a ishte arsyetuar nga eprori i tyre.

Edhe pretendimet e mësipërme ankimore sipas kësaj Gjykate janë të pabazuara. Në këtë çështje juridiko-penale është irelevante përpilimi i raportit me shkrim nga policët dhe kontrollimi i këtij raporti nga eprori i tyre. Nga deponimet e policëve-dëshmitarëve të kësaj ngjarje B. M., B. A., H. N. dhe L. B., Gjykata e Shkallës së Parë ka vërtetuar se i akuzuari F. së bashku me L. B. dhe G. K. përderisa ishin duke udhëtuar me automjetin e tipit "xhip landover" në Prishtinë në rrugën Agim Ramadani, policia i ka ndalë për ti kontrolluar, i akuzuari L. ka filluar t'i shajë dhe ofendoj policët, në momentin kur policia ka nxjerrë nga vetura të akuzuarin L., i akuzuari F. reagon me fjalët lironi L. se ju qova në hava, dhe në dorë kishte granatën, të cilës tentonte të ia hiqte siguresën. Dëshmitarët e kësaj ngjarje-policët duke u gjetur para kësaj situatë meqë gjendeshin në vend ku kishte qarkullim të madh të njerëzve nga frika se i akuzuari F. do ta aktivizonte granatën detyrohen t'i lëshojnë, ndërsa të akuzuarit largohen nga vendi i ngjarjes. Nga kjo rezulton se i akuzuari F. ditën e ngjarjes posedonte granatën e dorës ndërsa duke pasur parasysh mënyrën se si është zhvilluar ngjarja, faktin se i akuzuari është arrestuar disa javë nga dita e ngjarjes është irelevante se atij nuk i është sekuestruar apo gjetur granata.

Sa i përket bazës ankimore të shkeljes së ligjit penal, mbrojtësi në ankesë pretendon se Gjykata e Shkallës së Parë ka shkelur ligjin penal në dëm të të akuzuarit sepse të akuzuarin F. e ka shpallur fajtor për veprat penale të cilat nuk i ka kryer, konsideron se Gjykata e Shkallës së Parë gabimisht ka cilësuar veprën penale të dytë kur ka gjet se ka kryer veprën penale vringëllimi me armë

pasi që një cilësim i tillë me nenin 328 të KPPK, fare nuk ekziston.

Kjo Gjykatë edhe këto pretendime ankimore i konsideron si të pabazuara, sepse nga provat e administruara në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar se i akuzuari është kryes i veprave penale për të cilat është shpallur fajtor, ndërsa sa i përket cilësimit të veprës penale kjo Gjykatë konsideron se Gjykata gabimisht ka emërtuar veprën penale nga neni 328 par.1 të KPPK-ës, si vringëllim me armë, sepse emërtimi ligjor i kësaj vepre është mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve ndërsa paragrafi 1 i këtij neni i referohet cilësimit të veprës penale.

Përkritazi me vendimin për dënim në ankesë mbrojtësi i të akzuarit fare nuk jep arsytim meqë sipas ankesës aktgjykimi i kundërshtuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ligjit penal, arsytimi mbi vendimin për dënim është i tepërt.

Mirëpo, duke vlerësuar aktgjykimin e kundërshtuar në këtë aspekt Gjykata Supreme gjen se gjykata e shkallës së parë drejt dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat që sipas dispozitës së nenit 64 të KPPK, ndikojnë në llojin dhe masën e dënimit e po ashtu edhe rrethanat e rastit konkret. Si rrethana lehtësuese për të akzuarin F. S. gjykata e shkallës së parë ka gjetur, padënueshmërinë e tij të mëhershme dhe gjendjen e varfër ekonomike, ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur. Një vlerësim të tillë të të gjitha rrethanave e aprovon si të drejtë edhe kjo gjykatë, me bindje se dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë i përgjigjet rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë të të akzuarit, dhe se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat përkatëse ligjore.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 423 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Ap.nr. 47/2005, datë 19.04.2005

Procesmbajtësja,  
Mejreme Memaj

Anëtarët e kolegjit,  
Zait Xhemajli  
Avdi Dinaj

Kryetari i kolegjit,  
Miftar Jasiqi

#### [Gjykata Supreme - aktvendim mbi Kodin Penal - neni 297 (1,3,5) KPPK rrezikimi i trafikut publik - ankesë për ndryshimin e dënimit]

*Prokurori i Qarkut në Gjilan paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan duke bërë pretendimin ankimor se dënimi i shqiptuar nuk ishte në përpjestim me shkallën e përgjegjësisë penale të akzuarit dhe intensitetin e rrezikut shoqëror. I pandehuri është shpallur fajtor për veprë penale të rrezikimit të trafikut publik dhe është dënuar me kusht dhe me ndëshkime financiare shtesë dhe masa të sigurisë. Gjykata Supreme ka vendosur se dënimi me kusht nuk ishte në përpjestim me rrezikun shoqëror siç theksohet në ankesën e prokurorit. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e prokurorit të qarkut është e bazuar.*

Ap.nr.50/2005

#### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Miftar Jasiqi, kryetar kolegji, gjyqtarët Zait Xhemajli e Fejzullah Hasani, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Mejreme Memaj, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të akzuarit I. A. nga fsh. Sllatinë e Epërme, komuna e Vitisë, për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 al.1 lidhur me al.5 dhe 3 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut-Gjilan PP.nr.83/2004 datë 1 nëntor 2004, të paraqitur kundër aktgjykimin të Gjykatës së Qarkut-Gjilan, P.nr.98/2004 datë 22.09.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur me 11.05.2005, mori këtë:

#### A K T G J Y K I M

Me aprovimin e ankesës së Prokurorit Publik të Qarkut-Gjilan, aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Gjilan P.nr.98/04 datë 22.09.2004, ndryshohet përkritazi me vendimin për dënim ashtu që Gjykata Supreme të akzuarin I. A. për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, e gjykon me dënim burgu në kohëzgjatje prej 5 muajve, në të cilin i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 24.04.2004 gjer me datën 18.05.2004.

#### A r s y e t i m i

Gjykata e Qarkut në Gjilan, me aktgjykimin P.nr.98/2004, datë 22.09.2004, të akzuarin I. A., e ka shpallë fajtor për veprën penale rrezikimi i komunikacionit rrugor nga neni 297 par.1 lidhur me par.5 dhe 3 të KPPK-ës, e ka gjykuar kusht duke ia caktuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 1(një)

viti, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit prej 2(dy) viteve nuk kryen vepër tjetër penale, duke ia llogaritur në këtë dënim edhe kohën e kaluar në paraburgim prej datës 24.04.2004 e deri me datën 18.05.2004. Është obliguar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe shumë prej 50 (pesëdhjetë) eurove, në emër të paushallit gjyqësor. Sipas dispozitës së nenit 58 të KPPK-ës, të akuzuarit i është shqiptuar masa e sigurisë ndalimi i vozitjes me automjet motorik të udhëtarëve në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka paraqitur ankesë

-Prokurori Publik i Qarkut në Gjilan, për shkak të vendimit për dënim, me propozim që Gjykata Supreme aktgjykimin e kundërshtuar ta ndryshoi në atë mënyrë që të akuzuarit t'i shqiptojë dënim më të ashpër.

Gjykata Supreme e Kosovës për seancën e kolegjit në kuptim të dispozitës së nenit 410 të KPPPK-ës, njoftoi të akuzuarin, mbrojtësin e tij dhe Prokurorin Publik të Kosovës. Në seancë ishte i pranishëm i akuzuari, ndërsa mbrojtësi i tij dhe Prokurori Publik i Kosovës edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt nuk morën pjesë, mirëpo Prokurori Publik i Kosovës me parashtresën PPA.nr.50/2005 datë 16.02.2005, ka propozuar që ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut-Gjilan të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i ashpër.

Gjykata Supreme shqyrtoi shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e kundërshtuar konform dispozitës së nenit 415 të KPPPK-ës, dhe pas vlerësimit të pretendimet ankimore në ankesë konstatoi:

-ankesa është e bazuar.

Meqë aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat Gjykata Supreme në kuptim të dispozitës së nenit 415 të KPPPK-ës, i vëren sipas detyrës zyrtare e as shkelje të ligjit penal edhe pse aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë nuk kundërshtohet në këtë drejtim, ndërsa edhe gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë, kjo Gjykatë vlerësoi vetëm pretendimet e cekura në ankesë.

Në ankesë Prokurori Publik i Qarkut pretendon se dënimi i shqiptuar nuk i përgjigjet përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe intensitetit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale duke pasur parasysh rrethanat se i akuzuari në momentin kritik nuk ka ndërmarrë asnjë veprim të mënjanimit të së keqes, ditën e ngjarjes ka vozitur me shpejtësi prej 46,04 km/h, në vendin ku shpejtësia maksimale e lejuar është 40 km/h, ndërsa sipas mendimit të ekspertit

të komunikacionit vozitja prej 40 km/h, nuk do të ishte fatale për feminë 10 (dhjetë) vjeçar B. S., më tutje thekson se lëshimet e të ndjerit B. nuk janë të asaj mase sa që Gjykata e shkallës së parë ta ndajë përgjegjësinë penale.

Duke vlerësuar këto pretendime ankimore Gjykata Supreme gjen se dënimi me kusht nuk i përgjigjet rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, ashtu siç me të drejtë prokurori thekson në ankesë. Përkundër rrethanës së përgjigjes për aksidentin e ndodhur ka qenë edhe viktimja e kësaj ngjarje, duke pasur parasysh rrethanën se i akuzuari ka vozitur me një shpejtësi prej 46 km/h, në vendin ku shpejtësia maksimale e lejuar është 40 km/h dhe konstatimin e ekspertit të komunikacionit se sikur ngasësi i veturës t'i përmbahej shpejtësisë së lejuar dhe të voziste me kujdes të shtuar nuk do të vinte deri tek aksidenti, ndërsa në rastin konkret femija ka vdekur, kjo gjykatë i shqiptoi dënimin sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat përkatëse ligjore.

Nga sa u tha më lartë e sipas dispozitës së nenit 426 të KPPPK-ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË  
Ap.nr. 50/2005, datë 11.05.2005

Procesmbajtësja,  
Mejreme Memaj

Anëtarët e kolegjit,  
Zait Xhemajli  
mr.sc.Fejzullah Hasani

Kryetari i kolegjit,  
Miftar Jasiqi

**[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Kodin Penal - neni 244(2) KPPK prodhimi i parave të falsifikuara - ankesa për ndryshimin e dënimit ankesa e tërhequr nga Prokurori Publik i Kosovës]**

*Prokurori i Qarkut në Gjiilan paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjiilan duke bërë pretendimin ankimor se Gjykata e Qarkut në aktvendimin e vet kishte shkelur dispozitat e kodit penal dhe të procedurës penale dhe se kishte bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. I pandehuri ishte akuzuar për prodhim të parave të falsifikuara dhe ishte liruar nga Gjykata e Qarkut.*

*Prokurori Publik i Kosovës tërhoqi ankesën. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e prokurorit të qarkut është e pabazuar.*

Ap.nr.55/2005

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gjuran Dema, kryetar, mr.sc.Fejzullah Hasani, Agim Krasniqi anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Minire Xhambazi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. Xh. nga fsh. Dobresh Viti, për veprën penale falsifikimi i parasë, nga neni 244 al.2 të KPPK, duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut në Gjiilan, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjiilan, P.nr.111/2004, datë 4.10.2004, në seancën e Kolegjit të mbajtur më 19.5.2005, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Hidhet si e palejueshme ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Gjiilan e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjiilan, Pn.111/2004, datë 4.10.2004

**A r s y e t i m i**

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjiilan, P.nr.111/2004, datë 4.10.2004, në bazë të nenit 350 al.3 të LPP i akuzuari B. Xh., është liruar nga akuza, për veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 244 al.2 të KPPK.

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë ka paraqitur Prokurori Publik i Qarkut

në Gjiilan, për shkak të shkeljes esenciale të procedurës penale nga neni 364 par.1 pika 11 të LPP dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata Supreme aktgjykimin e kundërshtuar ta ndryshojë dhe të akuzuarin ta shpallë fajtor për veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 244 al.2 të KPPK dhe ta dënoj sipas ligjit, apo që këtë aktgjykim ta prish dhe lëndën ta kthej në rigjykim.

Prokuroria Publik e Kosovës me parashtresën PPA.nr.55/2005 të datës 1.3.2005, ka deklaruar se heq dorë nga ushtrimi i ankesës së Prokurorisë së Qarkut në Gjiilan të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjiilan P.nr.111/2004, datës 4.10.2004.

Meqenëse Prokuroria Publike e Kosovës e ka tërhequr ankesën, Gjykata Supreme, në pajtim me dispozitën e nenit 383 të LPP, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË**

Ap.nr.55/2005, datë 1.6.2005

Procesmbajtësja,  
Minire Xhambazi

Kryetari i kolegjit,  
Gjuran Dema

**[Gjykata Supreme - aktvendim mbi Kodin Penal - neni 245 LPJ prodhimi dhe shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve në bashkëpjesëmarrje - ankesë për shkak të shkeljes së Kodit Penal dëshmitarët bashkëpunëtor]**

*Prokurori i Qarkut në Mitrovicë paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë duke bërë pretendimin ankimor se Gjykata e Qarkut në aktvendimin e vet ka shkelur dispozitat e kodit penal dhe të procedurës penale dhe ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Të pandehurit janë shpallur fajtor për vepër penale të prodhimit dhe shpërndarjes së paautorizuar të narkotikëve të kryer në bashkëpjesëmarrje dhe ishin liruar nga Gjykata e Qarkut. Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shcallës së parë në aktvendimin vet ka përdorur gabimisht termin dëshmitar anonym duke iu referuar gjatë shqyrtimit kryesor dëshmitarit bashkëpunues. Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e Qarkut duke e bërë një gjë të tillë ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike duke shkelur kodin penal. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e prokurorit të qarkut është e bazuar.*

Ap.nr.56/2005

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Krasniqi, kryetar, Gjuran Dema dhe dr. Hamdi Podvorica, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesionale Minire Xhambazi, procesmbajtëse, në çështjen penale të të akuzuarve N. V., A. A., dhe F. T., të gjithë nga Mitrovica, për shkak të veprave penale prodhimi i paautorizuar dhe vënia në qarkullim të narkotikëve në bashkëekzekutim nga neni 245 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 22 të LPJ, duke vendosur sipas ankesës të Prokurorit Publik të Qarkut në Mitrovicë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, P.nr.236/2004 datë 15.09.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 410 të KPPPK (Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës), më datë 10.05.2005, mori këtë

**A K T V E N D I M**

Pranohet si e bazuar ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Mitrovicë, kurse aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, P.nr.236/2004 datë 15.09.2004, prishet dhe lënda i kthehet të njëjtës Gjykatë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë P.nr.236/2004 datë 15.09.2004, të akuzuarit janë liruar nga akuza në bazë të nenit 390 pika 3 të KPPPK dhe atë: N. V. dhe A. A., për shkak të veprës penale prodhimi i paautorizuar dhe vënia në qarkullim të narkotikëve në bashkëekzekutim nga neni 245 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 22 të LPJ, dhe të akuzuarit N. V., A. A. dhe F. T., për shkak të veprës penale prodhimi i paautorizuar dhe vënia në qarkullim të narkotikëve në bashkëekzekutim nga neni 245 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 22 të LPJ. Shpenzimet procedurale i janë ngarkuar mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur Prokurori Publik i Qarkut në Mitrovicë, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të prishet dhe lënda t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.

Gjykata Supreme e caktoi seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 410 të KPPPK, për të cilën ishin njoftuar me rregull të gjitha palët, ku prezent ishte vetëm mbrojtësi i të akuzuarit, avokati Shefqet Ibrahim, nga Skënderaj, i cili propozoi që ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Mitrovicë të refuzohet si e pabazuar.

Prokurori Publik i Kosovës me parashtresën e vetë PPA.nr.56/2005 datë 14.02.2005, ka propozuar që ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Mitrovicë të pranohet si e bazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të prishet dhe lënda t'i kthehet Gjykatës së Shcallës së Parë në rigjykim.

Gjykata Supreme i shqyrtoi shkresat e lëndës, studioi aktgjykimin e ankimuar konform dispozitës së nenit 415 të KPPPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, gjeti se:

Ankesat është e bazuar.

Aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale nga neni 403 par.1 pika 12 të KPPPK, sepse nuk përmban fare arsye për faktet vendimtare, sikurse dhe ka kundërtënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e shkresave ose të procesverbaleve për deklarimet e dhëna në procedurë dhe të vetë këtyre shkresave dhe procesverbaleve. Së këndejmi, Gjykata e Shcallës së Parë aktgjykimin e vet e mbështet në dispozitën e nenit 157 të KPPPK par.3 dhe 4, fare duke mos i vlerësuar mbrojtjet e të akuzuarve, në veçanti mbrojtjen e të akuzuarit F. T., në lidhmëri me deklaratën e dëshmitarit bashkëpunues. Prandaj, në këtë drejtim ankesa është e bazuar.

Me aktgjykimin e ankimuar as nuk është bërë orvatje që të jipen arsye

për faktet se cilave Gjykata i kushton besim, por vetëm të njëjtën e mbështet në dispozitën e nenit 157 par.3 dhe 4 të KPPPK. Gjykata e Shkallës së Parë dëshminë e dëshmitarit bashkëpunues nuk e vlerëson fare në kontekst të mbrojtjeve të të akuzuarve, e në veçanti të mbrojtjes të të akuzuarit F. T., i cili deklaroi se i njeh të akuzuarit N. V. dhe A. A., me të cilët ka udhëtuar në Novi Pazar. Nuk tregon arsyen pse ka udhëtuar edhe ai në Novi Pazar, por të akuzuarit e tjerë, sipas mbrojtjes të të akuzuarit F., kanë udhëtuar për nevojat e H. M., i cili ka pasur me dorëzuar dokumentat për rregullimin e pasaportës dhe lejes së automjetit. I akuzuari F. T. i njeh mirë të akuzuarit N.V. dhe A. A., i cili e ka pseudonimin "Zhuti". Mbrojtjet e të akuzuarve duhet të vlerësohen në lidhmëri me deklaratën e dëshmitarit bashkëpunues, i cili deklaroi: "të akuzuarin N. V. e njeh prej vitit 2003, i cili ka kërkuar që bashkarisht të punojnë diç. Në ndërkohë e ka njoftuar me A. dhe të akuzuarin A. A., të cilin e quajnë "Zhuti", duke ia ditur edhe adresën e tij, e i cili mirret me tregtinë e të gjitha sendeve ... Në Nëntor të vitit 2003 i akuzuari N. e thërret në telefon në ora 18 dhe kërkon që të takohet, takohen në pjesën veriore të qytetit në kafiterinë "Matrix", ku aty i len të akuzuarit N. dhe A. së bashku me dy vajza të quajtura G. dhe I., vetë ky shkon në pjesën jugore të Mitrovicës. Pas një kohe të shkurtër e thërrasin dhe i propozojnë që të takohen në Prishtinë, në lokalit "Kvos", ku edhe janë takuar, në shoqëri kanë qenë të akuzuarit A. dhe N. si dhe dy vajzat e përmendura, me ç'rast i akuzuari N. i tregon se prej A. A. ka blerë 6 kilogram marihuanë, të cilin G. dhe I. do t'i transportojnë në Serbi. Meqë i akuzuari N. nuk ka pasur para me ia paguar A. A. për mallin e blerë, në prezencën e tij janë marrë vesh që i akuzuari N. t'i bie në oborr të A. A. dy vetura të markës "Llada niva" njëra me targë UN-124 e tjetra 600-KS-613, të cilat vetë i ka pa, e që më pastaj i akuzuari N. do t'ia paguajë paratë. I akuzuari A. drogën e përmendur e ka shitur me çmim prej 150 euro për kilogram. Pas kësaj, A. A. ia jep 50 € për atë se është arritur marrëveshja. Pas disa ditësh përsëri takohet me të akuzuarin A. në pjesën jugore të Mitrovicës, e pastaj kalojnë në pjesën veriore, sepse i akuzuari duhej të takohet me të akuzuarin N.. Shkojnë dhe takohen me të akuzuarin N., me të cilin ka qenë edhe një djalosh i ri, farmacist në Zvečan, i quajtur M. nga Serbia. Aty në kafiteri të akuzuarit N. dhe A. janë marrë vesh për blerjen sasisë së re të drogës, të tipit "Heroin". Atë natë së bashku me të akuzuarit A. dhe N. dhe të përmendur M., farmacist nga Zveçani kalojnë në pjesën jugore të Mitrovicës në hotelin "Pallas", me automobilin e markës "Llada niva" me targë UN 124. Gjatë darkës të akuzuarit A. dhe N. shkojnë dhe takohen me një person të quajtur "Liko" afër restorantit "Mitrometal" për t'u marrë vesh rreth drogës të tipit të quajtur "Çokolatë". Më vonë po atë natë vijnë të akuzuarit A. dhe N. dhe i tregojnë se prej personit të quajtur "Liko" kanë marrë 250 gram drogë të tipit "Çokolatë". Pas darkës, të akuzuarit A. dhe N. kalojnë në anën e kundërt të rrugës përballë kafiterisë "Mitrometal" ku qëndron te një automobil i parkuar i markës "BMW", me ngjyrë të bardhë, me tabela të Bosnës dhe Hercegovinës, ku biseduan diç, e më pastaj i akuzuari N. dhe farmacisti M. shkuan në Beograd ku dërguan 250 gram drogë të quajtur "Çokolatë". Deklaron se këtë automobil "BMW" e njeh mirë si dhe vozitësin e

tij. Një ditë tjetër e thërret i akuzuari A. dhe takohen ku ia jep 150 € që të shkon ky deri në Rashka, me të akuzuarin N. dhe të akuzuarin F. T., me automobilin "Peugaut 306", me ngjyrë të bardhë, me tabela KM-142-92. Ky së bashku me F. nuk kanë guxuar me dalë prej automobilit, i akuzuari N. ua ka treguar se me ata njerëz që është takuar e të cilët ishin me automobilin e markës "Kalibra" me ngjyrë të bardhë, me regjistrim UR-296-340, është marrë vesh që t'u i dërgojë sasi të re të drogës. Më pastaj ka pa se të akuzuarit A. e N. shoqërohen dhe në Serbi kanë dërguar sasi të mallit të drogës si dhe se janë marrë me tregti të automobilave prej Serbisë në Kosovë. Është i njohur se të akuzuarit N. i janë kthyer dy automobilat "Llada niva" të cilat i ka dhënë peng të akuzuarit A. të premtën, e janë kthyer të hënën në mëngjes në ora 6. Vozitësi i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë Selajdin Haliti ka parë të akuzuarin A. të quajtur "Zhuti" se si e voziste automobilin "Llada niva" i cili është i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë. Më pastaj, i akuzuari N. e thërret në telefon dhe i kërcënohet se do ta vret. Me datën 22.12.2003 rreth orës 18, derisa ka qenë duke shkuar prej shtëpisë në punë, sepse banon në pjesën veriore të Mitrovicës, e ka pritur i akuzuari N. me dy persona të tjerë, i afrohet dhe e pyet se a dëshiron që edhe më tutje të punojnë, ky i përgjigjet se jo, por i afrohet shoku i të akuzuarit N. i quajtur "Bucko" se është i trashë, dhe i bjen me boks të hekurt, kurse personi i tretë i quajtur S., ish polic jugosllav, të cilin e njeh e të cilët ende i vijnë në shtëpi dhe i kërcënohen. Këtë për arsye se i akuzuari N. qëllimisht e bën këtë që me dhunë ta detyrojë të mirret me tregti me drogë dhe mos t'i tregojë dikujt se ai mirret me drogë". Nga kjo deklaratë e dëshmitarit bashkëpunues rezulton se të gjithë të akuzuarit njihen, dhe përputhet me deklaratën e të akuzuarit F. T. se bashkarisht kanë qenë edhe në Rashka dhe Novi Pazar. Por, Gjykata nuk ka bërë vlerësimin e kësaj prove në lidhmëri me mbrojtjet e të akuzuarve. bën këtë që me dhunë ta detyrojë të mirret me tregti me drogë dhe mos t'i tregojë dikujt se ai mirret me drogë". Nga kjo deklaratë e dëshmitarit bashkëpunues rezulton se të gjithë të akuzuarit njihen, dhe përputhet me deklaratën e të akuzuarit F. T. se bashkarisht kanë qenë edhe në Rashka dhe Novi Pazar. Por, Gjykata nuk ka bërë vlerësimin e kësaj prove në lidhmëri me mbrojtjet e të akuzuarve.

Në aktgjykimin e ankimuar Gjykata gabimisht përdor termin dëshmitari anonim, sepse në rastin konkret deklarata e dëshmitarit të lexuar në seancën kryesore ishte e dëshmitarit bashkëpunues.

Prandaj, gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Me një gjendje të tillë faktike të vërtetuar në mënyrë jo të drejtë dhe të plotë, ka ardhur edhe deri te shkelja e ligjit penal.

Në rigjykim, Gjykata e Shkallës së Parë së pari duke vepruar sipas nenit 302 të KPPPK, të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre duhej t'i njoftojë me urdhrin e Gjykatës për të shpalljen për dëshmitar bashkëpunues, më pastaj në seancën kryesore pas dëgjimit të të gjithë të akuzuarve dhe administrimit të provave

ekzistuese dhe ato të propozuara, si dhe të provave të tjera për të cilat gjen të arsyeshme që t'i administrojë, të bëjë vlerësimin e duhur dhe logjik të provave të administruara në lidhmëri me mbrojtjet e të akuzuarve, dhe të merr vendim të drejtë sipas ligjit.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 424 të KPPPK.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Ap.nr.56/2005, datë 10.05.2005

Procesmbajtësja,  
Minire Xhambazi

Anëtarët e kolegjit,  
Gjuran Dema  
Hamdi Podvorica

Kryetari i kolegjit,  
Agim Krasniqi

**[Gjykata Supreme - aktvendim mbi Kodin Penal - neni 253 (1) pika 1 KPPK/ - neni 23 KPPK/ neni 291 (1) KPPK - shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm vjedhja e rëndë - ankesë për ndryshimin e dënimit shkelje esenciale e KPPK]**

*Prokurori i Qarkut në Mitrovicë paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë duke bërë pretendimin ankimor se dënimi i Gjykatës së Qarkut ishte tejet i butë dhe propozoi të shqiptoi një dënim më të rëndë.*

*Avokati mbrojtës paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë duke bërë pretendimin ankimor se Gjykata e Qarkut në aktvendimin e vet kishte shkelur dispozitat e kodit penal dhe të procedurës penale dhe kishte bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.*

*Të pandehurit janë shpallur fajtor për vepër penale të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm dhe vjedhje të rëndë dhe janë dënuar me dënim me kohëzgjatje prej pesë vjet e gjashtë muaj dhe me dënime financiare shtesë. Gjykata Supreme ka vendosur se vendimi i Gjykatës së Qarkut përmban kundërshtime të konsiderueshme që e bëjnë vendimin jo kredibil në aspektin juridik. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e avokatit mbrojtës është e bazuar.*

Ap.nr.57/2005

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Zait Xhemajli, kryetar, Miftar Jasiqi e Avdi Dinaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Mejreme Memaj, procesmbajtëse, në çështjen penale të të akuzuarve I. R. dhe N. D., për katër vepra penale të vjedhjes së rëndë parashikuar nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), dhe veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm parashikuar nga neni 291 par.1 lidhur me nenin 23 të të njëjtit Kod, duke vendosur për ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut Mitrovicë, ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve dhe ankesën e të akuzuarit N. D. të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Mitrovicë, P.nr.137/2004, datë 21.10.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur në përputhje me nenin 410 të KPPPK, më 29.06.2005, mori këtë

## A K T V E N D I M

Me aprovimin e ankesave të mbrojtësve të të akuzuarve I. R. dhe N. D. dhe asaj të të akuzuarit N. D., aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Mitrovicë, P.nr.137/2004, datë 21.10.2004, në pjesën gjykuese prishet dhe çështja i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim.

Kundër të akuzuarve I. R. dhe N. D. ndërpritet paraburgimi.

Ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut Mitrovicë, për tani, është jo lëndore.

## A r s y e t i m i

Gjykata e Qarkut Mitrovicë me aktgjykimin P.nr.137/2004 datë 21.10.2004, të akuzuarit I. R. dhe N. D. i ka shpallur fajtorë si bashkëkryes për katër vepra penale vjedhje e rëndë parashikuar nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPPK dhe veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.1 lidhur me nenin 23 të të njëjtit Kod dhe pasi ua ka përcaktuar dënimet veç e veç për secilën vepër i ka gjykuar me dënim unik me burgim secilin prej nga 5 (pesë) vjet e 6 (gjashhtë) muaj, në të cilin dënim ua ka llogaritur edhe paraburgimin prej 18.01.2004 e tutje. I ka obliguar që në emër të paushallit gjyqësor secili të paguajë shumën prej nga 150 € si dhe në mënyrë solidare shpenzimet e procedurës penale. Të dëmtuarit Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Komunale Mitrovicë, Gjykata Komunale Zubin Potok, U.N.-LCO dhe A. A. për realizimin e kërkesave pronësore-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Me të njëjtin aktgjykim i akuzuari I. R. në pajtim me dispozitën e nenit 390 par.3 të KPPK, është liruar nga akuza për vepër penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 183 par.1 të Ligjit Penal të Kosovës (LPK)

Kundër pjesës gjykuese të këtij aktgjykimi ankesa të afatshme kanë paraqitur:

- Prokurori Publik i Qarkut Mitrovicë për shkak të vendimit për dënimin me propozim që Gjykata Supreme ta ndryshojë atë, ashtu që të akuzuarve t'iu përcaktojë dënime më të larta për secilën vepër e pastaj t'iu shqiptojë dënim unik më të ashpër.

Mbrojtësi i të akuzuarit I. R., avokat Miodrag Brkljaq, për shkak të

shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, vendimit për dënimin

Dhe shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesës për dëmshpërblim me propozim që Gjykata Supreme ta prishë atë dhe çështjen t'ia kthejë Gjykatës së Shkallës së Parë në rigjykim ose ta ndryshojë përkritazi me cilësimin juridik të veprave,

- mbrojtësi i të akuzuarit N. D., avokat Miro Deleviq, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, dhe vendimit për dënimin me propozim që Gjykata Supreme ta ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar ashtu që të akuzuarin në mungesë të provave ta lirojë nga akuza ose ta prishë atë dhe çështjen t'ia kthejë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe

- i akuzuari N. D., për të njëjtat baza sikurse edhe mbrojtësi i tij me propozim që Gjykata Supreme ta ndryshojë atë ashtu që ta lirojë nga akuza ose ta prishë dhe çështjen t'ia kthejë Gjykatës së Shkallës së Parë.

Gjykata Supreme në pajtim me dispozitën e nenit 410 të KPPK e mbajti seancën e kolegjit në të cilën mbrojtësit e të akuzuarit sqaruan disa nga pretendimet e parashtruara në ankesa dhe ngelën pranë propozimeve të parashtruara në to. Njëherit edhe i akuzuari N. D. sqaroi disa nga pretendimet e parashtruara në ankesën e tij dhe duke i përkrahur pretendimet e propozimet e mbrojtësit të tij ngeli pranë propozimeve të parashtruara në ankesë. I akuzuari I. R. është pajtuar me qëndrimet e mbrojtësit të tij dhe propozimet e parashtruara nga ai. Prokurori Publik i Kosovës me parashtrësën PPA.nr.57/2005 datë 21.02.2005, ka propozuar që të aprovohet ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut Mitrovicë kurse ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve dhe ajo e të akuzuarit N. D. të refuzohen si të papabuzuara.

Gjykata Supreme i shqyrtoi shkresat e lëndës, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me nenin 415 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

Ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve dhe ajo e të akuzuarit N. D. pjesërisht janë të bazuara kurse ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut Mitrovicë për tani është jo lëndore.

Aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale parashikuar nga neni 403 par.1 pika 12 të KPPK, ngase dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin, në aktgjykim nuk janë paraqitur arsye lidhur me faktet vendimtare, për faktet vendimtare në aktgjykim ka kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e shkresave, ose procesverbaleve për deklarimet e dhëna në procedurë dhe vetë këtyre

shkresave dhe procesverbaleve, të cilat për tani e bëjnë atë të paqëndrueshëm në aspektin juridik.

Duke e arsyetuar gjendjen faktike të vërtetuar me aktgjykim, Gjykata e Shkallës së Parë ndër të tjera mbështetet në dëshminë e dëshmitarit R. H., duke konstatuar se ai ka pohuar se me rastin e bastisjes së garazhës së të akuzuarit I. R. në cilësinë e policit të autorizuar së bashku me policinë M. K. në mes sendeve të tjera kanë gjetur edhe një makinë shkrimi numri i së cilës i përgjigjet numrit të evidencës në Gjykatën Komunale Mitrovicë, pllakat e keramikës për të cilat vozitësi i Gjykatës Komunale Zubin Potok, V. N. ka vërtetuar se kanë qenë në automobilin "Llada Niva" të Gjykatës Komunale në Zubin Potok kur i janë vjedhur bashkë me automobilin në fjalë dhe pjesë të kompjuterëve me numra serik të cilat përputhen me dokumentacionin e Gjykatës Komunale Mitrovicë, nga rezultoni se ka vlerësuar se këto janë fakte që argumentojnë se të akuzuarit i kanë kryer veprat penale të vjedhjes së rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPPK të përshkruara në dispozitivin I/1, 2 dhe 3 të dispozitivit të aktgjykimit. Gjykata Supreme vlerëson se kjo nuk është në harmoni me të dhënat me dispozitiv të aktgjykimit ngase makina e shkrimit dhe as pllakat e keramikës në fjalë nuk janë të përshkruara si objekte inkriminimi të veprave penale në dispozitiv të aktgjykimit në fjalë. Duke pasur parasysh këtë dhe faktin se as aktakuza e Prokurorit Publik të Qarkut Mitrovicë, makinën e shkrimit dhe pllakat e keramikës në fjalë nuk i përmban si objekt në të cilat janë kryer veprat penale ngel dubioze se a rezultojnë këto apo jo nga vjedhjet në fjalë gjë që lypset të vërtetohet në rigjykim. I akuzuari për veprat e tjera penale V. N. në fazën e hetuesisë nuk ka dëshmuar asgjë për pllakat e keramikës në fjalë, kur dhe ku dhe si janë vjedhur ato kurse në seancën gjyqësore nuk është dëgjuar fare, nga rezultoni se kjo çështje nuk është ndriçuar në tërësi dhe as përkitazi me pronësinë e tyre. Pos thënieve në arsyetim të aktgjykimit se numrat serik në pjesët e kompjuterëve që janë gjetur në garazhën e të akuzuarit I. R. përputhen me dokumentacionin e Gjykatës nuk ka diç më konkrete në këtë drejtim, ngase siç rezultoni nga shkresat e lëndës nuk ka ndonjë evidencë me shkrim se cilat sende i ka gjetur dhe marrë dëshmitari, polici R. H. me rastin e bastisjes së garazhës në fjalë.

Automobili i markës "Llada-Niva" me targë regjistrimi EU-502 që është gjetur në garazhën e të akuzuarit I. R. më 18 janar 2004, është objekt i veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPPK, të përshkruar në dispozitivin nën I/5 të aktgjykimit për të cilin të akuzuarit si bashkëkryes janë shpallur fajtorë. Mirëpo, në aktgjykimin e ankimuar nuk janë dhënë arsye më konkrete dhe bindëse për kryerjen në bashkëveprim të kësaj vepre penale. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme për tani nuk është i qëndrueshëm konstatimi i Gjykatës së Shkallës së Parë se vetëm fakti "se meqë po atë natë 18.01.2004, diku rreth orës 3,00 të mëngjesit të akuzuarit janë zënë në Zvečan, ata në bashkëveprim e kanë kryer veprën penale në fjalë" ngase ai fakt nuk është provë e mjaftueshme për një konstatim

të tillë se kemi të bëjmë me bashkëveprim të kryerjes së veprës penale. Në dispozitiv, duhet të vihen në dukje të gjitha elementet të cilat veprimin e kryerjes së veprës penale e bëjnë bashkëveprues e që janë: uniteti i dashjes për vendimin e përbashkët të shumë personave që të kryejnë veprën penale, ndarjen e roleve në procesin e kryerjes së veprës dhe marrëveshjen për ta kryer atë dhe marrëveshjen e kryerjes së saj. Në rastin konkret për veprën penale të theksuar më lartë por as për veprat e tjera penale nuk ka asnjë fjalë në aktgjykim, nga rezultoni se aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale parashikuar nga neni 403 par.1 pika 12 të KPPK dhe atë e bëjnë të paqëndrueshëm.

Kundërthëniet dhe mangësitë e theksuara e rezultojnë të pavërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë çështje penale. Në radhë të parë me aktgjykimin e kundërshtuar rezultoni të jetë dubioze çështja e makinës së shkrimit që është gjetur në garazhën e të akuzuarit I. R. si njëra prej provave materiale a është apo jo ajo objekt inkriminimi i veprës penale, pasi si e tillë siç u theksua më lart nuk përshkruhet në dispozitiv të aktgjykimit, por as me atë të aktakuzës. Ngajshëm me këtë del edhe çështja përkitazi me pllakat e keramikës të gjetura në garazhën e të akuzuarit I. R. dhe pjesët e kompjuterëve, sepse vetëm dëshmia e dëshmitarit, policit R. H. se ato kanë qenë objekte nga veprat e theksuara penale, pa u deklaruar për këtë përfaqësuesit e Gjykatave në fjalë dhe V. N. në cilësinë e dëshmitarit nuk është provë e mjaftueshme për nxjerrjen e aktgjykimit gjykues siç ka vepruar Gjykata e Shkallës së Parë në rastin konkret.

Të gjitha këto sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme e bëjnë aktgjykimin e kundërshtuar juridikisht të paqëndrueshëm dhe si i tillë u desht të prishet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Në rigjykim Gjykata e Shkallës së Parë duhet t'i eliminojë të gjitha shkeljet e sipërpërmendura, të veprojë në pajtim me vërejtjet e cekura më sipër, t'i administrojë të gjitha provat e mëparshme si dhe të dëgjojë përfaqësuesit e Gjykatave të dëmtuara dhe në cilësi të dëshmitarit V. N. dhe të njëjtat t'i vlerësojë në pajtim me dispozitat përkatëse dhe mvarësisht nga rezultati i vlerësimit të provave të nxjerrë konkluzione të drejta, të ligjshme e të bazuara me provat e administruara e mandej të merr vendim përkatës, duke patur parasysh edhe pretendimet e tjera të cekura në ankesa.

Nga sa u tha më lart dhe në bazë të nenit 420 par.1 pika 3 dhe 424 par.1 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e theksuara, për tani ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut Mitrovicë është jo lëndore dhe si e tillë me këtë rast nuk është vlerësuar.

Në pajtim me dispozitën e nenit 420 par.6 të KPPPK, Gjykata Supreme ka vendosur për paraburgimin si në dispozitiv të këtij aktvendimi me aktvendim të posaçëm.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË  
Ap.nr.57/2005, datë 29.06.2005

Procesmbajtësja,  
Mejreme Memaj

Anëtarët e kolegjit,  
Miftar Jasiqi  
Avdi Dinaj

Kryetari i kolegjit,  
Zait Xhemajli

**[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Kodin Penal - neni 229 (1) 23 KPPK - blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike - ankesë për prishjen e aktgjykimit - dënimit apo lirimin e të akuzuarit - procedura penale, gjendja faktike, rrethanat lehtësuese - neni 34 KPPK]**

*Avokati mbrojtës paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë duke bërë pretendimin ankimor se Gjykata e Qarkut në aktvendimin e vet shkeli dispozitat e kodit penal dhe të procedurës penale dhe kishtë bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.*

*I pandehuri është akuzuar për blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar të drogave narkotike dhe substancave psikotropike, ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me 18 muaj burgim si dhe me ndëshkime financiare shtesë dhe me masa të sigurisë.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e Qarkut nuk kishte shkelur procedurën penale dhe se kishte vlerësuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike. Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e Qarkut nuk kishte vlerësuar në mënyrë të plotë rrethanat lehtësuese dhe si rrjedhojë kishte shqiptuar një dënim më të rëndë siç parashihet me nenin 34 të KPPK-së. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e avokatit mbrojtës është pjesërisht e bazuar.*

Ap.nr.62/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gjuran Dema, kryetar, Agim Krasniqi, Avdi Dinaj, Mr.sc.Fejzullah Hasani dhe Miftar Jasiqi, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Minire Xhambazi, procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzues A. G. D., nga qyteti Sllanca Prahova-Republika e Rumunisë, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike në bashkëkryerje nga neni 229 par.4 nën par.1 lidhur me nenin 23 të KPPK (Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës), duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të akuzuarës, avokatit Hasan Jashari, nga Prishtina, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P.nr.394/2004 të datës 09.12.2004, në seancën e mbajtur konform dispozitës së nenit 410 të KPPPK (Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës), më datën 21.04.2005, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e pjesshëm të ankesës të mbrojtësit të të akuzuarës A. G. D., aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.nr.394/2004 i datës 09.12.2004, ndryshohet vetëm përkitazi me vendimin për dënimin, ashtu që Gjykata Supreme të akuzuarën për veprën penale për të cilën është shpallur fajtores e gjykon me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, kurse dënimi me gjobë mirret si i vërtetuar.

### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.nr.394/2004 të datës 09.12.2004, e akuzuara A. G. D. është shpallur fajtores për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike në bashkëkrerje nga neni 229 par.4 nën par.1 lidhur me nenin 23 të KPPK, dhe është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muajë dhe me gjobë prej 1.500 €, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 19.05.2004 e tutje.

Narkotikët dhe substancat psikotropike janë konfiskuar.

Të akuzuarës i është shqiptuar edhe dënimi plotësues-dëbimi i të huajve nga territori i Kosovës në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

E akuzuara është obliguar që t'i paguaj shpenzimet procedurale sipas llogarisë së Gjykatës dhe paushalin gjyqësor në shumë prej 100 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarës për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të priset dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, ose të ndryshohet dhe e akuzuara të lirohet nga akuza në mungesë provash. Në ankesë ka propozuar që së bashku me të mbrojturën e vet të njoftohen për seancën e Kolegjit.

Gjykata Supreme e mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 410 të KPPPK, ku mbrojtësi i të akuzuarës dha ca sqarime nga thëniet e ankesës dhe mbeti në propozimet e bëra në te, kurse e akuzuara pranoi thëniet e mbrojtësit të vet.

Prokurori Publik i Kosovës i njoftuar me rregullë për seancën e kolegjit

nuk ishte prezentë, por me parashtrësën e vet PPA.nr.62/2005 datë 15.02.2005, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të të akuzuarës të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata Supreme pas shqyrtimit të shkresave të lëndës studioi aktgjykimin e ankimuar në bazë të nenit 415 të KPPPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, gjeti se:

Ankesa pjesërisht është e bazuar.

Aktgjykimi i ankimuar nuk përmbanë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse i njëjti përmbanë arsye mbi faktet vendimtare në këtë çështje juridiko-penale dhe është në përputhje me përmbajtjen e shkresave dhe të procesverbaleve, të administruara si prova dhe të trajtuara në mënyrë të drejtë.

Gjykata drejtë ka vlerësuar mbrojtjen e të akuzuarës në kontekst të të gjitha provave të administruara, duke dhënë përfundime të qarta dhe të drejta.

Prandaj, në këtë drejtim ankesa është e pabazuar.

Gjendja faktike me aktgjykimin e ankimuar në këtë çështje juridiko-penale është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë me vlerësim të drejtë të mbrojtjes të të akuzuarës dhe provave tjera të administruara veç e veç dhe në lidhmëri njëra me tjetrën, drejtë duke përfunduar se e akuzuara në marrëveshje paraprake me të pandehurit A. T. dhe A. Sh. kishin marrë substanca narkotike-heroinë, të paketuara në dy pako me neto peshë njëra pako me peshë prej 490 gr e tjetra me peshë prej 472 gr, me peshë të përgjithshme neto të heroinës prej 962 gr, të konstatuar nga ana e Institutit të Kriminalistikës në Republikën e Bullgarisë-Sofije në raportin e tyre Nr.H-600 të datës 06.08.2004, ku është konstatuar se përbërja e këtyre dy pakove është substance narkotike heroinë, e cila është e ndaluar të prodhohet apo të përdoret legalisht dhe është nën kontrollë sipas Konventës të Përbashkët të KB-së të vitit 1961 për substanca toksike (lista 1) dhe Konventës të KB-së të vitit 1988. E akuzuara këto pako i ka pasur në trup brenda veshjes së saj, ashtu që gjatë kontrollimit në Aeroportin e Prishtinës në pikën kontrolluese X-Rej (detektor elektrik rezatues për kontrollë) ka treguar se në trupin e saj qëndron diq e dyshuar. Pas kontrollimit nga ana e Policisë është vërtetuar se në ato dy pako gjendet heroina.

Me aktgjykimin e ankimuar drejtë është përfunduar se e akuzuara në marrëveshje paraprake me të pandehit A. T. dhe A. Sh., me dashje, i ka marrë pakot me narkotikë me vehte me qëllim shitjeje dhe përfitim material. Së këndejmi drejtë janë vlerësuar të gjitha provat e administruara së bashku me mbrojtjen e të akuzuarës veç e veç dhe në lidhmëri njëra me tjetrën dhe drejtë është përfunduar se të gjitha veprimet e të akuzuarës kanë qenë të ndërmarra me vetëdije dhe qëllim për të ardhur deri te përfitimi material, pra me dashje

direkte. Prandaj, në këtë drejtim ankesa është e pabazuar.

Me një gjendje të tillë faktike të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, drejtë është përfunduar se në veprimet e të akuzuarës A. G. D. ekzistojnë të gjitha elementët e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par.4 nën par.1 lidhur me nenin 23 të KPPK, meqë këtë veprë e ka kryer në bashkëkryerje së bashku me të pandehurit A. T. dhe A. Sh.. Prandaj, në këtë drejtim ankesa është e pabazuar.

Duke vlerësuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata Supreme se rrethanat lehtësuese të konstatuara nuk janë vlerësuar në masë të duhur, e ato: se më parë nuk ka qenë e gjykuar, se është nënë e një fëmiu, gjendjen e varfër ekonomike të saj dhe sjelljet e saja korekte, sidomos rrethana se është nënë e një fëmiu të mitur e në kontekst të gjendjes së varfër ekonomike, prandaj i shqiptoi dënim nën minimumin e paraparë ligjor dhe e gjykoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 19.05.2004, kurse dënimin me gjobë e muarë si të vërtetuar, me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet intenzitetit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarës dhe do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 34 të KPPK. Prandaj, në këtë drejtim ankesa është e bazuar.

#### GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ap.nr. 62/2005, datë 21.04.2005

Procesmbajtëse,  
Minire Xhambazi

Anëtarët e kolegjit  
Agim Krasniqi  
Avdi Dinaj  
Mr.sc.Fejzullah Hasani  
Miftar Jasiqi

Kryetari i kolegjit,  
Gjuran Dema

#### **Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Kodin Penal - neni 328 (2) KPPK mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve - ankesë për ndryshimin e dënimit - rrethanat që ndikojnë në llojin dhe kohëzgjatjen e dënimit - neni 41 LPJ**

*Prokurori i Qarkut në Mitrovicë paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë duke bërë pretendimin ankimor se dënimi i Gjykatës së Qarkut ishte tejet i butë dhe propozoi të shqiptoi një dënim më të rëndë.*

*Të pandehurit janë akuzuar me marrje në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve ishin shpallur fajtor dhe ishin dënuar me gjobë.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e Qarkut kishë bërë vlerësimin e drejtë të rrethanave rënduese dhe lehtësuese siç parashihet me nenin 41 të LPJ-së Gjykata Supreme ka vendosur se lloji dhe kohëzgjatja e dënimit të shqiptuar nga Gjykata e Qarkut ishin adekuate. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e avokatit mbrojtës është e pabazë.*

Ap.nr.71/2005

#### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - Kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gjuran Dema, kryetar kolegji, Riza Loci e Agim Krasniqi, anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Mejreme Memaj, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarve E. H., D. H. e A. H. që të tretë nga fsh. Vinarc i ulët, komuna e Mitrovicës, për veprën penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 al.2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut-Mitrovicë dhe përgjigjes në ankesë të mbrojtësit të të akuzuarve, paraqitur kundër aktgjykimin të Gjykatës së Qarkut-Mitrovicë, P.nr.47/01 datë 9.12.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 5.04.2005, mori këtë:

#### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut-Mitrovicë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut-Mitrovicë, P.nr.47/2001 datë 9.12.2004, vërtetohet.

## A r s y e t i m

Gjykata e Qarkut - Mitrovicë, me aktgjykimin P.nr.47/2001 datë 9.12.2004, të akuzuarit E. H., D. H. dhe A. H., secilin veç e veç i ka shpallur fajtor për veprën penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 al. 2 të KPPK-ës i ka gjykuar të akuzuarin E. H. me dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) eurove, të akuzuarin D. H. me dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) eurove dhe A. H. me dënim me gjobë në shumë prej 700 (shtatëqind) euro, secili prej tyre këto shuma obligohen ti paguajnë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi e në rast të mos pagesës i njëjti do tu zëvendësohet me dënim burgu duke iu llogaritur çdo ditë e kaluar në burg me 15 (pesëmbëdhjetë) euro. Janë obliguar që secili veç e veç në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 50 (pesëdhjetë) eurove dhe shpenzimet e procedurës penale në mënyrë solidare sipas listës definitive të Gjykatës.

Të akuzuarit E. H. i është marrë revolva e markës "TT-M-57", e kal.7.63mm, me nr.serik 62456, 53 fishekë të kal.7.62mm. Të akuzuarit D. H. granta e dorës defansive "F11" prodhim i ish BRSS, 8 (tetë) fishekë të kal.7.65mm dhe 4 fishek të kal.6.35mm, dhe nga i akuzuari A. H. pushka e markës "Mauzer-48" me nr.serik 19723, 76 fishek të kal.7mm dhe 56 fishekë të kal.6.35mm.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë Prokurori Publik i Qarkut-Mitrovicë, për shkak të vendimit për dënim me propozim që Gjykata Supreme ta ndryshon aktgjykimin e ankimuar vetëm sa i përket vendimit për dënim ashtu që të akuzuarve tu shqiptohet dënim më i ashpër.

Përgjigje në ankesën e Prokurorit ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarve av. Zenel Ademi nga Mitrovica, me propozim që ankesa e Prokurorit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës mbajti seancën e kolegjit në të cilën edhe pse i njoftuar me rregull nuk mori pjesë Prokurori Publik i Kosovës por me parashtrësën me shkrim PPA.nr.71/2005 datë 15.02.2005, ka propozuar që ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut-Mitrovicë, të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet vetëm mbi vendimin për dënim ashtu që të akuzuarve tu shqiptohet dënim me burg.

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e ankimuar konform dispozitës së nenit 376 të LPP-ës, vlerësoi pretendimet ankimore në ankesë dhe përgjigjes në ankesë dhe konstatoi se:

- ankesa nuk është e bazuar.

Aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë nuk përmban shkelje genësore të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit për të cilat kjo Gjykatë në bazë të nenit 376 të LPP-ës, kujdeset detyrimisht.

Po ashtu në ankesë aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë nuk ankimohet për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, prandaj në këtë aspekt aktgjykimi i ankimuar nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, prandaj u vlerësua lidhur me pretendimet ankimore.

Në ankesë prokurori pretendon se Gjykata e Shkallës së Parë me rastin e caktimit të masës së dënimit nuk i ka vlerësuar drejtë dhe në mënyrë të plotë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Konsideron se Gjykata gabimisht vlerëson se në anën e të akuzuarve nuk ka rrethana rënduese ndërsa, sipas ankesës si rrethanë rënduese është dashur të vlerësohet rrezikshmëria shoqërore e veprës penale dhe fakti se këto lloj veprash ne treven e kësaj Gjykate janë në rritje të dukshme.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet ankimore të mësipërme janë të pabazuara. Gjykata e Shkallës së Parë drejt dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat që në kuptim të dispozitës së nenit 41 të LPJ-ës, që ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësinë e dënimit dhe rrethanat e rastit konkret. Rrezikshmëria shoqërore sipas vlerësimit të kësaj Gjykate është element i veprës penale ashtu si me të drejtë cekë mbrojtësi i të akuzuarve në përgjigjen e dhënë ndaj ankesës së prokurorit, ndërsa meqë në ankesë nuk ceket ndonjë rrethanë tjetër rënduese në anën e të akuzuarve, e as që kjo Gjykatë gjen, pretendimet që të akuzuarve tu shqiptohen dënime më të ashpra janë të pabazuara. Dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve i përgjigjen rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësive penale të të akuzuarve dhe me dënimet e shqiptuara kjo Gjykatë është e bindur se do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat përkatëse ligjore.

Nga sa u tha më lartë e në kuptim të dispozitës së nenit 384 të LPP-ës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË  
Ap.nr. 71/2005, datë 5.04.2005

Procesmbajtësja  
Mejreme Memaj

Kryetari i kolegjit  
Gjuran Dema

**[Gjykata Supreme - aktvendim mbi Kodin Penal - neni 139 (1) KPPK/ neni 25 KPPK - trafikimi me njerëz - ankesë për ndryshimin e dënimit rrethanat lehtësuese]**

*Prokurori i Qarkut në Gjilan paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan duke bërë pretendimin ankimor se dënimi i Gjykatës së Qarkut është tejte i butë dhe propozoi të shqiptoi një dënim më të rëndë.*

*Avokati mbrojtës paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, duke bërë pretendimin ankimor se Gjykata e Qarkut në aktvendimin e vet kishte shkelur kodin penal dhe të procedurës penale dhe se kishte bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.*

*Të pandehurit ishin akuzuar për vepër penale të trafikimit me njerëz, ishin shpallur fajtor dhe ishin dënuar me 2 vjet dhe me 2 vjet e 6 muaj burgim si dhe me ndëshkime financiare shtesë dhe me masa të sigurisë. Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak se një gjendje tjetër faktike ishte vërtetuar ndryshe nga përshkrimi faktik i veprimeve të të akuzuarit. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e avokatit mbrojtës është pjesërisht e bazuar.*

Ap.nr.89/2005

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gjuran Dema, kryetar kolegji, Agim Krasniqi dhe mr.sc.Fejzullah Hasani, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Mejreme Memaj, procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarve G. L., për shkak të veprës penale trafikimi me njerëz nga neni 139 par.1 të KPPK (Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës) dhe N. L., për shkak të veprës penale trafikimi me njerëz nën ndihmë nga neni 139 par.1 lidhur me nenin 25 të KPPK, duke vendosur sipas ankesave: të Prokurorit Publik të Qarkut në Gjilan dhe mbrojtësve të të akuzuarve, av. Nasuf Nasufi dhe Shemsedin Piraj, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr.109/2004 datë 28.10.2004, në seancën e Kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 410 të KPPK, më 24.05.2005, mori këtë

**A K T G J Y K I M**

I. Me pranimin e pjeshëm të ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit G. L. dhe sipas detyrës zyrtare, aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr.109/2004 i datës 28.10.2004, në pjesën nën I. të dispozitivit ndryshohet vetëm përkitazi me vendimin për llogaritjen e paraburgimit, ashtu që Gjykata Supreme të akuzuarit G. L., në dënimin e shqiptuar me burg në kohëzgjatje prej 2

(dy) vitesh, ia llogarit kohën e kaluar në paraburgim prej datës 26.06.2004 deri më datë 28.10.2004.

II. Pranohet si e bazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit N. L., kurse aktgjykimi i përmendur në pikën nën II. të këtij aktgjykimi përkitazi me të akuzuarin N. L., sikurse edhe masa e sigurisë konfiskimi i parave dhe ajo e shqiptimit të masës së ndalimit të ushtrimit të profesionit, shpenzimeve procedurale dhe të paushallit gjyqësor, prishen dhe lënda në këtë pjesë kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë në rigjykim.

III. Ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Gjilan refuzohet si e pabazuar.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan P.nr.109/2004 datë 28.10.2004, të akuzuarit G. dhe N. L., janë shpallur fajtor dhe atë i akuzuari i parë për shkak të veprës penale trafikimi me njerëz nga neni 139 par.1 të KPPK, dhe i akuzuari i dytë për shkak të veprës penale trafikimi me njerëz nga neni 139 par.1 lidhur me nenin 25 të KPPK, dhe janë gjykuar: i akuzuari i parë me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, i akuzuari i dytë me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj. Kundër të akuzuarit N. L. janë shqiptuar: masa e sigurisë konfiskimi i parave 3.300 €, 442 \$ dhe 110 CHF, dhe masa e ndalimit të ushtrimit të profesionit dhe veprimtarisë hoteliere në restorantin "Leka N.", në kohëzgjatje prej 1 viti, e cila masë i llogaritet nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, koha e kaluar në paraburgim nuk i llogaritet në shqiptimin e dënimit. Të akuzuarit janë obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë nga 50 € dhe në mënyrë solidare t'i kompensojnë shpenzimet procedurale sipas llogarisë së Gjykatës, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesa kanë paraqitur:

- Prokurori Publik i Qarkut në Gjilan për shkak të vendimit për dënim, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet përkitazi me vendimin për dënimin ashtu që të akuzuarve t'iu shqiptohen dënim më të mëdha,

- mbrojtësi i të akuzuarit G. L., për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të prishet dhe lënda t'i kthehet të njëjtës Gjykatë në rigjykim,

- mbrojtësi i të akuzuarit N. L., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar

dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të prishet dhe lënda të kthehet në rigjykim, ose të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i butë, dhe ka parashtruar edhe përgjigje në ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut në Gjilan, ku ka propozuar që e njëjta ankesë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 410 të LPP, ku ishin prezent i akuzuari N. L. dhe mbrojtësi i tij i cili dha ca sqarime nga thëniet e theksuara në ankesë dhe në përgjigjen e dhënë në ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut në Gjilan, duke mbetur në pretendimet e bëra në ato, i akuzuari i pranoi thëniet e mbrojtësit të tij, kurse nuk ishin prezent i akuzuari G. L. dhe mbrojtësi i tij, si dhe Prokurori Publik i Kosovës, të cilët kanë qenë të njoftuar me rregull.

Prokurori Publik i Kosovës me parashtrësën e vet PPA.nr.89/2005 datë 17.02.2005, ka propozuar që ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Gjilan, të pranohet si e bazuar, kurse ato të mbrojtësve të të akuzuarve të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme i shqyrtoi shkresat e lëndës, studioi aktgjykimin e ankimuar konform dispozitës së nenit 415 të KPPPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të përgjigjes në ankesë, gjeti se:

Ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit G. L. pjesërisht është e bazuar, ajo e mbrojtësit të të akuzuarit N. L. është e bazuar, kurse ajo e Prokurorit Publik të Qarkut në Gjilan është e pabazuar.

Aktgjykimi i ankimuar përkitazi me të akuzuarin G. L. nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale me të cilat kjo Gjykatë kujdeset detyrimisht konform dispozitës së nenit 415 par.1 pika 1-3 të KPPPK.

Gjendja faktike në këtë çështje penale përkitazi me të akuzuarin G. L. është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, sidomos me deklaratat e qarta dhe shumë konkrete të të dëmtuarës J. K. dhe të dëshmitarit E. A., nga të cilat është vërtetuar në mënyrë të padyshimtë se ditën kritike, pra më datë 26.06.2004, në restorantin "Leka N.", i akuzuari G. dëshmitarit E. A. paraprakisht ia cakton terminin, pra ditën kritike për të cilin e cakton që J. K. të ketë marrëdhënie seksuale, në lokalet e këtij restoranti, për të cilin shërbim nga dëshmitari E. A. merr 10 €, ndërkaq i njëjti dëshmitar të dëmtuarës paraprakisht ia jep 50 €, të cilat para kanë qenë të fiksuara dhe e njëjta banknotë prej 50 € me nr. X 10669661804 gjithashtu është gjetur. Pasi që së pari e dëmtuara J. K. shkon në dhomën e caktuar e më pastaj një person e fton dëshmitarin E. A. që edhe ky të shkojë në dhomë, me ç'rast e dëmtuara zhvishet deri në brez e njëkohësisht kërkon që edhe dëshmitari E. të zhvishet, i cili kinse me qëllim që ta lajmërojë shokun e vet me telefon që më vonë të vjen me e marrë me veturë, e njofton, meqë paraprakisht ishte përgatitur plani për

zbulimin e rastit në këtë lokal, me ç'rast vjen policia, bënë bastisjen dhe i privon nga liria. Me aktgjykimin e ankimuar përkitazi me të akuzuarin G. L. janë vlerësuar të gjitha provat veç e veç e në lidhmëri me mbrojtjen e të akuzuarit, si dhe të gjitha sëbashku, duke dhënë arsye të bindshme përse Gjykata nuk e pranon mbrojtjen e të akuzuarit, e konform dispozitës së nenit 396 pika 7 të KPPPK. Prandaj, në këtë drejtim ankesa është e pabazuar.

Me vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike edhe ligji penal drejt është zbatuar kur është përfunduar se në veprimet e të akuzuarit G. L. formohen të gjitha elementët e veprës penale trafikimi me njerëz nga neni 139 par.1 të KPPPK, për të cilën veprë edhe është shpallur fajtor. Prandaj, në këtë drejtim ankesa është e pabazuar. Mirëpo, Gjykata Supreme duke vendosur sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 415 par.1 pika 4 lidhur me nenin 404 par.1 pika 6 të KPPPK, gjen se në dëm të akuzuarit G. L. është shkelur ligji penal dhe atë neni 73 të KPPK, sepse në dënimin e shqiptuar nuk i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim, ashtu që kjo Gjykatë në dënimin e shqiptuar të akuzuarit G. L. ia llogarit kohën e kaluar në paraburgim prej datës 26.06.2004 deri më datë 28.10.2004.

Duke e vlerësuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin për dënimin, kjo Gjykatë i pranon të gjitha rrethanat e konstatuara dhe drejt të vlerësuar për të akuzuarin G. L., se është i ri, i papunë, gjer më tani i pagjykuar, si rrethana lehtësuese, dhe prej rrethanave rënduese se këto vepra penale në Kosovë janë në rritje e sipër, kurse rrethanën se me kryerjen e veprës ka dasht me përfitu pasuri të kundërligjshme, duke shfrytëzuar pozitën e rëndë të dëmtuarës, këto përbëjnë elementët e veprës penale, prandaj si të tilla nuk mund të qëndrojnë. Mirëpo, kjo Gjykatë nuk gjeti ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese e cila kishte me ndiku në lartësinë e dënimin, prandaj, dënimi i shqiptuar për të akuzuarin G. L. me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, në të cilin i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 26.06.2004 deri më 28.10.2002, është në përputhje edhe me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe të përgjegjësisë penale të të akuzuarit, dhe mund të pritet se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimin i paraparë me dispozitën e nenit 34 të KPPK.

Ndërsa, aktgjykimi i ankimuar përkitazi me të akuzuarin N. L. përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse dispozitivi përkitazi me këtë të akuzuar është i pakuptueshëm, kundërtshënës, sidomos kur thuhet se: "i akuzuari me dashje i ka ndihmuar në trafikimi me njerëz, me qëllim të shfrytëzimit seksual të dëmtuarën J. K.", e cila thënie nuk përkon me elementët e veprës penale. Në këtë pjesë aktgjykimi përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 403 par.1 pika 12 të KPPPK, prandaj ankesa në këtë drejtim është e bazuar.

Edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, sepse për këtë të akuzuar është vërtetuar një gjendje tjetër faktike

krahasuar me përshkrimin faktik të veprimeve të të akuzuarit në dispozitivin nën II të aktgjykimit të ankimuar, meqë Gjykata ka vërtetuar se i akuzuari N. L. ka vënë në dispozitim dhomën e lokalit të tij për trafikim, për të cilin shërbim ka marrë 15 €. Mirëpo, ky konstatim është në kundërshtim me përshkrimin faktik të veprës penale në dispozitivin nën II të aktgjykimit të ankimuar ku thuhet se i akuzuari ka ndihmuar me dashje në trafikim me njerëz, me qëllim të shfrytëzimit seksual të dëmtuarën J. K.. I akuzuari kursesi nuk ka mundur me i ndihmu të dëmtuarës J. K. që ta kryejë veprën penale, sikurse gabimisht është konstatuar në dispozitivin nën II, ndërsa në arsyetim janë dhënë krejtësisht arsye të tjera. Së këndejmi, Gjykata nuk ka bërë edhe vlerësimin e provave veç e veç dhe në lidhmëri me mbrojtjen e të akuzuarit N. L. konform dispozitës së par.7 të nenit 396 të KPPPK. Prandaj, në këtë drejtim ankesa është e bazuar.

Me një gjendje të tillë të vërtetuar faktike në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë, ka ardhur deri te shkelja e ligjit penal, sepse kjo Gjykatë për tani nuk mund të pranojë përfundimin e Gjykatës së Shkallës së Parë se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementët e veprës penale trafikimi me njerëz në ndihmë nga neni 139 par.1 lidhur me nenin 25 të KPPK. Prandaj, në këtë drejtim ankesa është e bazuar.

Në rigjykim, Gjykata e Shkallës së Parë, përkitazi me të akuzuarin N. L., pas administrimit të të gjitha provave dhe vlerësimit të tyre veç e veç dhe të mbrojtjes së të akuzuarit, edhe të gjitha së bashku, duke pasur parasysh edhe pretendimet e tjera ankimore, të bëj vlerësim të drejtë se në veprimet e të akuzuarit a formohen elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar apo eventualisht të ndonjë vepre tjetër penale dhe të merr vendim sipas ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 426 dhe 425 të KPPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË  
Ap.nr. 89/2005, datë 24.05.2005

Procesmbajtësja,  
Mejreme Memaj

Anëtarët e kolegjit,  
Agim Krasniqi  
Mr.sc.Fejzullah Hasani

Kryetari i kolegjit  
Gjuran Dema

**[Gjykata Supreme - aktvendim mbi Kodin Penal - neni 328 (2) KPPK mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve - ankesë për ndryshimin e dënimit]**

*I pandehuri paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan duke bërë pretendimin ankimor se Gjykata e Qarkut në aktvendimin e vet kishte shkelur dispozitat e kodit penal dhe të procedurës penale dhe se kishte bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.*

*I pandehuri ishte akuzuar për marrje në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve, ishte shpallur factor dhe ishte dënuar me 6 muaj burgim.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se i akuzuari u deklarua fajtor; shqyrtimi kryesor do të vazhdojë me fjalën përfundimtare siç parashihet me nenin 359 paragrafin 5 të KPPPK-së. Gjykata Supreme ka vendosur se gjykata e shkallës së parë nuk i është përmbajtur këtyre instituteve juridike dhe i ka injoruar ato sikurse të mos ekzistonin fare. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e të akuzuarit është pjesërisht e bazuar.*

Ap.nr.91/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gjuran Dema, kryetar, Riza Loci dhe mr.sc.Fejzullah Hasani, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Minire Xhambazi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit H. M. nga fshati Lipovicë, komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve parashikuar me nenin 328 par.2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), duke vendosur për ankesën e të akuzuarit të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan P.nr.139/04 datë 6 janar 2005, në seancën e kolegjit të mbajtur më 21 qershor 2005, mori këtë:

A K T V E N D I M

Me rastin e ankesës së të akuzuarit H. M. dhe sipas detyrës zyrtare aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan P.nr.139/04 datë 6 janar 2005 anulohet dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë për rigjykim.

## A r s y e t i m i

Gjykata e Qarkut në Gjilan, me aktgjykimin Pnr.139/04 datë 6 janar 2005 të akuzuarin H. M., e ka shpallur fajtor për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPPK-së dhe për këtë veprë e ka gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh. E ka obliguar që t'i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale dhe 100 € në emër të paushallit gjyqësor, njëherit i është sekuestruar pushka e llojit karabin prodhimi jugosllav M-C Zastava, të kalibrit 8,57 mm me nr.serik 178810 së bashku me 3 fishekë.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka paraqitur i akuzuari, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit për dënimin, me propozim që Gjykata Supreme aktgjykimin e ankimuar ta anulojë dhe çështjen ta kthejë për rigjykim ose ta ndryshojë përkritazi me vendimin për dënimin, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptojë një dënim me kusht.

Për seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 410 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK) janë njoftuar Prokurori Publik i Kosovës, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, mirëpo nuk morën pjesë në seancën e kolegjit. Por, Prokurori Publik i Kosovës, me shkresën PPA.nr.91/05 datë 14 shkurt 2005 propozoi që ankesa e paraqitur të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 415 të KPPPK-së dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

- aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kushtëzojnë prishjen e tij.

Sipas shkresave të kësaj çështje penal-juridike rezulton se i akuzuari në seancën e konfirmimit të aktakuzës të mbajtur më datë 30 nëntor 2004 ka pranuar fajësinë. Një pranim të tillë të fajësisë për çdo pikë të akuzës i akuzuari e ka përsëritur edhe në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më 6 janar 2005. Në raste të tilla, pra si rastin konkret, konform dispozitës së nenit 359 par.5 të KPPPK pas deklarimit të akuzuarit menjëherë shqyrtimi gjyqësor vazhdon me fjalën përfundimtare të palëve. Pra, nuk zbatohet procedura e të provuarit, nuk administrohen provat, nuk kërkohet deklarimi i të akuzuarit përkritazi me gjendjen e fakteve të ngjarjes kritike. Kështu, substrati faktografik i ngjarjes nuk është objekt vlerësimi as i Gjykatës së Shkallës së Parë, e as i asaj të shkallës së dytë, sepse konform nenit 402 par.2 të KPPPK kundër aktgjykimin kur i akuzuari ka pranuar fajësinë e trupi gjykues është pajtuar me një pohim të tillë, nuk mund të ushtrohet ankesë përkritazi me bazën ankimore vërtetimi i

gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike. Kjo do të thotë se i akuzuari nuk ka pasur të drejtë të paraqesë ankesë përkritazi me këtë bazë ankimore.

Mu në rrethanat e sipërcekura manifestohet rëndësia e institucionit juridik të seancës për konfirmimin e aktakuzës dhe mundësisë së të akuzuarit për deklarim për fajësinë në shqyrtimin gjyqësor. Në rastin konkret Gjykata e Shkallës së Parë fare nuk i ka përfillur këto institute, për më tepër i ka injoruar sikur të mos ishin, sepse në shqyrtimin gjyqësor jo vetëm që janë administruar të gjitha provat, por ato në aktgjykimin e ankimuar janë vlerësuar, në anën tjetër i akuzuari është marrë në pyetje para prezantimit të provave.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shklejes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata Supreme të njëjtin e vlerësoi edhe në këtë aspekt sipas detyrës zyrtare, në pajtim me dispozitën e nenit 415 të KPPPK dhe konstatoi se i njëjti, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e sipërcekura përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parashikuara nga neni 403 par.1 pika 12 të KPPK, sepse për faktet vendimtare ka kundërthënë të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimin dhe vetë shkresave dhe procesverbaleve. Po ashtu, përmban edhe shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 403 par.2 pika 1 të KPPPK.

Prandaj, nga arsyet e sipërcekura aktgjykimi i ankimuar nuk mund të qëndrojë, nuk është marrë në harmoni me dispozitat ligjore dhe si i tillë është dashtë që të anulohet neni 424 të KPPPK.

Në rigjykim Gjykata e Shkallës së Parë duhet të veprojë në pajtim me vërejtjet e sipërcekura dhe varësisht nga rezultati i procedurës të merr vendim përkatës të ligjshëm.

Nga sa u tha më lart, e në pajtim me dispozitën e nenit 424 të KPPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË  
Ap.nr.91/05, datë 21.6.2005

Procesmbajtësja,  
Minire Xhambazi

Anëtarët e kolegjit:  
Riza Loci  
Mr.sc.Fejzullah Hasani

Kryetari i kolegjit,  
Miftar Jasiqi

**[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Kodin Penal - neni 244 (1) KPPK prodhimi i parave të falsifikuara - ankesa e tërhequr nga prokurori publik i Kosovës]**

*Prokurori i Qarkut në Gjilan paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan duke bërë pretendimin ankimor se Gjykata e Qarkut në aktvendimin e vet kishte shkelur dispozitat e kodit penal dhe të procedurës penale dhe se kishte bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. I akuzuari ishte akuzuar për prodhim të parave të falsifikuara dhe ishte liruar nga Gjykata e Qarkut.*

*Prokurori Publik i Kosovës e tërhoqi ankesën. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e prokurorit të qarkut është e pabazuar.*

Ap.nr.100/2005

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Zait Xhemajli, kryetar, Miftar Jasiqi dhe Avdi Dinaj, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarit H. H. nga Gjilani, për veprën penale falsifikim i parave nga neni 244 par.1 të KPPK duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut në Gjilan, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr.62/2004 datë 29.07.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur me 05.04.2005, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Hidhet si e palejueshme ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Gjilan, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr.62/2004 datë 29.07.2004.

**A r s y e t i m i**

Gjykata e Qarkut në Gjilan, me aktgjykimin P.nr.62/2004 datë 29.07.2004, të akuzuarin H. H. nga Gjilani e ka liruar nga akuza për veprën penale falsifikim i parave nga neni 244 par. 1 të KPPK.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të

gjykatës.

Ndaj të akuzuarit është shqiptuar masa e sigurisë marrja e bankënotës në apoën prej 50 euro me numër serik P00751070073

Kundër këtij aktgjykimi ka paraqitur ankesë Prokurori Publik i Qarkut në Gjilan, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Në përgjigje ndaj ankesës së Prokurorit Publik në Gjilan, mbrojtësi i të akuzuarit propozon që ankesa e PPQ Gjilan të refuzohet si e pabazuar.

Në përputhje me dispozitat e LPP, ankesa së bashku me shkresat e lëndës i është dërguar Prokurorisë Publike të Kosovës, e cila, përkitazi me këtë çështje juridiko-penale, me parashtresën PPA.nr.100/2005 datë 24.02.2005, njoftoi Gjykatën se heq dorë nga ushtrimi i ankesës.

Meqë Prokuroria Publike e Kosovës e ka tërhequr ankesën, Gjykata Supreme, në pajtim me dispozitën e nenit 383 të LPP, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË**

Ap.nr.100/2005, datë 05.04.2005

Procesmbajtësja,  
Ajna Gashi

Kryetari i kolegjit  
Zait Xhemajli

**[Gjykata Supreme - aktvendimi mbi Kodin e Procedurës Penale - neni 146 (1), neni 20- vrasja - nenet 8.2, 8.6 rregullorja e UNMIK-ut 2001/7 mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paaautorizuar të armëve - ankesa për prishjen/ndryshimin e aktgjykimit dispozitat e procedurës penale, gjendja faktike dhe ligjore, vendimi për dënim - neni 403 para. 1 p. 12 KPPPK]**

*Avokati mbrojtës paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan duke bërë pretendimin ankimor se Gjykata e Qarkut në aktvendimin e vet kishte shkelur dispozitat e kodit penal dhe të procedurës penale, dhe kishte bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.*

*I pandehuri ishte shpallur fajtor për marrje në pronësi, kontroll, posedim, dhe shfrytëzim të paaautorizuar të armëve, ishte shpallur fajtor, dhe ishte dënuar me 1vjet dhe 10 muaj burg.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e Qarkut nuk kishte shkelur procedurën penale dhe kishte vlerësuar drejtë gjendjen faktike. Gjykata Supremeka vendosur se qëllimi i dënimit do të mund të arrihej me një dënim më të butë. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e avokatit mbrojtës është pjesërisht e bazuar.*

Ap.nr. 102/2005

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, Kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Miftar Jasiqi, Kryetar i Kolegjit, Avdi Dinaj, Fejzullah Hasani dhe Hamdi Podvorica, anëtarë të Kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Mejreme Memaj, procesëmbajtës, në çështjen penale të të akuzuarit V. L., për shkak të veprës penale vrasje nga neni 146 par.1 e në lidhje me nenin 20 të KPPK dhe të nenin 8.6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 7/2001, duke vendosur lidhur me ankesat e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan P.nr.73/04 të dt. 27.09.2004, në seancën e mbajtur në pajtim me dispozitat e nenit 410 të KPPK, me dt. 18.05.2005, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Duke marrë në konsideratë pjesërishtë ankesën e të akuzuarit V. L. dhe të mbrojtësit të tij korrigjohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan P.nr. 73/04 të dt. 27.09.2004, vetëm në pjesën vendimit për dënimin, kështu që kjo Gjykatë të akuzuarin për veprë penale vrasje nga neni 146 par.1 e në lidhje me nenin 20 të KPPK për çka është shpallur fajtorë, ia përcaktonë dënimin me burg në kohëzgjatje prej 1 vit 4 muaj dhe duke marrë parasyshë si dënimin të

vërtetuar të cilën Gjykata e Shkallës së Parë ia ka shqiptuar të akuzuarit për veprë penale mbajtje të paaautorizuar të armës nga neni 8.2 e në lidhje me nenin 8.6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 7/2001 burg në kohëzgjatje prej 5 muaj, duke u mbështetur në nenin 71 të KPPK, të akuzuarin e gjykon me dënim unik burg në kohëzgjatje prej 1 vit e 6 muaj duke iu llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 25.02.2004.

## A r s y e t i m i

Gjykata e Qarkut në Gjilan me aktgjykimin P.nr. 73/04 të dt. 27.09.2004 e ka shpallur fajtorë të akuzuarin V. L. për veprë penale vrasje nga neni 146 par. 1 e në lidhje me nenin 20 të KPPK dhe për veprë penale mbajtje të paaautorizuar të armës nga neni 8.2 e në lidhje me nenin 8.6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 7/2001 dhe për këto vepra penale e ka shqiptuar dënimin unik me burg në kohëzgjatje prej 1 vit e 10 muaj duke e llogaritur edhe kohën që i akuzuari e ka kaluar në paraburgim prej dt. 25.02.2004. Gjykata e ka obliguar të akuzuarin të paguaj harxhimet e procedurës penale në pajtim me kalkulimin përfundimtarë të Gjykatës si dhe paushallin gjygjësorë në lartësi prej 50 EUR. Kundër të akuzuarit Gjykata ka shqiptuar dënimin shtes konfiskim i armës si mjet me të cilin është kryer vepra penale.

Kundër këtij aktgjykimi me kohë ankesa kanë paraqitur i akuzuari V. L. dhe mbrojtësi i tij Paviq Vlladimir, avokat, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të Ligjit mbi procedurën penale, për shkak të shkeljes të Ligjit, për arsye të vërtetimit të gabuar dhe jo të mjaftueshëm të gjendjes faktike dhe për shkak të vendimit për dënimin me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet në Gjykatë të Shkallës së Parë në gjykim të përsëritur apo që e njehta të të rikualifikohet dhe i akuzuari të lirohet nga aktakuzat apo të akuzuarit të i shqiptohet dënim me kushtë. Në ankesë është propozuar që i akuzuari dhe mbrojtësi i tij të informohen për mbajtjen e seancës së Kolegjit.

Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar sipas propozimit të vënë në ankesë, ka caktuar seancën e Kolegjit në të cilën ka marrë pjesë mbrojtësi i të akuzuarit Paviq Vlladimir, avokat i cili pasi ka paraqitur arsyetimin e ankesës ka mbetur në tërësi pranë pohimeve nga ankesa i ka propozuar Gjykatës që aktgjykimi i ankimuar të rikualifikohet në pajtim me nenin 420 par.1 pika 4 të KPPK, kurse i akuzuari i cili është në paraburgim dhe i cili është njoftuar me kohë për mbajtjen e seancës të Kolegjit nuk ka shfaqur dëshirë që të mer pjesë në seancën e Kolegjit andajë seanca është zhvilluar pa prezencën e të akuzuarit. Në seancë gjithëashtu nuk ishte prezentë edhe Prokurori publik i Kosovës i cili gjithëashtu ka qenë i informuar me kohë për mbajtjen e seancës së Kolegjit por me shkresën e vet PPA nr. 102/05 të dt. 25.02.2005, ka propozuar që ankesat të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme duke shqyrtuar shkresat nga kjo lëndë si dhe aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitat nga neni 415 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pohimeve nga ankesa, ka gjetur se:

Ankesat janë pjesërisht të bazuara.

Në ankesën e vet mbrojtësi i të akuzuarit përpos tjerash përmend se aktgjykimin i ankimuar përmbanë lëshime esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 403 par.1 pika 12 të KPPK sepse e njehta nuk përmbanë arsytet për faktet vendimtare. Gjegjësistë, ankesa konsideron se Gjykata e Shkallës së Parë nuk e ka vërtetuar se a ka qenë i akuzuari i vetëdijshëm apo ka mundur të jetë i vetëdijshëm në momentin kritik të kryerjes së veprës penale dhe në rastin konkret a e ka kryer i akuzuari veprën e inkriminuar me paramendim direkt apo eventual, me që i akuzuari ka qenë në gjendje të neurozës të fortë dhe nën ndikimin e alkoolit. Gjykata Supreme ka gjetur se këto fakte ankimore janë të pabazuara dhe se aktgjykimin i ankimuar përmbanë arsye të mjaftueshme në të gjitha faktet vendimtare dhe se shqiptimi i dënimit në tërësi është në pajtim me arsyetimin dhe arsytet të përmendura në aktgjykimin e ankimuar. Gjegjësistë, Gjykata e Shkallës së Parë pa marrë parasysh se i akuzuari ka qenë nën ndikim të alkoolit me të drejtë ka gjetur se i akuzuari ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e veta dhe se në rastin konkret veprën e ka kryer me paramendim dhe se nuk ka kurrfarë baze ligjore të cilat kishin me e eliminuar përgjegjësinë penale të të akuzuarit.

Duke çmuar aktgjykimin e ankimuar në pjesën e cila bën fjalë për vërtetimin të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata Supreme gjithashtu gjen se aktgjykimin i ankimuar edhe në këtë pjesë është e ligjshme dhe se Gjykata e Shkallës së Parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike. Nuk është kontestuese se ditën kritike gjegjësistë më dt. 25.02.2004 ka ardhur deri te grindja në mes të të akuzuarit V. L. dhe djalit të tij të dëmtuarit V. R., dhe se kjo grindje ka përfunduar në mënyrë që i akuzuari ka hyrë në dhomën e fjetjes ku e ka marrë pistoletën të cilin e mbante të fshehur dhe nga e njehti ka shkrepur katër plumba në drejtim të të dëmtuarit duke e goditur në pjesën e krahorit të majtë dhe me dy plumba në pjesën e abdomenit dhe se me këtë rast të dëmtuarit i ka shkakuar lëndime që konsiderohen si lëndime të natyrës së rëndë me pasoja për jetën nga të cilat lëndime i dëmtuari ende është duke u mjekuar. Kjo gjendje faktike është vërtetuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë pjesërisht në bazë të pranimin të të akuzuarit dhe nga dëshmia e dëshmitarit të dëmtuarit V. R., pastaj dëshmitarëve S. Z., V. K., B. F. dhe B. P. të cilët pasi kishin dëgjuar të shtënat kanë hyrë në shtëpi të të akuzuarit dhe kanë gjetur të dëmtuarin të shtrirë në gjak dhe menjherë e kanë dërguar për në ndihmë mjekësore. Gjithëashtu Gjykata e Shkallës së Parë ka vërtetuar nga fletëlëshimi nr. 00247 të klinikës kirurgjike në Vranjë në emër të të dëmtuarit V. R. se i njehti në këtë klinikë është shëruar nga plagët e mara me anë të armës prej

dt. 25.01.2004 deri më dt. 13.03.2004 kurse nga vërtetimi mjeksorë nr. 2/9 të dt. 09.09.2004 se në rastin konkret bëhet fjalë për lëndime serioze me pasoja për jetën. Pran kësaj gjendje thënjet ankimore nga ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë, sipas Gjykatës Supreme nuk janë të bazuara.

Gjykata e Shkallës së Parë në bazë të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike, në mënyrë të drejtë ka implementuar dispozitat e Ligjit penal, kur ka gjetur se në veprimet e të akuzuarit gjenden të gjitha karakteristikat e veprës penale vrasje nga neni 166 par.1 e në lidhje me nenin 20 të KPPK dhe të veprës penale mbajtje e paautorizuar e armës dhe municionit nga neni 8.2 e në lidhje me nenin 8.6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 7/2001 dhe se i akuzuari për këto vepra është penalishtë përgjegjës.

Duke vlerësuar aktgjykimin e ankimuar në vendimit për dënim, Gjykata Supreme ka gjetur se në këtë pjesë të ankesës të të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij pjesërisht janë të bazuara. Përpos faktit se Gjykata e Shkallës së Parë me rastin e përcaktimit të dënimit në mënyrë të drejtë ka vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat janë me ndikim që dënimi të jetë më i rëndë apo më i lehtë, Gjykata Supreme ka gjetur se në anën e të akuzuarit qëndrojnë rrethanat lehtësuese, posaqërisht se bëhet fjalë për marrëdhënje të çrregulluara familjare në mes të djalit dhe babasë, dhe duke patur parasysh faktin se këto marrëdhënje kohëvë të fundit janë përmirësuar dhe se djali gjegjësistë i dëmtuari e viziton babanë në burg dhe duke pranuar të gjitha arsytet tjera të cilat Gjykata e Shkallës së Parë i ka dhënë me rastin e vlerësimit të rrethanave lehtësuese, kjo Gjykata ka gjetur se ka vend për zbutje të dënimit për të akuzuarin kështu që në këtë pjesë është pranuar ankesa dhe aktgjykimin i ankimuar ndryshohet ashtu që i akuzuari gjykohet me dënim unik me burg në kohëzgjatje prej 1 vit e gjashtë muaj, duke iu llogaritur koha që i akuzuari e ka akluar në paraburgim, i njehti dënim është në përpjestim më peshën dhe pasojat e veprës penale me dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit e përcaktuar me Ligj.

Nga se u tha më lartë e në bazë të nenin 426 të KPPK, është vendosur sin në dispozitiv të këtij aktgjykimin.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ap. Nr. 102/2005 të dt. 18.05.2005

Procesëmbajtësi,  
Mejreme Memaj

Anëtarët e Kolegjit,  
1. Zait Xhemajli  
2. Avdi Dinaj  
3. Fejzullah Hasani  
4. Hamdi Podvorica

Kryetari I Kolegjit,  
Miftar Jasiqi

**[Gjykata Supreme- aktvendim mbi Kodin Penal - neni 149 KPPK- vrasje nga pakujdesia - neni 328 (2) KPPK - mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve - ankesë për prishjen e aktgjykimit / ndryshimin e dënimit - vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike shkelje e të drejtës materiale - deklarimi i fajësisë - neni 351 (1) KPPK neni 359 (2) KPPK]**

*Avokati mbrojtës paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykata e Qarkut in Gjilan, duke bërë pretendimin ankimor se Gjykata e Qarkut në aktvendimin e vet kishte shkelur dispozitat e kodit penal dhe të procedurës penale, dhe kishte bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.*

*I pandehuri ishte akuzuar për vrasje nga pakujdesia dhe ëith marrje në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve, ishte shpallur fajtor, dhe ishte dënuar me 1 vjet dhe 6 muaj burg.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se nuk ekzistojnë bazat për kundërshtimin e aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike duke marrë parasysh se i akuzuari ishte deklaruar fajtor gjatë shqyrtimit kryesor në secilën pikë të aktakuzës. Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së parë kishte zbatuar drejtë nën 351 (1) dhe 359(2) të KPPK-së. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e avokatit mbrojtës ishte e pabazuar.*

Ap.nr.103/2005

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Avdi Dinaj, kryetar, Gjuran Dema dhe Mr.sc.Fejzullah Hasani, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesionale Mejreme Memaj, procesmbajtëse, në çështjen penale të të akuzuarit S. H., për shkak të veprës penale vrasje nga pakujdesia nga neni 149 i KPPK dhe të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPPK, duke vendosur përkritazi me ankesat e të akuzuarit, mbrojtësit të tij av.Avdullah Ismajli nga Gjilani dhe të dëmtuarit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan P.nr.146/2004 datë 17.12.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur në kuptim të nenit 410 të KPPK, me datë 04.05.2005, merr këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat e të akuzuarit S. H. dhe mbrojtësit të tij, kurse aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan P.nr.146/2004 datë 17.12.2004, vërtetohet.

Ankesa e të dëmtuarit A. B. hudhet si e pasafatshme.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan P.nr.146/2004 datë 17.12.2004, në dispozitivin nën I i akuzuari S. H. është shpallur fajtor për veprën penale vrasje nga pakujdesia nga neni 149 të KPPK, kurse në dispozitivin nën II është shpallur fajtor për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPPK. Për veprën penale nën I të dispozitivit i është caktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, kurse për veprën penale nën II të dispozitivit i është caktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muajsh dhe është gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 14.09.2004 deri më datë 13.10.2004. I akuzuari është detyruar t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit. Të akuzuarit i është shqiptuar dënimi plotësues, marrja e pushkës së gjuetisë, kalibër 12 mm me numër serik 3536 i prodhimit rus.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor kanë paraqitur ankesa:

- I akuzuari, nëpërmjet av. Halit Azemi nga Gjilani, për shkak të: shkeljes qenësore të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të priset dhe çështja t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim, ose të ndryshohet përkritazi me vendimin për dënim ashtu që i akuzuari të lirohet nga dënimi,

- Mbrojtësi i të akuzuarit, av.Avdullah Ismajli, nga Gjilani, për shkak të vendimit për dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet përkritazi me vendimin për dënim dhe i akuzuari të lirohet nga dënimi, apo t'i shqiptohet dënim më i butë, dhe

- I dëmtuari, për shkak të vendimit për dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet përkritazi me vendimin për dënim, ashtu që i akuzuari të lirohet nga aktakuza.

Kjo gjykatë seancën e mbajti në kuptim të dispozitës nga neni 410 të KPPK, në të cilën morën pjesë i akuzuari dhe mbrojtësi i tij av.Halit Azemi. Mbrojtësi i të akuzuarit në seancë pasi sqaroi disa nga pretendimet ankimore, ngeli pranë propozimeve të bëra në ankesë, kurse i akuzuari në tërësi pranoi mbrojtjen e mbrojtësit të tij.

Prokurori Publik i Kosovës me parashtresën PPA.nr.103/2005 datë 24.02.2005, ka propozuar që ankesat e të akuzuarit, mbrojtësit të tij dhe të dëmtuarit të refuzohen si të pabazuara, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet. Në seancë nuk mori pjesë edhe pse është njoftuar me rregull.

Gjykata Supreme i shqyrtoi shkresat e lëndës së bashku me aktgjykimin e ankimuar të cilin e studioi në kuptim të dispozitës nga neni 415 të KPPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet ankimore, gjen se:

Ankesat e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij janë të pabazuara, kurse ankesa e të dëmtuarit është e pasafatshme.

Pretendimet ankimore se aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë përmban shkelje qenësore të dispozitave të procedurës penale parashikuar me nenin 403 par.1 pika 12 e KPPPK, për shkak se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, nuk përmban arsye për faktet vendimtare, se arsyerat e dhëna janë në kundërtënie në mes veti dhe se ekziston kundërtënie e konsiderueshme në mes arsyerave të aktgjykimit për përmbajtjen e dokumenteve dhe procesverbaleve për deklaratat e dhëna në procedurë dhe vetë atyre dokumentave dhe procesverbaleve, nuk arsyetohen fare. Kjo Gjykatë duke studiuar aktgjykimin e ankimuar detyrimisht, në kuptim të dispozitës nga neni 415 të KPPPK, gjen se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje qenësore të dispozitave të procedurës penale.

Pa bazë ankimohet aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë se gjendja faktike është e vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë. Duke pasur parasysh se i akuzuari në seancë kryesore e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, në kuptim të dispozitës nga neni 402 par.2 të KPPPK, përjashtohet mundësia e ankimit të aktgjykimit për bazën ankimore, vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike.

Janë të pabazuara pretendimet ankimore se aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë përmban shkelje të ligjit penal.

Drejtë ka vendosur Gjykata e Shkallës së Parë kur ka gjetur se në veprimet e të akuzuarit sajohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale të vrasjes nga pakujdesia nga neni 149 të KPPK dhe të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPPK. I akuzuari në procedurën e konfirmimit të aktakuzës dhe në seancën kryesore ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, ndërsa gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat nga neni 315 par.1 dhe 359 par.2 të KPPPK.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se vendimi për dënim me aktgjykimin e ankimuar është i kundërligjshëm dhe i ashpër.

Gjatë matjes së dënimit me aktgjykimin e ankimuar të akuzuarit i janë njohur rrethana lehtësuese dhe në mungesë të rrethanave rënduese, për veprat Penale për të cilat është shpallur fajtor, i është shqiptuar dënimi unik me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj. Rrethanat lehtësuese të njohura të akuzuarit me aktgjykimin e ankimuar si drejtë të vlersuara i pranon edhe kjo Gjykatë. Në ankesa nuk është paraqitur asnjë rrethanë lehtësuese e cila ka ekzistuar në kohën e marrjes së aktgjykimit të ankimuar por ka ngelur e pa vlerësuar, e as ndonjë rrethanë lehtësuese e cila është paraqitur pas marrjes së aktgjykimit e cila do të kishte ndikim që vendimi për dënim të jetë më i butë, krahasuar me të shqiptuarin me aktgjykimin e ankimuar.

Kjo Gjykatë gjen se vendimi për dënim i shqiptuar të akuzuarit në aktgjykimin e ankimuar është në përputhshmëri me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale dhe përgjegjësinë penale të të akuzuarit, me të cilin mund të pritset se do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me dispozitën nga neni 34 i KPPPK dhe i cili do të ndikojë që në të ardhmen i akuzuari të përmbahet nga kryerja e veprës së njëjtë apo të ngjashme penale e gjithashtu do të ndikojë edhe te të tjerët që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Duke pasur parasysh se i dëmtuari aktgjykimin e ankimuar e ka pranuar me datë 14.01.2005, ndërsa ankesën e tij gjykata e shkallës së parë e ka pranuar me datë 01.02.2005, respektivisht pas afatit ligjor prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, ankesa hidhet si e pasafatshme. Qëndron edhe fakti se i dëmtuari nuk e ka paralajmëruar ankesën parashikuar me nenin 400 par.1 të KPPPK.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të dispozitës nga neni 421 dhe 423 të KPPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ap.nr. 103/2005, datë 04.05.2005

Procesmbajtësje,  
Mejreme Memaj

Anëtarët e kolegjit,  
Gjuran Dema  
Mr.sc.Fejzullah Hasani

Kryetari i kolegjit  
Avdi Dinaj

**[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Kodin Penal - neni 229 (1) 23 KPPK - blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike - ankesat për ndryshimin / prishjen e aktgjykimit /- dispozitat e KPPPK - gjendja ligjore dhe faktike - rrethanat lehtësuese në caktimin e dënimit]**

*Avokati mbrojtës paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, duke bërë pretendimin ankimor se Gjykata e Qarkut në aktvendimin e vet kishte shkelur dispozitat e kodit penal dhe të procedurës penale, dhe kishte bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.*

*Të pandehurit ishin akuzuar për blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të drogave narkotike të rrezikshme dhe substancave psikotropike, ishin shpallur fajtor, dhe ishin dënuar me 10 muaj burg, si dhe me ndëshkime financiare shtesë dhe masa të sigurisë.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e Qarkut nuk kishte vlerësuar dëshmitë në pajtim të plotë me dispozitat në fuqi të KPPPK, kishte bërë vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, dhe kishte vlerësuar drejtë rrethanat lehtësuese. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e avokatit mbrojtës është e pabazuar.*

Ap.nr.105/2005

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gjuran Dema, kryetar, Agim Krasniqi dhe Avdi Dinaj, anëtarë, me bashkëpunëtoreshen profesionale Minire Xhambazi, procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarve H. Sh., nga Gjilani dhe Ll. R., nga fshati Pozharan komuna e Vitisë, për shkak të veprës penale blerja e paautorizuar, posedimi, distribuimi dhe shitja e narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike në bashkëkryerje nga neni 229 par.2 lidhur me nenin 23 të KPPK (Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës), duke vendosur sipas ankesave: të mbrojtësit të akuzuarit H. Sh., avokati Aziz Shaqiri, nga Gjilani, dhe të akuzuarit Ll. R., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr.144/2004 datë 02.12.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 17.05.2005, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohen si të pabazuara ankesat e mbrojtësit të akuzuarit H. Sh. dhe i të akuzuarit Ll. R., kurse aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan,

P.nr.144/2004 i datës 02.12.2004, vërtetohet.

**A r s y e t i m i**

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr.144/2004 të datës 02.12.2004, të akuzuarit H. Sh. dhe Ll. R. janë shpallur fajtorë për shkak të veprës penale blerja e paautorizuar, posedimi, distribuimi dhe shitja e narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike në bashkëkryerje nga neni 229 par.2 lidhur me nenin 23 të KPPK, dhe të dy të akuzuarit janë gjykuar me nga 10 (dhjetë) muaj burg dhe me dënim me gjobë në shumë prej 150 €, të cilën shumë do të paguajnë në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Nëse dënimi me gjobë nuk mund të paguhet as me përmbarim të dhunshëm do të zëvendësohet me dënim burgu, ashtu që për çdo 15 euro të filluara llogaritet një ditë burgu. Në dënimet e shqiptuara me burg të akuzuarve iu është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datë 21.03.2004 deri më datën 02.12.2004. Kundër të akuzuarve është shqiptuar masa e sigurisë konfiskimi i mjeteve narkotike të llojit "heroinë" në sasi prej 5.99gr.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesa kanë paraqitur:

- mbrojtësi i të akuzuarit H. Sh., për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të priset dhe lënda të kthehet në rigjykim, ose i njëjti të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza, dhe

- i akuzuari Ll. R., për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza, ose i njëjti të priset dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Gjykata Supreme e caktoi seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 410 të KPPPK, ku të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre kanë qenë të njoftuar me rregull, sikurse edhe Prokurori Publik i Kosovës, të cilët nuk ishin prezent.

Prokurori Publik i Kosovës, me parashtrësën e vetë PPA.nr.105/2005 datë 24.02.2005, ka propozuar që ankesat e parashtruara të refuzohen si të pabazuara, dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata Supreme i shqyrtoi shkresat e lëndës, studioi aktgjykimin e ankimuar konform dispozitës së nenit 415 të KPPPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara.

Aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 403 par.1 pika 12 të KPPPK, sepse dispozitivi i të njëjtit është i qartë edhe në përputhje me arsyetimin e dhënë, ku janë dhënë arsye të qarta mbi faktet vendimtare për veprën penale për të cilën të akuzuarit janë shpallur fajtorë, sikurse edhe arsyet se cilave prova gjykata nuk u ka kushtuar besim e cilave u kushton besim e në të cilat mbështetë aktgjykimin e ankimuar, duke dhënë vlerësime të drejta në bazë të nenit 396 të KPPPK. Sikurse edhe për faktet vendimtare të dhëna ekziston përputhshmëri me përmbajtjen e dokumenteve ose të procesverbaleve për deklaratat e dhëna në procedurë të vetë të të akuzuarve dhe të vetë atyre dokumenteve ose procesverbaleve. Gjithashtu, kjo Gjykatë konstaton se nuk ekzistojnë shkelje tjera qenësore në të cilat kujdeset detyrimisht konform dispozitës së nenit 415 të KPPPK. Prandaj, në këtë drejtim ankesa është e pabazuar.

Gjendja faktike në këtë çështje juriko-penale është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, sepse Gjykata drejt i ka vlerësuar mbrojtjet e të akuzuarve, ku i akuzuari Ll. R. ka deklaruar se para se të vijë tek punkti për kontrollim të KFOR-it i akuzuari i parë H. Sh. ia jep një send të mbështjellë me letër të bardhë të cilin ky i akuzuar e futë nën brekë përpara, kurse i akuzuari H. Sh. përveç tjerash deklaroi se kur kanë kontrolluar detajisht të akuzuarin Ll. ushtarët e KFOR-it e në prezencën e policisë kanë gjetur diçka por kam mund me marrë me mend se kanë gjetur një sasi narkotik. I akuzuari Ll. H. në seancë së pari e pranon në tërësi aktakuzën, kurse më pastaj përsëri në seancë e mohon duke thënë se i akuzuari H. nuk i ka dhënë asgjë por ajo substancë narkotike "heroin" që është gjetur te ai ka qenë e tij. Me bazë Gjykata nuk i kushton besim deklaratës të akuzuarit Ll. dhënë në seancë pas pranimit të tërësishëm të aktakuzës, e cila është e drejtuar kah shmangia e përgjegjësisë penale të të akuzuarit H.. Së këndejmi, Gjykata duke bërë analizën e mbrojtjeve të të akuzuarve dhe provave të administruara drejt përfundon se të akuzuarit H. dhe Ll. me marrëveshje paraprake e me qëllim që të sigurojnë përfitim pasuror të kundërligjshëm kanë siguruar substancë narkotike të llojit "heroin" në peshë prej 5.99 gr, e me qëllim që të njëjtën ta vëjnë në qarkullim. Prandaj, në këtë drejtim ankesat janë të pabazuara.

Me vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike edhe ligji penal drejt është zbatuar kur është përfunduar se në veprimet e të akuzuarve H. Sh. dhe Ll. R. formohen të gjitha elementet e veprës penale blerja e paautorizuar, posedimi, distribuimi dhe shitja e narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike në bashkëkryerje nga neni 229 par.2 lidhur me nenin 23 të KPPK.

Duke vlerësuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin për dënimin, kjo Gjykatë i pranon të gjitha rrethanat lehtësuese të konstatuara dhe drejt të vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, me konstatim se

rrethana rënduese nuk ka dhe se kjo rrethanë gabimisht është konstatuar

përkitazi me llojin dhe sasinë e drogës së gjetur, sepse sasia nuk ka qenë e konsiderueshme, por edhe në mungesë të rrethanës rënduese e cila nuk kishte ndikim në lartësinë e dënimit, në kontekst të intensitetit të rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale, kjo Gjykatë gjen se dënimet e shqiptuara kundër të akuzuarve me burg në kohëzgjatje me nga 10 (dhjetë) muaj dhe me dënim gjobe me nga 150 €, janë në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve, duke qenë e bindur se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 34 të KPPPK. Prandaj, në këtë drejtim ankesa është e pabazuar.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e në bazë të nenit 423 të KPPPK.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË  
Ap.nr. 105/2005, datë 17.05.2005

Procesmbajtësa,  
Minire Xhambazi

Kryetari i kolegjit,  
Gjuran Dema

Anëtarët e kolegjit:  
Agim Krasniqi  
Avdi Dinaj

**[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Kodin Penal - Neni 193 (3) ((5)) KPPK- përdhunimi ankesë për prishjen e aktgjykimit / ndryshimin e dënimit - shkelje e të drejtës materiale - shkelje e KPPPK-së - vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike - Neni 157 - Neni 391 KPPPK Neni 403 KPPPK]**

*Avokati mbrojtës paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykata e Qarkut në Prishtinë, duke bërë pretendimin ankimor se Gjykata e Qarkut në aktvendimin e vet kishte shkelur dispozitat e kodit penal dhe të procedurës penale, dhe kishte bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.*

*Të pandehurit ishin akuzuar për dhunim, ishin shpallur fajtor, dhe ishin dënuar me 6 vjete burg.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se vendimi i Gjykatës së Qarkut nuk përmban shkelje esenciale dhe nuk jep arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare dhe ishte bazuar në të gjitha dëshmitë dhe deklaratave të mbrojtjes, të cilat qoftë ishin të administruara veç e veç apo në lidhje me njëra tjetrën. Dhe aktvendimi ishte bazuar kryesisht në deklaratën e palës së dëmtuar. Gjykata Supreme ka vendosur se dënimet e shqiptuara ishin në pajtim me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e avokatit mbrojtës është e pabazuar.*

Ap.nr.115/2005

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Supreme e Kosovës, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gjuran Dema, kryetar, Agim Krasniqi, dr. Hamdi Podvorica, mr.sc.Fejzullah Hasani dhe Avdi Dinaj, anëtarë, me bashkëpunëtoreshen profesionale Minire Xhambazi, procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarve Emrush Gashi, Muharrem Gashi dhe Ramiz Gashi, për shkak të veprës penale, secili veç e veç, të dhunimit nga neni 193 par.3 pika 5 lidhur me par.1 të KPPK (Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës), duke vendosur sipas ankesave të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre avokatëve Ramadan Berisha, Haxhi Millaku dhe Ramiz Krasniqi, të gjithë nga Prishtina, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P.nr.393/2004 datë 06.10.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 410 të KPPPK, më datë 26.05.2005, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohen si të pabazuara ankesat e të akuzuarve Emrush Gashi, Muharrem Gashi dhe Ramiz Gashi, dhe mbrojtësve të tyre, kurse aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.nr.393/2004 datë 06.10.2004, vërtetohet.

**A r s y e t i m i**

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P.nr.393/2004 të datës 06.10.2004 të akuzuarit Emrush Gashi, Muharrem Gashi dhe Ramiz Gashi, janë shpallur fajtorë secili veç e veç, për shkak të veprës penale të dhunimit nga neni 193 par.3 pika 5 lidhur me par.1 të KPPK dhe janë gjykuar me nga 6 (gjashtë) vjet burg, në të cilat dënime iu është llogaritur koha e kaluar në paraburgim, për të akuzuarit Emrush Gashi dhe Muharrem Gashi prej datës 05.05.2004, kurse për të akuzuarin Ramiz Gashi prej datës 08.05.2004. E dëmtuara për realizimin e kërkesës juridiko-pronësore është udhëzuar në kontestin civil. Të akuzuarit janë obliguar që t'i paguajnë të gjitha shpenzimet procedurale sipas llogarisë së gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 150 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesa kanë paraqitur:

- mbrojtësi i të akuzuarit Emrush Gashi, av.Ramadan Berisha, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të priset dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim, ose të ndryshohet dhe i akuzuari të gjykohet me një dënim më të butë;

- i akuzuari Emrush Gashi, pa përcaktuar bazat ankimore, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të priset dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim;

- mbrojtësi i të akuzuarit Muharrem Gashi, av.Haxhi Millaku, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të priset dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim, ose të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza. Në ankesë në bazë të nenit 410 të KPPPK ka propozuar që së bashku me të mbrojturin e tij të njoftohen për seancën e kolegjit;

- i akuzuari Muharrem Gashi, pa përcaktuar bazat ankimore, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të priset dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, si dhe t'i ndërpritet paraburgimi;

- mbrojtësi i të akuzuarit Ramiz Gashi, av.Ramiz Krasniqi, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të priset dhe lënda t'i kthehet gjykatës së

shkallës së parë për rigjykim, ose të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza. Në kuptim të nenit 410 të KPPPK ka kërkuar që së bashku me të mbrojturin e tij të njoftohen për seancën e kolegjit, dhe

- i akuzuari Ramiz Gashi, pa përcaktuar bazat ankimore, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të priset dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës konform dispozitës së nenit 410 të KPPPK i njoftoi mbrojtësit dhe të akuzuarit, ku ishin prezentë mbrojtësit e të akuzuarve Muharrem Gashi dhe Ramiz Gashi, të cilët dhanë ca sqarime nga thëniet e ankesave të tyre dhe mbetën në pretendimet e bëra në ato, si dhe të akuzuarit Muharrem Gashi dhe Ramiz Gashi të cilët i pranuan në tërësi thëniet e mbrojtësve të tyre.

Nuk ishin prezent: mbrojtësi i të akuzuarit Emrush Gashi, avokati Ramadan Berisha, i njoftuar me rregull për seancën e kolegjit dhe i akuzuari Ramiz Gashi, për të cilin qëndron konstatimi nga Burgu Dubrava në Istog se nga Gjykata Komunale në Prishtinë është arratisur.

Prokurori Publik i Kosovës i njoftuar me rregull për seancën e kolegjit nuk ishte prezent, por me parashtrësën e vet PPA.nr.115/2005 datë 11.03.2005 ka propozuar që ankesat e të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre të refuzohen si të pabazuara, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata Supreme i shqyrtoi shkresat e lëndës, studioi aktgjykimet e ankimuar konform dispozitës së nenit 415 të KPPPK (Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës), dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara.

Aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 403 par.1 pika 7 të KPPPK, sepse aktakuza është shqyrtuar dhe zgjidhur në tërësi, ndërkaq vepra penale dhunimi nuk mund të kryhet në bashkëkryerje, prandaj moszbatimi i dispozitës nga neni 23 i KPPK me aktgjykimin e ankimuar është i drejtë.

Aktgjykimi i njëjtë nuk përmban shkelje esenciale nga dispozita e pikës 12 par.1 të nenit 403 të KPPPK, spese në të janë dhënë arsye të bindshme dhe të qarta për faktet vendimtare, në bazë të vlerësimit të të gjitha provave të administruara dhe të mbrojtjeve të të akuzuarve veç e veç e në lidhmëri me njëra tjetrën, të cilat janë në përputhje me përmbajtjen e tyre. Prandaj, drejt është zbatuar edhe dispozita e nenit 391 të KPPPK.

Përkritazi me të akuzuarin Emrush Gashi, nuk është shkelur e drejta e

mbrojtjes së tij në procedurën paraprake, sepse i njëjti vetë është deklaruar se heq dorë nga avokati, pra nuk dëshiron mbrojtës, prandaj, në këtë drejtim nuk qëndrojnë shkeljet e dispozitave të procedurës penale nga neni 403 par.2 pika 1 dhe 2 të KPPPK.

Përkritazi me thënien e ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit Muharrem Gashi, se avokati Nikë Lumezi së pari ka pasë autorizimin me mbrojtë këtë të akuzuar e më pastaj ka përfaqësuar të dëmtuarën, nuk paraqet asnjë shkelje ligjore, sepse i njëjti avokat nuk ka marrë pjesë në asnjë instancë procedurale ndaj të akuzuarit Muharrem Gashi.

Aktgjykimi i ankimuar është marrë në bazë të gjitha provave të administruara në seancë kryesore, respektivisht në bazë të deklaratës së të dëmtuarës Shqipe Kaja, të dëgjuar edhe në cilësi të dëshmitares dhe ekspertizës mjeko-ligjore, prandaj pretendimet ankimore se i njëjti është mbështetur vetëm në deklaratën e të dëmtuarës dhe se nuk është zbatuar drejt dispozita nga neni 157 të KPPPK, nuk qëndrojnë.

Aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje qenësore të dispozitave të procedurës penale për të cilat kjo Gjykatë kujdeset detyrimisht, konform dispozitës së nenit 415 të KPPPK.

Prandaj, në këtë drejtim ankesat janë të pabazuara.

Gjendja faktike në këtë çështje juriko-penale është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, sidomos nga deklaratat e të dëmtuarës Shqipe Kaja, e cila tërë rastin kritik e përshkruan në mënyrë të detajizuar, se ditën kritike më datën 04.052004, rreth orës 15,00, ka qenë e marrur me dhunë dhe e futur në automobilin e të akuzuarve, nga dy persona, për të cilët ka deklaruar se ata nuk ishin prezentë në sallën e gjykimit, të cilët me veturë e dërgojnë në malet e fshatit Mramor. Në veturë kanë qenë 5 veta të cilët me radhë e dhunojnë, prej tyre i pari i akuzuari Ramiz Gashi, të cilin e dëmtuara Shqipe e ka njohur edhe përpara, megjë me të më përpara ka kaluar, por marrëdhëniet i ka ndërprerë para ca muajsh për arsye se i akuzuari Ramiz kishte qenë i arrestuar në Burgun e Prizrenit, prandaj edhe në rastin kritik i ka thënë të dëmtuarës: "kjo është hakmarrja e Prizrenit", duke iu kërcënuar me thikë, e detyron që e dëmtuara të zhvishet dhe e dhunon e më pastaj me radhë vijnë të akuzuarit: Emrush Gashi dhe Muharrem Gashi dhe dy persona të tjerë, të gjithë e dhunojnë, ku i akuzuari Muharrem i bjen disa shuplaka të dëmtuarës, e përafërsisht pas 2 orësh, me automobil e kthejnë në Prishtinë dhe e lënë në vendin e quajtur "Hani i Dilit". E dëmtuara Shqipe Kaja, të akuzuarin Muharrem Gashi dhe Emrush Gashi i identifikon gjatë identifikimit të bërë në polici, dhe atë të akuzuarin Muharrem Gashi me numrin 2 ndërsa të akuzuarin Emrush Gashi me numrin 4. E dëmtuara është kontrolluar menjëherë edhe nga eksperti i mjekësisë ligjore, ku

janë konstatuar dëmtime në pjesët e trupit, përkatësisht në pjesët e gjoksit dhe të skuqura në pjesët e organit seksual, me konstatim se në pjesën e gjoksit janë konstatuar ndrydhje dhe hematome të bëra me besueshmëri të lartë nga shtrëngimi me duar (mollza e gishtit), kurse të tjerat, skuqjet e shtypjes nga dhëmbët, ndërkaq skuqjet në organin gjenital tregojnë për marrëdhënie seksuale në afërsi kohore. Nga të gjitha këto prova gjykata e shkallës së parë drejt ka përfunduar se të akuzuarit kanë pasë marrëdhënie seksuale me dhunë me të dëmtuarën.

Me të drejtë gjykata e shkallës së parë nuk u ka kushtuar besim mbrojtjeve të të akuzuarve, sepse ato janë në kundërshtim me deklaratën e të dëmtuarës Shqipe Kaja dhe me provat e tjera të administruara. E dëmtuara Shqipe Kaja edhe sipas bindjes së kësaj Gjykate nuk ka pasë arsye me iu mveshë veprime inegziste të akuzuarve, që pretendohet në ankesat e të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre. Deklarata e të dëmtuarës në tërësi përputhet edhe me konstatimin dhe mendimin e ekspertit të mjekësisë ligjore për dëmtimet e konstatuara te ajo.

Prandaj, në këtë drejtim ankesat janë të pabazuara.

Me një gjendje të tillë faktike të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë edhe ligji penal drejt është zbatuar kur është përfunduar se në veprimet e të akuzuarve: Emrush Gashi, Muharrem Gashi dhe Ramiz Gashi, veç e veç, formohen të gjitha elementët e veprës penale të dhunimit nga neni 193 par.3 pika 5 lidhur me par.1 të KPPK.

Prandaj, në këtë drejtim ankesat janë të pabazuara.

Duke vlerësuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata Supreme i pranon të gjitha rrethanat konstatimet dhe vlerësimet për rrethanat e marra me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit për çdo të akuzuar. Vendimi për dënim me aktgjykimin e ankimuar nuk është arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme, mirëpo duke patur parasysh se i njëjti është arsyetuar në bazë të fakteve të konstatuara në dispozitiv, kjo rrethanë nuk paraqet bazë e cila do të kishte për pasojë prishjen e aktgjykimit. Kjo Gjykatë gjen se në anën e të akuzuarve ekzistojnë edhe rrethana rënduese mënyra e vrazhdë e kryerjes së veprës penale. Prandaj, dënimet e shqiptuara me aktgjykimin e ankimuar të akuzuarve janë në përputhje me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprave të kryera penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve. Kjo gjykatë është e bindur se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 34 të KPPK. Prandaj, në këtë drejtim ankesat janë të pabazuara.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform dispozitës së nenit 423 të KPPPK.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Procesmbajtësja,  
Minire Xhambazi

Kryetari i kolegjit,  
Gjuran Dema

Anëtarët e kolegjit:

Agim Krasniqi

Dr.Hamdi Podvorica

Mr.sc.Fejzullah Hasani

Avdi Dinaj

**[Gjykata Supreme - aktvendim mbi Kodin Penal - neni 328 (2) KPPK mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve - ankesë për ndryshimin e dënimit]**

*Prokurori i Qarkut në Gjilan paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykata e Qarkut of Gjilan duke bërë pretendimin ankimor se Gjykata e Qarkut në aktvendimin e vet kishte shkelur dispozitat e kodit penal dhe të procedurës penale, dhe kishte bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.*

*I pandehuri ishte akuzuar për marrje në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve, dhe ishte liruar nga Gjykata e Qarkut në Gjilan.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se vendimi i Gjykatës së Qarkut ishte i qartë, drejtpërdrejt, dhe nuk përmban kundërshtime qoftë me vetveten apo me arsyet tjera dhe provat e administruara. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e prokurorit të qarkut është e pabazuar.*

Ap.nr.117/2005

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Zait Xhemajli, kryetar kolegji, Miftar Jasiqi dhe Avdi Dinaj, anëtarë, me bashkëpunëtoreshen profesionale Mejreme Memaj, procesmbajtëse, në lëndën penale ndaj të akuzuarit N. S. nga Gjilani, për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, posedim, ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 par.2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut-Gjilan, paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut-Gjilan, P.nr.195/04, datë 19.01.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.05.2005, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut-Gjilan, ndërsa aktgjyqimi i Gjykatës së Qarkut-Gjilan, P.nr.195/2004, datë 19.01.2005, vërtetohet.

**A r s y e t i m i**

Gjykata e Qarkut-Gjilan, me aktgjykimin P.nr.195/2004, datë 19.01.2005, të akuzuarin N. S., për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim, ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPPK-ës, konform neni 390 par.1 nënpar.3 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, e ka liruar nga akuza. Shpenzimet e procedurës penale i janë ngarkuar mjeteve buxhetore të Gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë Prokurori Publik i Qarkut-Prishtinë për shkak të sjklejeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata Supreme aktgjykimin e kundërshtuar ta prishë dhe lënda t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë në rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës mbajti seancën e kolegjit në pajtim me nenin 410 të KPPPK-ës, në të cilën edhe pse i njoftuar me rregull nuk mori pjesë Prokurori Publik i Kosovës por me parashtresën me shkrim PPA.nr.117/2005 datë 9.03.2005, ka propozuar që ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut-Prishtinë, të aprovohet si e bazuar ndërsa aktgjykimin e kundërshtuar të priset dhe lënda t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë në rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e kundërshtuar konform dispozitës së neni 415 të KPPPK-ës, vlerësoi pretendimet ankimore dhe konstatoi se:

-ankesa nuk është e bazuar.

Në ankesë prokurori pretendon se aktgjykimin e kundërshtuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 403 par.1 pika.12 të KPPPK-ës, sepse dispozitivi i aktgjyqimit është në kundërshtim me arsyetimin dhe përmbajtjen e shkresave të lëndës. Këto kundërthënie sipas ankesës manifestohen në rrethanën se konkludimi i Gjykatës së Shkallës së Parë i dhënë në arsyetimin e aktgjyqimit se nga mbrojtja e të akuzuarit është vërtetuar se i akuzuari nuk është furnizues dhe as posedues i pushkës së gjuetisë është në kundërshtim me dëshminë e dëshmitarit E. M., dëshmia e të cilit fare nuk vlerësohet në arsyetimin e aktgjyqimit, e poashtu në arsyetimin e aktgjyqimit nuk përmendet se është shtjelluar si provë vërtetimi mbi konfiskimin e përkohshëm të sendeve nga i akuzuari.

Kjo Gjykatë pretendimet e mësipërme ankimore i konsideron si të pabazuara, aktgjykimin e kundërshtuar është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, nuk ka kundërthënie qoftë me veten apo me arsyet dhe provat e administruara. Gjykata e Shkallës së Parë ka bërë vlerësimin dhe analizën e të gjitha provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë. Në këtë çështje juridiko-penale nuk është kontestuese se pushka e gjuetisë është gjetur në shtëpinë e të akuzuarit N., ky fakt jo vetëm që vërtetohet nga dëshmia e

dëshmitarit E. M., fotodokumentacioni hetues, raporti mbi marrjen e pushkës, por edhe nga i akuzuari i cili me rastin e bastisjes së shtëpisë vullnetarisht e ka lajmëruar policinë për armën, por mohon njëkohësisht se arma-pushka egjuetisë është e tij.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar ose jo i plotë i gjendjes faktike prokurori publik në ankesë pretendon se Gjykata e Ghkallës së Parë nuk e ka vërtetuar faktin se shtëpia ku është gjetur arma është pronësi e përbashkët e të akuzuarit N. dhe e vëllait të tij N. S., me tutje konteston konkludimin e Gjykatës së çështjes se pushka e gjuetisë e gjetur në shtëpinë e të akuzuarit nuk është e tij por e vëllait të tij bazuar vetëm në librezën e antarësisë së shoqatës së gjuetarëve sepse shoqata e gjuetarëve nuk ka autorizim të lëshojë leje për posedimin e armëve, ndërsa pushka e gjuetisë është gjetur në dhomën e të akuzuarit.

Edhe këto pretendime ankimore janë të pabazuara sipas vlerësimit të kësaj Gjykate. Qëndron fakti se shoqata e gjuetarëve nuk është organ që lëshon leje për posedimin e armëve, mirëpo nga librezja e antarësisë është vërtetuar se pushka e gjuetisë nuk i takon të akuzuarit por vëllait të tij, ndërsa sipas Rregullores së UNMIK-ut nr.2001/7, për autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë, pushkët e gjuetisë ju lejohet qytetarëve t'i mbajnë pa leje vetëm në shtëpi, ndërsa pushka e gjuetisë në rastin konkret është gjetur në shtëpi, irelevante është vendi ku është gjetur arma dhe fakti se shtëpia a është pronësi e përbashkët e të akuzuarit dhe vëllait të tij.

Duke pasur parasysh rrethanat e lartcekura, arsyet me detale të theksuara në aktgjykimin e kundërshtuar, rezulton si i drejtë dhe i ligjshëm konkludimi i Gjykatës së çështjes se i akuzuari nuk është kryerës i veprës penale për të cilën është akuzuar.

Nga sa u tha më lart e në kuptim të dispozitës së nenit 423 të KPPPK-ës u vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ap.nr.117/2005, datë 31.5.2005

Procesmbajtësja,  
Mejreme Memaj

Anëtarët e kolegjit  
Miftar Jasiqi  
Avdi Dinaj

Kryetari i kolegjit,  
Zait Xhemajli

**[Gjykata Supreme - aktvendim mbi Kodin Penal - neni 328 (1) KPPK mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve - kualifikimi juridik - ankesë për ndryshimin e dënimit]**

*Prokurori i Qarkut në Prishtinë paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, duke bërë pretendimin ankimor se dënimi i Gjykatës së Qarkut ishte tejet i butë dhe propozoi që Gjykata të shqipton dënim efektiv me burg.*

*I pandehuri ishte akuzuar për marrje në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve, ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me dënim me kusht me 10 muaj burg, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk përsërit veprën penale për dy vjetët e ardhshme.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së parë kishte zbatuar gabimisht kodin penal kur ka gjetur se veprimet e të akuzuarit përbëjnë elemente të dy veprave penale. Gjykata Supreme ka vendosur se rasti përkatës kishte të bëjë me një veprë penale për shkak se ka të bëjë me një palë të dëmtuar dhe se kishte ndoshtur gjatë një kontinuiteti kohor.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se shqiptimi i dënimit me kusht nuk është në përpjestim me intensitetin të rrezikut ndaj vlerës së mbrojtur. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e prokurorit të qarkut ishte pjesërisht e bazuar.*

Ap.nr.133/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Zait Xhemajli, kryetar, Miftar Jasiqi dhe Mr.sc.Fejzullah Hasani, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Drita Rexhaj, procesmbajtëse, në çështjen penale të të akuzuarit Sh. H., nga Shtimja, për dy vepra penale mbajtja në pronësi, në kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorit Publik të Qarkut Prishtinë të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prishtinë, P.nr.303/2004 datë 24.01.2005, në seancën e mbajtur konform dispozitës së nenit 410 të KPPPK, më datë 7.06.2005, mori këtë

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e pjesshëm të ankesës së Prokurorit Publik të Qarkut Prishtinë, e detyrimisht ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prishtinë, P.nr.303/2004 datë 24.01.2005, përkitazi me cilësimin juridik dhe sanksionin

penal ashtu që i akuzuari Sh. H. shpallet fajtor për një veprë penale mbajtja në pronësi, në kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPPK në vazhdim dhe për këtë veprë gjykohet me dënim me gjobë prej 1.000 €, të cilin dënim obligohet që ta paguajë në afatin prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi merr formë të prerë, e nëse ky dënim nuk mund të ekzekutohet edhe me dhunë, atëherë i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur 15 € për një ditë burgim.

### A r s y e t i m

Gjykata e Qarkut Prishtinë, të akuzuarin Sh. H. e ka shpallur fajtor për dy vepra penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPPK dhe për këto dy vepra i ka shqiptuar dënim. Për veprën penale nën I të dispozitivit i është caktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, kurse për veprën penale nën II të dispozitivit i është caktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muajsh dhe është gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 14.09.2004 deri më datë 13.10.2004. I akuzuari është detyruar t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit. Të akuzuarit i është shqiptuar dënimi plotësues, marrja e pushkës së gjetisë, kalibër 12 mm me numër serik 3536 i prodhimit rus.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor kanë paraqitur ankesa:

- I akuzuari, nëpërmjet av. Halit Azemi nga Gjilani, për shkak të: shkeljes qenësore të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të priset dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim, ose të ndryshohet përkitazi me vendimin për dënim ashtu që i akuzuari të lirohet nga dënimi,

- Mbrojtësi i të akuzuarit, av. Avdullah Ismajli, nga Gjilani, për shkak të vendimit për dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet përkitazi me vendimin për dënim dhe i akuzuari të lirohet nga dënimi, apo t'i shqiptohet dënim më i butë, dhe

- I dëmtuari, për shkak të vendimit për dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet përkitazi me vendimin për dënim, ashtu që i akuzuari të lirohet nga aktakuzar

Kjo Gjykatë seancën e mbajti në kuptim të dispozitës nga neni 410 të KPPK, në të cilën morën pjesë i akuzuari dhe mbrojtësi i tij av. Halit Azemi.

Mbrojtësi i të akuzuarit në seancë pasi sqaroi disa nga pretendimet ankimore, ngeli pranë propozimeve të bëra në ankesë, kurse i akuzuari në tërësi pranoi mbrojtjen e mbrojtësit të tij.

Prokurori Publik i Kosovës me parashtresën PPA.nr.103/2005 datë 24.02.2005, ka propozuar që ankesat e të akuzuarit, mbrojtësit të tij dhe të dëmtuarit të refuzohen si të pabazuara, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet. Në seancë nuk mori pjesë edhe pse është njoftuar me rregull.

Gjykata Supreme i shqyrtoi shkresat e lëndës së bashku me aktgjykimin e ankimuar të cilin e studioi në kuptim të dispozitës nga neni 415 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet ankimore, gjen se:

Ankesat e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij janë të pabazuara, kurse ankesa e të dëmtuarit është e pasafatshme.

Pretendimet ankimore se aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë përmban shkelje qenësore të dispozitave të procedurës penale parashikuar me nenin 403 par.1 pika 12 e KPPK, për shkak se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, nuk përmban arsye për faktet vendimtare, se arsyerat e dhëna janë në kundërtënie në mes veti dhe se ekziston kundërtënie e konsiderueshme në mes arsyerave të aktgjykimit për përmbajtjen e dokumenteve dhe procesverbaleve për deklaratat e dhëna në procedurë dhe vetë atyre dokumentave dhe procesverbaleve, nuk arsyetohen fare. Kjo Gjykatë duke studiuar aktgjykimin e ankimuar detyrimisht, në kuptim të dispozitës nga neni 415 të KPPK, gjen se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje qenësore të dispozitave të procedurës penale.

Pa bazë ankimohe aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë se gjendja faktike është e vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë. Duke pasur parasysh se i akuzuari në seancë kryesore e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, në kuptim të dispozitës nga neni 402 par.2 të KPPK, përjashtohet mundësia e ankimit të aktgjykimit për bazën ankimore, vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike.

Janë të pabazuara pretendimet ankimore se aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë përmban shkelje të ligjit penal.

Drejtë ka vendosur gjykata e shkallës së parë kur ka gjetur se në veprimet e të akuzuarit sajohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale të vrasjes nga pakujdesia nga neni 149 të KPPK dhe të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPPK. I akuzuari në procedurën e konfirmimit të aktakuzës dhe në seancën kryesore ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë drejtë ka zbatuar

dispozitat nga neni 315 par.1 dhe 359 par.2 të KPPPK.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se vendimi për dënim me aktgjykimin e ankimuar është i kundërligjshëm dhe i ashpër.

Gjatë matjes së dënimit me aktgjykimin e ankimuar të akuzuarit i janë njohur rrethana lehtësuese dhe në mungesë të rrethanave rënduese, për veprat penale për të cilat është shpallur fajtor, i është shqiptuar dënimi unik me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj. Rrethanat lehtësuese të njohura të akuzuarit me aktgjykimin e ankimuar si drejtë të vlersuara i pranohet edhe kjo Gjykatë. Në ankesa nuk është paraqitur asnjë rrethanë lehtësuese e cila ka ekzistuar në kohën e marrjes së aktgjykimit të ankimuar por ka ngelur e pa vlerësuar, e as ndonjë rrethanë lehtësuese e cila është paraqitur pas marrjes së aktgjykimit e cila do të kishte ndikim që vendimi për dënim të jetë më i butë, krahasuar me të shqiptuarin me aktgjykimin e ankimuar.

Kjo gjykatë gjen se vendimi për dënim i shqiptuar të akuzuarit në aktgjykimin e ankimuar është në përputhshmëri me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale dhe përgjegjësinë penale të të akuzuarit, me të cilin mund të pritët se do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me dispozitën nga neni 34 i KPPPK dhe i cili do të ndikojë që në të ardhmen i akuzuari të përmbahet nga kryerja e veprës së njëjtë apo të ngjashme penale e gjithashtu do të ndikojë edhe te të tjerët që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Duke pasur parasysh se i dëmtuari aktgjykimin e ankimuar e ka pranuar me datë 14.01.2005, ndërsa ankesën e tij Gjykata e Shkallës së Parë e ka pranuar me datë 01.02.2005, respektivisht pas afatit ligjor prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, ankesa hidhet si e pasafatshme. Qëndron edhe fakti se i dëmtuari nuk e ka paralajmëruar ankesën parashikuar me nenin 400 par.1 të KPPPK.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të dispozitës nga neni 421 dhe 423 të KPPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ap.nr. 133/2005, datë 04.05.2005

Procesmbajtëse,  
Mejreme Memaj

Anëtarët e kolegjit,  
Gjuran Dema  
Mr.sc.Fejzullah Hasani

Kryetari i kolegjit  
Avdi Dinaj

#### **[Gjykata Supreme - aktvendim mbi Kodin Penal - neni 193 (3) ((1)) ((2)) KPPK - përdhunimi - ankesë për prishjen e aktgjykimit / ndryshimin e dënimit - shkelje e të drejtës materiale - shkelje e KPPPK-së - vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike - neni 157 -neni 391 KPPPK- neni 403 KPPPK]**

*Prokurori i Qarkut në Prishtinë paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, duke bërë pretendimin ankimor se dënimi i Gjykatës së Qarkut ishte tejet i butë dhe propozoi të shqiptohet një dënim më të rëndë.*

*Avokati mbrojtës paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, duke bërë pretendimin ankimor se Gjykata e Qarkut në aktvendimin e vet kishte shkelur dispozitat e kodit penal dhe të procedurës penale dhe kishte bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.*

*I pandehuri ishte akuzuar për dhunim, ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me 1 vjet dhe 6 muaj burg.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e Qarkut nuk ka marrë parasysh ndonjë rrethanë rënduese dhe se dënimi i Gjykatës së Qarkut nuk ishte llogaritur si duhet për të arritur qëllimin e dënimit të parashikuar me ligj. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e prokurorit të qarkut ishte e bazuar.*

Ap.nr.160/2005

#### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Krasniqi, kryetar, Gjuran Dema, Miftar Jasiqi, Dr. Hamdi Podvorica dhe Mr.sc.Fejzullah Hasani, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Mejreme Memaj, procesmbajtëse, në lëndën penale të akuzuarit L. H., për shkak të veprës penale dhunimi nga neni 193 par.3 nën par.1 dhe 2 të KPPK, duke vendosur përkitazi me ankesat e Prokurorit Publik të Qarkut në Prishtinë dhe mbrojtësit të të akuzuarit av. Ahmet Gjinovci nga Prishtinë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P.nr.406/2004 datë 10.11.2004, në seancën e kolegjit të mbajtur në kuptim të dispozitës nga neni 410 të KPPPK, me datë 24.05.2005, mori këtë:

#### A K T G J Y K I M

Me pranimin e ankesës së Prokurorit Publik të Qarkut në Prishtinë, aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P.nr.406/2004 datë 10.11.2004,

ndryshohet përkritazi me vendimin për dënimin, ashtu që Gjykata Supreme të akuzuarin L. H. për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin ia llogaritë kohën e kaluar në paraburgim prej datës 30.06.2004 deri më datë 10.11.2004.

Ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit L. H. refuzohet si e pabazuar.

### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P.nr.406/2004 datë 10.11.2004, i akuzuari L. H. është shpallur fajtor për vepër penale dhunimi nga neni 193 par.3 nën par.1 dhe 2 të KPPK dhe është gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj në të cilin i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 30.06.2004 deri më datë 10.11.2004. I akuzuari është liruar nga detyrimi i pagesës të shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor kanë paraqitur ankesa:

- Prokurori Publik i Qarkut në Prishtinë, për shkak të vendimit për dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet përkritazi me vendimin për dënimin, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje më të madhe, dhe

- Mbrojtësi i të akuzuarit, për shkak të: shkeljes qenësore të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të prishet dhe çështja t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim.

Kjo Gjykatë, seancën e mbajti në kuptim të dispozitës nga neni 410 të KPPPK, në për të cilën i njoftoi të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij, por ata nuk ishin të pranishëm.

Prokurori Publik i Kosovës me parashtresën PPA.nr.160/2005 datë 23.03.2005, ka propozuar që ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Prishtinë të pranohet si e bazuar, kurse ajo e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet. Në seancë nuk mori pjesë edhe pse është njoftuar me rregull.

Gjykata Supreme i shqyrtoi shkresat e lëndës së bashku me aktgjykimin e ankimuar të cilin e studioi në kuptim të dispozitës nga neni 415 i KPPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet ankimore, gjen se:

Ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Prishtinë është e bazuar, kurse ajo e mbrojtësit të akuzuarit është e pabazuar.

Pretendimet ankimore se aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë përmban shkelje qenësore të dispozitave të procedurës penale parashikuar me nenin 403 par.1 pika 12 e KPPPK, për shkak se dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyerat dhe me shkresat e lëndës, nga se në dispozitiv thuhet se vepra penale është kryer me datë 20.06.2004 kurse në arsyetim me datë 29.06.2004, janë të pabazuara.

Koha e kryerjes së veprës penale si dhe lëshimet e tjera të paraqitura me aktgjykimin e ankimuar, janë përmirësuar me aktvendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë P.nr.406/2004 datë 17.02.2005, kopjen e të cilit e ka pranuar i akuzuari dhe mbrojtësi i tij. Me këtë aktvendim janë përmirësuar lëshimet e paraqitura me aktgjykimin e ankimuar, ashtu që koha e kryerjes së veprës penale merret data 29.06.2004. Pretendimet ankimore se ekziston kundërthënia e konsiderueshme në mes të arsyerave të aktgjykimit të ankimuar për përmbajtjen e dokumenteve dhe procesverbaleve për deklaratat e dhëna në procedurë dhe vet atyre dokumentave dhe procesverbaleve, nuk arsyetohet fare. Kjo Gjykatë duke u kujdesur detyrimisht në kuptim të dispozitës nga neni 415 të KPPPK, gjen se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje qenësore të dispozitave të procedurës penale.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se me aktgjykimin e ankimuar gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë, për shkak se provat materiale nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Me vlerësimin e drejtë të deklaratës të dëmtuarës M. M., e dëgjuar edhe në cilësi të dëshmitares, raportet mjekësore të lëshuar në emër të saj të datës 30.06.2004 dhe fotodokumentacionet dhe duke vlerësuar në kuadër të këtyre provave edhe deklaratat e dëshmitarëve Z. R., A. P. dhe S. B., Gjykata e Shkallës së Parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka ardhur në përfundim të drejtë kur ka gjetur se i akuzuari L. H. me dashje e ka detyruar të dëmtuarën M. në marrëdhënie seksuale, duke i thënë që ajo të hy në shtëpinë e tij, meqenëse në shtëpi janë bashkshorti dhe fëmijët e tij, e pasi e ka bindur të dëmtuarën në momentin kur ajo ka hyrë në shtëpi, ai ia mbyllë derën me çelës, fillon ta grushtojë dhe shqelmojë duke i shkaktuar lëndime në pjesë të trupit të paraqitura më hollësisht në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, e pasi e then rezistencën e të dëmtuarës, me të kryen aktin seksual.

Pretendimet ankimore se nga deklaratat e dëshmitarëve është vërtetuar se vetë e dëmtuara i ka dhënë alkool të akuzuarit dhe pastaj e ka marrë për dore

të dehur nga kafeneja, nuk e përjashton përgjegjësinë penale të tij, pasi i akuzuari veprimet inkriminuese në drejtim të kryerjes së veprës penale për të cilën është shpallur fajtor me aktgjykimin e ankimuar i ndërmorri pasi të dëmtuarën me paraqitjen e fakteve të rrejtshme e vendosi në shtëpinë e tij. Fakti se e dëmtuara i ka sjellë alkool të akuzuarit derisa ai ka qenë në treg e pastaj i ka ndihmuar atij që ta dërgojë në shtëpinë e tij, nga kafeneja ku ka qenë duke u kotur, nuk paraqesin arsye të cilat përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, por përkundrazi keqpërdorim ndaj mirësjelljes së saj.

Nga gjendja faktike e vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, me aktgjykimin e ankimuar drejtë është zbatuar ligji penal dhe drejtë ka vendosur Gjykata e Shkallës së Parë kur ka gjetur se në veprimet e të akuzuarit L. H. qëndrojnë të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale dhunimi nga neni 193 par.3 nën par.1 dhe 2 të KPPK. I akuzuari para dhe gjatë Dhunimit duke përdorur forcë i ka shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarës duke e torturuar dhe duke e trajtuar në mënyrë jo njerëzore që si pasojë ka pasur çrregullim të rëndë të shëndetit fizik dhe shpirtëror të saj, prandaj pretendimet ankimore se ligji penal me aktgjykimin e ankimuar është zbatuar në dëm të akuzuarit, janë të pabazuara.

Thëniet ankimore të Prokurorit Publik të Qarkut në Prishtinë se vendimi për dënim me aktgjykimin e ankimuar nuk i përgjigjet intensitetit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe se me të nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit, janë të bazuara, kurse thëniet e mbrojtësit të të akuzuarit se vendimi për dënim është i kundërligjshëm, si pasojë e mos vërtetimit të ekzistimit të veprës penale në anën e tij, janë të pabazuara.

Rrethanat lehtësuese të njohura të akuzuarit gjatë matjes së dënimit me aktgjykimin e ankimuar, si drejtë të vlerësuara i pranon edhe kjo Gjykatë. Edhe pse të akuzuarit gjatë matjes së dënimit nuk i është marrë asnjë nga rrethanat rënduese, aktgjykimi i ankimuar u ndryshua përkitazi me vendimin për dënim duke pasur parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale për të cilin është shpallur fajtor i akuzuari, ashtu që i njëjti për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor u gjykua me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj.

Dënimi i shqiptuar të akuzuarit me këtë aktgjykim është në përputhshmëri me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij, me të cilin mund të pritët që do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me dispozitën nga neni 34 të KPPK, ashtu që ky dënim në të ardhmen do të ndikojë që i akuzuari të përmbahet nga kryerja e veprave penale dhe të ndikojë në rehabilitimin e tij, e gjithashtu të ndikojë edhe te të tjerët që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Nga sa u parashtrua më lart e në kuptim të dispozitës nga neni 426 të KPPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Ap.nr.160/2005, datë 14.05.2005

Procesmbajtëse,  
Mejreme MemajAnëtarët e kolegjit,  
Gjuran Dema  
Miftar Jasiqi  
Dr.Hamdi Podvorica  
Mr.sc.Fejzullah HasaniKryetari i kolegjit,  
Agim Krasniqi

**[Gjykata Supreme - Aktvendim mbi Kodin Penal - Neni 327 (2) KPPK- Neni 20 KPPK- Furnizimi, transporti, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve - ankesë për ndryshimin e dënimit]**

*Prokurori i Qarkut në Prizren paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, duke bërë pretendimin ankimor se dënimi i Gjykatës së Qarkut ishte tejet i butë dhe propozoi të shqiptoi një dënim më të rëndë.*

*I pandehuri ishte akuzuar për furnizimi, transportimi, prodhimi, shkëmbimi apo shitja e paautorizuar e armëve, ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me 5 muaj burg.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së parë kishte tejçmuar rrethanat lehtësuese dhe shqiptoi dënimin me burg i cili nuk është në përputhje me intensitetin të rrezikut shoqëror dhe shkallës së përgjegjësisë penale. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e prokurorit të qarkut është e bazuar.*

Ap.nr.165/2005

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Zait Xhemajli, kryetar, Avdi Dinaj e Miftar Jasiqi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Drita Rexhaj, procesmbajtëse, në çështjen penale të të akuzuarit B. Th., nga fshati Rogovë, komunë e Gjakovës, për veprën penale furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve në tentativë nga neni 327 par.2 lidhur me nenin 20 të KPPK, duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut Prizren, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prizren, P.nr.214/2004 datë 14 janar 2005, në seancën e kolegjit të mbajtur më 28 qershor 2005, mori këtë

**A K T G J Y K I M**

Me aprovimin e ankesës së Prokurorit Publik të Qarkut Prizren, aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prizren, P.nr.214/2004 datë 14 janar 2005, ndryshohet përkritazi me vendimin për dënimin, ashtu që Gjykata Supreme të akuzuarin B. Th., për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, e gjykon me dënim burgu në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajsh, në të cilin i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej 9 dhjetor 2004 gjer më 14 janar 2005.

**A r s y e t i m i**

Gjykata e Qarkut Prizren, me aktgjykimin P.nr.214/2004 datë 14 janar 2005, të akuzuarin B. Th. e ka shpallur fajtor për veprën penale furnizimi, transporti, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve në tentativë nga neni 327 par.2 lidhur me nenin 20 të KPPK dhe e ka gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajsh; e ka obliguar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe 50 € në emër të shumës paushalle.

Ndaj të akuzuarit është shqiptuar masa e sigurisë marrja e 720 fishekëve të pushkës automatike të kal.7,622 mm, 250 copë fishekë të pushkës së gjuetisë të kal. 12mm, 100 fishekë të revoles së kal. 7,62, një revole të tipit QZ "Zbrojevka" me nr. serik 694965 e kal. 7,55mm, një karikatorë me 6 fishekë të kal. 7,55mm si mjete të kryerjes së veprës penale.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka paraqitur Prokurori Publik i Qarkut Prizren vetëm përkritazi me vendimin për dënimin, me propozim që kjo Gjykatë aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë, ashtu që të akuzuarit, për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, t'i shqiptojë dënim më të ashpër

Gjykata Supreme mbajti seancën e kolegjit, në të cilën edhe pse të njoftuar me rregull i akuzuari, mbrojtësi i tij av. Nexhat Elshani nga Prizreni si dhe Prokurori Publik i Kosovës, nuk morën pjesë, por Prokurori Publik i Kosovës me propozimin me shkrim PPA.nr.165/2005 datë 30.03.2005, ka propozuar që ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut të aprovohet si e bazuar.

Gjykata Supreme i shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko penale, studioi aktgjykimin e ankimuar konform dispozitës së nenit 415 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë kjo Gjykatë e shqyrtoi atë edhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 415 të KPPK dhe gjeti se nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin prishjen e tij. Po ashtu, as gjendja faktike e vërtetuar nga Gjykata e Shkallës së Parë nuk kontestohet, prandaj ajo nuk ka qenë objekt shqyrtimi nga ana e kësaj Gjykate.

Duke e shqyrtuar çështjen përkritazi me vendimin për dënimin, Gjykata Supreme gjen se ankesa e paraqitur është e bazuar. Si rrethana lehtësuese, të cilat Gjykata e Shkallës së Parë i ka njohur të akuzuarit kanë qenë: pranimit i

veprës penale, sjellja korrekte para Gjykatës, pa dënueshmëria e tij kurse rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, Gjykata e Shkallës së Parë i ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese dhe ka shqiptuar dënim me burg si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, i cili nuk është në përpjestim me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si ekzekutor, duke pasur parasysh se të i akuzuari është gjetur sasi e madhe e municionit të ndryshëm, si dhe revolva, sipas të akuzuarit kanë qenë të dedikuara për tregti, që paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore.

Prandaj, duke i pasur parasysh këto rrethana, kjo Gjykatë të akuzuarit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitën e nenit 34 të KPPK.

Nga sa u tha më lart e në pajtim me dispozitën e nenit 426 të KPPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Ap.nr.165/2005, datë 28 qershor 2005

Procesmbajtëse,  
Drita Rexhaj

Anëtarët e kolegjit,  
Avdi Dinaj  
Miftar Jasiqi

Kryetari i kolegjit,  
Zait Xhemajli

**[Gjykata Supreme - aktvendim mbi Kodin Penal - neni 297 (5) KPPK rrezikimi i trafikut publik - neni 358 KPPPK - deklarimi i fajësisë - neni 358 KPPPK - neni 403 KPPPK- rrethanat lehtësuese - neni 64 KPPK -neni 66,42,43 i KPPPK-së]**

*Avokati mbrojtës paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, duke bërë pretendimin ankimor se Gjykata e Qarkut në aktvendimin e vet kishte shkelur dispozitat e kodit penal dhe të procedurës penale , dhe kishte bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.*

*I pandehuri ishte akuzuar për rrezikimin e trafikut publik, ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me 1 vjet burg*

*Gjykata Supreme ka vendosur se nuk ka bazë për kundërshtimin e aktvendimit të Gjykatës së shkallës së parë për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike duke marrë parasysh se i pandehuri është deklaruar fajtor gjatë shqyrtimit kryesor në secilën pikë të aktakuzës. . Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së parë kishte zbatuar drejtë nenin 351 (1) dhe 359(2) të KPPPK-së. Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e Qarkut nuk kishte vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe kishte shqiptuar dënimin i cili nuk ishte në përpjestim me intensitetin e rrezikut shoqëror dhe shkallës së përgjegjësisë penale. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e avokatit mbrojtës është pjesërisht e bazuar.*

Ap.nr.180/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Miftar Jasiqi, kryetar, doc.dr. Hamdi Podvorica dhe mr.sc.Fejzullah Hasani, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesionale Minire Xhambazi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit H. H. nga fshati Gllavnik i Komunës së Podujevës, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, të parashikuar nga neni 297 par.5 të KPPK-së, përkitazi me ankesën e të akuzuarit H. H. të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.nr.347/2004 datë 23.02.2005, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 410 të KPPPK-së, më 24.05.2005, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me pranimin e pjesshëm të ankesës së të akuzuarit H. H., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.nr.347/2004 datë 23.02.2005, vetëm përkitazi me vendimin për dënimin, ashtu që Gjykata Supreme për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, pas zbutjes së dënimit sipas nenit 66 të KPPK-së dhe me zbatimin nenit 42 dhe 43 të KPPK-së, të akuzuarin

e gjykon me dënim të kushtëzuar, duke i shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale në afatin prej 2 (dy) vjetësh.

### A r s y e t i m i

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me aktgjykimin P.nr.347/2004 datë 23.02.2005, të akuzuarin H. H. e ka shpallë fajtor për veprën penale rrezikimi i trafikut publik të parashikuar nga neni 297 par.5 të KPPK-së dhe për këtë vepër penale e ka gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim prej 20.04.2004 deri më 02.06.2004. E ka detyruar që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë 100 € dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit. Për realizimin e kërkesës pasurore-juridike të dëmtuarën S. M. e ka udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë të afatshme i akuzuari H. H. për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe për shkak të vendimit për sanksionin penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës aktgjykimin e ankimuar ta prishë dhe çështjen t'ia kthejë Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim dhe vendim, ose ta ndryshojë përkritazi me vendimin për dënimin ashtu që të akuzuarin ta gjykojë me dënim të kushtëzuar. Ka kërkuar që ai dhe mbrojtësi i tij av. Hasan Rexha të njoftohen për seancën e kolegjit.

Gjykata Supreme mbajti seancën e kolegjit konform nenit 410 të KPPPK-ës, në të cilën mbrojtësi i të akuzuarit dhe i akuzuari pasi sqaruan pretendimet ankimore të parashtruara, ngelën pranë propozimeve të bëra në ankesë.

Prokurori Publik i Kosovës ka propozuar në shkresën PPA.nr.180/2005 datë 26.04.2005, që ankesa e të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar kurse aktgjykimi i kundërshtuar të vërtetohet.

Gjykata Supreme, pas shqyrtimit të shkresave të kësaj çështje juridike penale, studimit të aktgjykimit të ankimuar lidhur me nenin 415 të KPPPK-ës, vlerësimin të pretendimeve ankimore në ankesë, gjeti se:

Ankesa e të akuzuarit është pjesërisht e bazuar.

Në ankesën e ushtruar pretendohet se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale neni 403 par.1 nënpar.9 të

KPPPK-së, se nuk i është dhënë mundësi të akuzuarit të deklarohet për pranimin e fajësisë për secilën pikë të aktakuzës dhe se aktgjykimi është i kundërligjshëm.

Gjykata Supreme gjen se Gjykata e Shkallës së Parë drejt ka zbatuar dispozitat e nenit 358 të KPPPK-së, andaj pretendimet ankimore se nuk i është dhënë mundësia të akuzuarit të deklarohet për të gjitha pikat e aktakuzës për pranimin e fajësisë dhe se aktgjykimi është i kundërligjshëm, janë të pabazuara. Nga shkresat e lëndës rezulton se në shqyrtimin kryesor i akuzuari e ka pranuar fajësinë për tërë aktakuzën. Me pranimin e fajësisë të akuzuarit është pajtuar edhe trupi gjykues dhe as i akuzuari e as mbrojtësi i tij nuk kanë paraqitur vërejtje sa i përket pranimit të fajësisë të akuzuarit për tërë akuzën. Nga kjo rrjedhë se Gjykata e Shkallës së Parë ka zbatuar drejtë dispozitat e nenit 358 të KPPPK-së dhe ka marrë aktgjykim të ligjshëm.

As pretendimet ankimore se aktgjykimi i kundërshtuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 403 par.1 nën par.8 dhe nga neni 402 par.3 të KPPPK, për shkak se bazohen në prova të papranueshme dhe se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë, nuk qëndrojnë. Në bazë të nenit 402 par.2 të KPPPK-së, kur i akuzuari ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës dhe trupi gjykues është pajtuar me pohimin e tillë, konsiderohet se edhe gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të saktë dhe të plotë, ashtu që as ndaj aktgjykimit nuk mund të ushtrohet ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike. Aktgjykimi i ankimuar nuk përmban as shkelje të tjera esenciale për të cilat Gjykata i shqyrton sipas detyrës zyrtare, e të cilat kishin për ta kushtëzuar prishjen e këtij aktgjykimi.

Qëndron fakti se Gjykata e Shkallës së Parë në kundërshtim me dispozitat e nenit 387 par.1, aktgjykimin e bazon edhe në prova të cilat nuk i ka proceduar në shqyrtim gjyqësor, si: mendimi dhe konstatimi i ekspertit të trafikut datë 06.05.2004 dhe shikimi i fotodokumentacionit të vendngjarjes, mirëpo, kjo Gjykatë gjen se në çështjen konkrete juridike ky lëshim nuk ka peshën e ndikimit të prishjes së aktgjykimit të ankimuar, sepse duke marrë parasysh pranimin e fajësisë së të akuzuarit për tërë aktakuzën dhe pajtimin e trupit gjykues me këtë, edhe pa këto prova, do të merrej i njëjti aktgjykim. Pra, është zbatuar drejt edhe ligji penal.

Pretendimi ankimore përkritazi me vendimin për dënimin është i bazuar. Gjykata e Shkallës së Parë, duke i vlerësuar rrethanat plotësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe në lartësinë e sanksionit penal, në mbështetje të nenit 64 të KPPK-së, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin merr parasysh faktin se ai më parë nuk ka qenë i akuzuar, se ishte i moshuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, se është at i 5 fëmijëve dhe i gjendjes së vështirë ekonomike, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese nuk ka gjetur,

rrethana këto të cilat i parovon edhe kjo Gjykatë. Mirëpo, sipas vlerësimit të

Gjykatës Supreme, është dashur të kihet parasysh si rrethanë lehtësuese edhe sjelljen korrekte para dhe pas kryerjes së veprës penale të akuzuarit, pendimi i tij i thellë, ndërsa si rrethanë veçanërisht lehtësuese gjendjen e tij të rëndë shëndetësore, i cili vuan nga sëmundja Diabetes mellitus dhe gangrena, përça i janë amputuar gishtrinjtë e këmbës së djathtë dhe lëvizë me vështirësi.

Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartpërmendura, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, duhet zbutur dënimi me aplikimin e dispozitave të nenit 66 dhe me zbatimin edhe të nenit 42 dhe 43 të KPPPK-së, të akuzuarit t'i shqiptohet dënimi i kushtuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, sepse ky sanksion penal është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se me të do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i parashikuar me dispozitën e nenit 34 të KPPK, që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, që të bëjë rehabilitimin e tij dhe që të përmbajë persona të tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi komfor dispozitës së nenit 426 par.1 të KPPPK.

#### GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ap.nr. 180/2005, datë 24.05.2005

Procesmbajtësja,  
Minire Xhambazi

Anëtarët e kolegjit,  
Doc.dr.Hamdi Podvorica  
Mr.sc.Fejzullah Hasani

Kryetari i kolegjit,  
Miftar Jasiqi

#### **[Gjykata Supreme - aktvendim mbi Kodin Penal - neni 328 (1) KPPK mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paaautorizuar të armëve - neni 160 KPPPK- neni 403 (1) ((2)) KPPPK]**

*Avokati mbrojtës paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, duke bërë pretendimin ankimor se Gjykata e Qarkut në aktvendimin e vet kishte shkelur dispozitat e kodit penal dhe të procedurës penale, dhe kishte bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.*

*I pandehuri ishte akuzuar për marrje në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të paaautorizuar të armëve, ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me 5 muaj burg.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së parë, kishte dhënë një gjendje faktike e cila ishte vërtetuar duke ofruar arsye të qarta, logjike dhe bindëse për të provuar faktet dhe se kishte përshkruar rezultatin e procedurës së dëshmimeve përkitazi me faktet vendimtare. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e avokatit mbrojtës është e pabazuar.*

Ap.nr.183/2005

#### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Riza Loci, kryetar, doc.dr. Hamdi Podvorica dhe mr.sc.Fejzullah Hasani, anëtarë, procesmbajtësja, Minire Xhambazi, bashkëpunëtoresh profesionale, në çështjen penale kundër të akuzuarit Rr. L., nga fshati Bainsë, komuna Drenasit, për shkak të veprës penale mbajtje në pronësi, në posedim, në kontroll, apo në shfrytëzim të paaautorizuar të armëve të parashikuar nga neni 328 par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit Cenë Gashi, avokat nga Klina, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prishtinë, P.nr.400/2004 datë 25.02.2005, në seancën e kolegjit të mbajtur në pajtim me nenin 410 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK), më datë 31.3.2005, mori këtë

#### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit Rr. L., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prishtinë, P.nr.400/2004 datë 25.02.2005, vërtetohet.

## A r s y e t i m

Gjykata e Qarkut Prishtinë, me aktgjykimin P.nr.400/2004 datë 25.02.2005, të akuzuarin Rr. L. e ka shpallur fajtor për veprën penale mbajtje në pronësi, në posedim, në kontroll apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve parashikuar nga neni 328 par.1 të KPPK, për të cilën e ka gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajsh, në të cilën i ka llogaritur kohën e kaluar në paraburgim prej 28.06.2004 deri më 20.07.2004. I ka konfiskuar revolen tipi "TT" kal.1.7,62 mm si mjet i kryerjes së veprës penale. I dëmtuari A. L. e ka udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pronësore juridike. Ka detyruar të akuzuarin që në emër paushallit gjyqësor të paguajë 100 € si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së Gjykatës, në afatin prej 15 ditësh, pasi aktgjykimi të ketë marrë formë të prerë.

Kundër këtij aktgjykimi mbrojtësi i të akuzuarit Rr. L., Cenë Gashi, avokat nga Kilna, ka ushtruar ankesë të afatshme, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës aktgjykimin e ankimuar ta prishë dhe çështjen t'ia kthejë të njëjtës Gjykatë në rigjykim dhe vendosje ose ta ndryshojë, ashtu që të akuzuarit Rr. L. t'i shqiptojë një dënim të kushtëzuar.

Gjykata Supreme mbajti seancën e kolegjit në pajtim me nenin 410 të KPPPK, në të cilën mbrojtësi i të akuzuarit dhe i akuzuari, pasi sqaruan pretendimet ankimore të parashtruara, qëndruan në propozimet e bëra në ankesë.

Prokurori Publik i Kosovës, me parashtrësën PPA.nr.183/2005 datë 26.4.2005, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit Rr. L. të refuzohet si e pabazuar kurse aktgjykimi i kundërshtuar të vërtetohet.

Gjykata Supreme pas shqyrtimit të shkresave të kësaj çështje juridike-penale, ekzaminimit të aktgjykimin të ankimuar sipas nenit 415 të KPPPK dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Sipas pretendimeve ankimore të parashtruara në ankesë, aktgjykimi ankimor përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale parashikuar nga neni 403 par.1 nën.par.12 të KPPPK, sepse dispozitivi i aktgjykimit është kundërthënë në brendinë e tij ose me arsyet e aktgjykimit, në të nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare dhe aktgjykimi është bazuar vetëm në deponimet e dëshmitarëve dhe të dëmtuarve, të cilët mes veti

janë gjini e afërt.

Gjykata Supreme vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet e lartpërmendura ankimore e as që ka shkelje të tjera esenciale të cilat kjo Gjykatë i merr parasysht sipas detyrës zyrtare e të cilat do të kushtëzohin prishjen e aktgjykimit.

Aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale parashikuar nga neni 403 par.1 nën.par.12 të KPPPK, të cilave vetëm në mënyrë të përgjithësuar e pa bazë ligjore u referohet ankesave. Në të vërtetë Gjykata e Shkallës së Parë në arsyetimin e aktgjykimit ankimor ka parashtruar gjendjen faktike të cilën e ka vërtetuar duke dhënë arsye të qarta, logjike dhe bindëse për vërtetimin e fakteve, ka përshkruar rezultatin e procedurës provuese lidhur me faktet vendimtare dhe ka dhënë vlerësimin për provat e shtjelluara duke arsyetuar se për ç'arsye disa fakte i mori si të provuara e disa jo, ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit e ka dhënë arsye të qarta për ç'arsye nuk e pranoi versionin e mbrojtjes të të akuzuarit, por dëshmitë e dëshmitarëve: H. L., A. L. dhe H. E. dhe të dëmtuarve: B. L., B. L. dhe H. L., të cilat në të tërësi i mbështet edhe kjo Gjykatë. Të qenurit gjini e afërt e të dëmtuarve ose e dëshmitarëve, nuk përbënë bazën ligjore për lirim të tyre nga detyra e dëshmitarit (neni 160 i KPPPK). Prandaj, edhe Gjykata Supreme vlerëson se konstatimi i Gjykatës së Shkallës së Parë se duhet kushtuar besimin dëshmisë së të dëmtuarve dhe dëshmitarëve është i drejtë, sepse ata me ato dëshmi kanë ofruar të dhëna, fakte të qarta, konkrete dhe bindëse për çështjen, të cilat kanë mbështetje edhe në të gjitha provat e tjera të administruara.

Sa i përket bazës ankimore se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabueshme ose jo të plotë, në ankesë pretendohet se deklaratat e të akuzuarit janë diametralisht të kundërta me deponimet e dëshmitarëve dhe të dëmtuarve, se nuk është bërë ballafaqimi në rrethanat kontestuese mes të akuzuarit, dëshmitarëve dhe të dëmtuarve dhe i akuzuari ka shtënë revole atëher kur i kanosej rreziku, pasi të dëmtuarit kishin kaluar dëshmitarin H. L. dhe i afroreshin të akuzuarit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme edhe këto pretendime ankimore nuk rezultojnë të bazuara. Nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor datë 01.2005 rezulton se i akuzuari ka pohuar që ditën kritike ka shtënë njëherë revole në ajër. Me të drejtë Gjykata e Shkallës së Parë aktgjykimin e ka mbështetur edhe në këtë pjesë të mbrojtjes së tij, sepse ajo nuk ishte në kundërshtim me asnjë provë të administruar e as me deponimet e dëshmitarëve dhe të dëmtuarve. Në rrethanat kontestuese nuk ka qenë e mundur të bëhet ballafaqimi i të akuzuarit me dëshmitarët dhe të dëmtuarit, sepse kur janë dëgjuar dëshmitarët dhe të akuzuarit, siç del nga procesi i shqyrtimit gjyqësor datë 24.2.2005, i akuzuari është mbrojtur në heshtje. Është provuar në mënyrë

të plotë dhe të drejtë me deponimet e dëshmitarëve B. L., B. L., H. L. Dhe dëshmitarit H. L. u se i akuzuar ka shtënë revole kur të dëmtuarit: B. L., B. L. dhe H. L., janë kthyer mbrapa për të shkuar në shtëpitë e tyre. I akuzuari kishte shkuar me kamion për t'i bartur sanë nga livadhi H. L.. Kjo tregon se ata kanë qendruar në marrëdhënie të mira njëri me tjetrin. Nga ky shkak dyshimi i shprehur në ankesë në objektivitetin e këtij dëshmitari, dëshmitarëve të tjerë dhe të dëmtuarve janë të pabazuara, aq më tepër se ato nuk ishin në kundërshtim njëra me tjetrën dhe ata ishin të pranishëm gjatë gjithë zhvillimit të ngjarjes. Andaj, duhet theksuar se këto deponime janë prova të sigurtë e të padyshimta. Arsyet më detajisht të cituara në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar si të drejta në tërësi i pranon edhe kjo Gjykatë.

Së këndejmi, duke u gjetur në praninë e kësaj gjendje faktike të vërtetuar dalin të pabazuara pretendimet ankimore në ankesë, kurse, në anën tjetër, del i drejtë, logjik dhe i ligjshëm konkludimi i Gjykatës së Shkallës së Parë se në veprimet e të akuzuarit përbushen të gjitha tiparet e veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve të parashikuara nga neni 328 par.1 i KPPPK. Nga kjo rrethje se drejtë janë aplikuar edhe dispozitat e ligjit penal.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimet, Gjykata Supreme vlerëson se edhe në këtë bazë pretendimet ankimore nuk janë të bazuara. Mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë thekson se të akuzuarit është dashur që si rrethana lehtësuese t'i merren parasysh edhe: "Pranimi i sinqertë i veprës penale (par.2 nga neni 328 të KPPK) nga i akuzuari, mos ikja nga vendbanimi, tregimi i armës dhe dorëzimi i saj pa kërkesën e policisë, pendimi i sinqertë dhe real, sjellja e të akuzuarit gjatë gjithë procedurës". Ka pretenduar se këto rrethana kushtëzojnë shqiptimin e gjykimit me kusht.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme rezultojnë të pabazuara edhe këto pretendime ankimore, sepse rrethanat e lartëpërmendura nuk mund të merren parasysh si lehtësuese në rastin konkret, sepse pranimi i veprës tjetër penale jo i fajësisë për veprën për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor nuk është rrethanë lehtësuese. S'mund të jetë rrethanë lehtësuese pendimi i sinqertë dhe real, nëse i akuzuari fare nuk e pranon veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, e as mos ikja nga vendbanimi apo tregimi i armës dhe dorëzimi i saj, për arsye se ato nuk kanë kurrfarë ndikimi në matjen e llojit dhe të lartësisë së dënimit.

Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë më lart dhe faktin se Gjykata e Shkallës së Parë me rastin e matjes së llojit e të lartësisë së dënimit, drejt i ka vlerësuar të gjitha rrethanat siç parasheh dispozita e nenit 64 e KPPK, del se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në proporcion me veprën, me sjelljet e rrethanat e kryerësit, në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe

me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitën e nenit 34 të KPPK, që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, që të bëjë rehabilitimin e tij dhe që të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprës penale.

Nga sa u tha më lartë dhe në pajtim me dispozitën e nenit 423 të KPPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Ap.nr. 183/2005, datë 31.05.2005

Procesmbajtësja,  
Minire XhambaziAnëtarët e kolegjit,  
Doc.dr. Hamdi Podvorica  
Mr.sc.Fejzullah HasaniKryetari i kolegjit  
Riza Loci

**[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Kodin Penal - Neni 328(2) KPPK mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve - Neni 159 (1) KPPK - rrëmbim i personit - Neni 161 (2) KPPK - kanosje - kualifikim ligjor - bashkim i veprave penale dënime i përbashkët - Neni 403 (1) ((12))]**

*Avokati mbrojtës paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, duke bërë pretendimin ankimor se Gjykata e Qarkut në aktvendimin e vet kishte shkelur dispozitat e kodit penal dhe të procedurës penale dhe kishte bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.*

*I pandehuri ishte akuzuar për marrje në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve dhe kidnapim, ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me 5 muaj burg.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së parë, kishte dhënë një gjendje faktike e cila ishte përcaktuar duke ofruar arsye të qarta, logjike dhe bindëse për provimin e fakteve dhe se kishte përshkruar rezultatit e procedurës së dëshimive përkitazi me faktet vendimtare. Gjykata Supreme gka vendosur se aktvendimi i Gjykatës së shkallës së parë përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale përkitazi me përshkrimin faktik të veprës penale. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e avokatit mbrojtës është pjesërisht e bazuar.*

Ap.nr.248/2005

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Miftar Jasiqi, kryetar, Zait Xhemajli e doc.dr. Hamdi Podvorica, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesionale, Mejreme Memaj, procesmbajtëse, në çështjen penale të të akuzuarit N. T., nga fshati Piranë, komuna e Prizrenit, për veprë penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim, ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPPK, rrëmbimi i personit nga neni 159 par.1 të KPPK dhe kanosja nga neni 161 par.2 të KPPK, duke vendosur sipas ankesave të Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren dhe mbrojtësve të të akuzuarit, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, P.nr.27/2005 datë 6.04.2005, në seancën e mbajtur konform dispozitës së nenit 410 të KPPK, më 27.07.2005, mori këtë

## A K T G J Y K I M

Me aprovimin e pjesshëm të ankesave të mbrojtësve të të akuzuarit N. T.:

- ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, P.nr.27/2005 datë 6.04.2005, në pjesën nën 2 të dispozitivit, përkitazi me cilësimin juridik dhe vendimin për dënimin, ashtu që Gjykata Supreme të akuzuarin e shpall fajtor për veprë penale rrëmbim i personit nga neni 159 par.3 të KPPK dhe për këtë veprë e gjykon me dënim me burg në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muajve, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 19.01.2005,

-në pjesët nën 1 dhe 3 të dispozitivit, priset dhe çështja në këtë pjesë i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim.

Ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren, për pjesën nën 2 të dispozitivit, përkitazi me veprën penale të rrëmbimit të personit nga neni 159 të KPPK, refuzohet si e pabazuar, ndërsa për pjesët tjera të aktgjykimit kjo ankesë tani për tani është jo lëndore.

## A r s y e t i m i

Gjykata e Qarkut në Prizren, me aktgjykimin P.nr.27/2005 datë 6.04.2005, të akuzuarin N. T. e ka shpallur fajtor për tri vepra penale dhe atë për veprë penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim, ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPPK, për veprë penale rrëmbim i personit nga neni 159 par.1 të KPPK dhe për veprë penale kanosje nga neni 161 par.2 të KPPK dhe i ka shqiptuar për secilën veprë dënimin veç e veç kurse me aplikimin e nenit 71 të KPPK për këto tri vepra e ka gjykuar me dënim unik me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim ia ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim prej datës 21 janar 2005.

Ndaj të akuzuarit Gjykata ka shqiptuar edhe dënimin plotësues marrjen e revoles TT-M57 me nr.serik C38037, kal.7,62 mm dhe 7 predha të kal.9 mm, kurse të dëmtuarit E. B. dhe E. B. për realizimin e kërkesës pronëroro-juridike i ka udhëzuar në kontest civil. Gjykata të akuzuarin gjithashtu e ka obliguar që t'i paguajë edhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 200 €.

Kundër këtij aktgjykimi me afat ankesë kanë paraqitur:

- Prokurori Publik i Qarkut në Prizren, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i ashpër.

- ankesë të përbashkët mbrojtësit e të akuzuarit av. Lulzim Billurdagu dhe Nexhat Elshani, për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të

gjendjes faktike dhe vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga aktakuza dhe që i njëjti të priset dhe çështja t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim;

- mbrojtësi i të akuzuarit av. Ymer Osaj, për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i kundërshtuar të priset dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim dhe ndaj të akuzuarit të ndërpritet paraburgimi duke ia mundësuar që i njëjti të mbrohet në liri.

Mbrojtësit e të akuzuarit me ankesa kanë parashtuar propozimin që konform dispozitës së nenit 410 të KPPK të njoftohen për seancën e kolegjit.

Duke u bazuar me propozimin e parashtuara me ankesa, Gjykata Supreme caktoi seancën e kolegjit në të cilën ishin prezent mbrojtësit e të akuzuarit av. Lulzim Billurdagu, Nexhat Elshani dhe Ymer Osaj, ndërsa i akuzuari meqë gjindet në paraburgim i njëjti konform dispozitës së nenit 410 par.2 të KPPK nuk ka shfaqur dëshirën që të marrë pjesë në seancë. Në seancë nuk ishte prezent as Prokurori Publik i Kosovës edhe pse i njoftuar me rregull, por i njëjti me parashtresën me shkrim PPA.nr.248/2005 datë 27.06.2005, ka propozuar që ankesat e mbrojtësve të të akuzuarit të refuzohen si të pabazuara ndërsa ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut të aprovohet si e bazuar. Në seancë mbrojtësit e të akuzuarit secili veç e veç, pasi dhanë disa sqarime përkitazi me pretendimet ankimore, në tërësi ngelën sipas propozimeve të bëra në ankesa.

Gjykata Supreme shqyrtoi shkresat e kësaj lënde, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 415 të KPPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, konstatoi:

Ankesat e mbrojtësve të të akuzuarit janë pjesërisht të bazuara ndërsa ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut, në pjesën që ka të bëjë me veprën penale të rrëmbimit të personit nga neni 159 par.1 të KPPK, nuk është e bazuar. Ndërsa për pjesët tjera të aktgjykimin, për tani, është jo lëndore.

Mbrojtësit e të akuzuarit me ankesa pretendojnë se aktgjykimi i kundërshtuar është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës penale të parashikuara me nenin 403 par.1 pika 12 të KPPK, ngase dispozitivi i aktgjykimin të kundërshtuar është i paqartë, është në kundërshtim me arsyetimin dhe se për faktet vendimtare nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme, përkitazi me veprimet e të akuzuarit, veprime këto të cilësuar si vepra penale për të cilat është shpallur fajtor. Sipas ankesave dispozitivi i aktgjykimin është kontradiktor me atë ç'ka thuhet në arsyetimin e aktgjykimin për faktin se siç rezultojn edhe nga aktgjykimi i kundërshtuar Gjykata aktgjykimin e ka bazuar pjesërisht edhe në pranimin e të akuzuarit ndërsa, i akuzuari nuk e ka pranue

Asnjërin prej veprave penale për të cilat është shpallur fajtor. Duke e shqyrtuar aktgjykimin e kundërshtuar përkitazi me këto pretendime ankimore, Gjykata Supreme vlerëson se këto pretendime pjesërisht janë të bazuara. Qëndron fakti se i akuzuari N. T. nën 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimi është shpallur fajtor për armëmbajtje pa leje ngase më 19.01.2005, me rastin e bastisjes së shtëpisë së tij në një stog sane afër shtëpisë së tij është gjetë se pa lejen e organit kompetent ka mbajtur një revole të tipit TT kal.7,62 mm. Nga shkresat e lëndës rezultojn se ditën kritike i akuzuari më datë 19.01.2005 ka qenë në paraburgim dhe se me rastin e bastisjes së shtëpisë së tij kur është gjetur revolja në fjalë i përmenduri nuk ka qenë prezent. Bazuar në këtë Gjykata e Shkallës së parë nuk ka dhënë arsye mbi faktin vendimtar se si dhe në ç'mënyrë i akuzuari e ka mbajtur këtë armë, a ishte ai në posedim, në pronësi apo në përdorim të kësaj arme, rrethana këto të cilat meqenëse përveç të akuzuarit në shtëpinë ku është bërë bastisja, jetojnë edhe anëtarët tjerë të familjes, aktgjykimin e bëjnë të pakjartë. Po ashtu, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të bazuara janë edhe pretendimet ankimore përkitazi me përshkrimin e veprimeve të të akuzuarit sa i takon veprën penale të kanosjes të përshkruar nën 3 të dispozitivit të aktgjykimin të kundërshtuar, sidomos pretendimet se kjo vepër penale ndiqet sipas propozimit dhe se në rastin konkret përkitazi me këtë çështje nga ana e të dëmtuarit nuk ka propozim. Bazuar në këtë Gjykata Supreme gjen se në këtë pjesë aktgjykimi i kundërshtuar përkitazi me përshkrimin faktik të veprës penale nën 1 dhe nën 3 të këtij aktgjykimi është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës penale të parashikuara me nenin 403 par.1 pika 12 të KPPK dhe si i tillë nuk mund të qëndrojë, andaj në këtë pjesë i njëjti duhet të priset.

Duke e shqyrtuar aktgjykimin e kundërshtuar përkitazi me pretendimet ankimore për vërtetim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, Gjykata e Shkallës së Parë gjen se pretendimet ankimore të mbrojtësve të të akuzuarit edhe në këtë pjesë janë pjesërisht të bazuara. Gjykata e Shkallës së Parë, siç rezultojn nga shkresat e lëndës, me rastin e kontrollimit të shtëpisë së të akuzuarit N. T., më datë 19.01.2005, në një stog me duaj të kashtës policia ka gjetë një revole të tipit TT kal.7,62 mm. Në shkresat e lëndës nuk ka procesverbal mbi marrjes e sendeve e as të kontrollit nga i cili do të shihej se nga i akuzuari është marrë revolja në fjalë, kurse po ashtu nga shkresat e lëndës rezultojn se i akuzuari me rastin e bastisjes së shtëpisë nuk ka qenë në shtëpi, meqë ishte në paraburgim. Bazuar në këtë, rezultojn se gjendja faktike përkitazi me këtë vepër penale nuk është vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë, meqë në shkresat e lëndës nuk ka prova se i akuzuari ishte në posedim të kësaj arme. Edhe sa i takon veprën penale të kanosjes, Gjykata e Shkallës së Parë nuk e ka vërtetuar plotësisht gjendjen faktike. Siç rezultojn nga shkresat e lëndës i akuzuari bashkëshorten e tij E. B. e ka kërcënuar duke i thënë: "eja më shpejt hyn në veturë sa nuk të kam vra ty dhe gjithë familjen tënde" dhe se kur ajo don të hyjë në veturë sërish i drejtohet me fjalë "largohu nga vetura se ti më nuk do të vjen te unë" dhe se me këtë rast e ka godit me dorëz të revoles në krah. Në

ankesat e mbrojtësve të të akuzuarit me të drejtë parashtrohet pyetja se kjo kanosje ishte serioze e nëse po, si do të guxonte tani e dëmtuara E. qe me vëllain e saj E. pas pak çastesh të shkonin në shtëpinë e të akuzuarit, i cili me atë rast nuk ka ndërmarrë asnjë veprim përveç se i ka thënë se ajo duhet të kthehet te baba i saj. Sa i takon veprës penale të rrëmbimit të personit Gjykata e Shkallës së parë drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike përkitazi me veprimet e të akuzuarit, veprime këto të cilësuar si rrëmbim të personit. Nuk është kontestuese se ditën kritike më datë 17.01.2001 i akuzuari N. kishte shkuar në familjen B. për ta marrë bashkshorten e tij E. dhe se me atë rast në oborrin e shtëpisë e kishte takuar vëllaun e bashkëshortes E. të cilin e kishte marrë dhe kishin shkue mbas shtëpie edhe atë nën kërcënimin e armës dhe se për këtë ngjarje, anëtarët e familjes B. e kishin njoftuar policinë. Me të ardhur policia, ata kishin kontaktuar me të akuzuarin nëpërmes telefonit dhe se ai u kishte thënë policisë se E. është mirë dhe se së shpejti do të kthehet në shtëpi e kështu edhe kishte ndodhur, pra përfaqësisht mbas dy orësh nga koha kur ai e kishte marrë E. ky i fundit pra i dëmtuari E. ishte kthyer në shtëpi. Bazuar në këtë gjendje të kësajsoji të vërtetuar faktike, përkitazi me veprimet e të akuzuarit sa i takon armëmbajtjes pa leje dhe kanosjes, Gjykata Supreme vlerëson se Gjykata e Shkallës së Parë nuk e ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike e si pasojë e kësaj ka ardhur edhe deri tek aplikimi i gabuar i ligjit penal. Sipas nenit 161 par.5 të KPPK, procedura penale për veprën penale nga paragrafët 1,2 dhe 3 të këtij neni fillohet sipas propozimit, në rastin konkret, siç rezulton nga shkresat e lëndës, ky propozim mungon. Në bazë të nenit 55 par.1 të KPPK, propozimi për ndjekje i paraqitet Prokurorit Publik. Bazuar në këtë Gjykata e Shkallës së Parë ka shkelë ligjin penal duke e shpallur të akuzuarin fajtor për veprën penale të kanosjes të parashikuar me nenin 161 par.2 të KPPK. Edhe sa i përket veprës penale të armëmbajtjes pa leje po ashtu Gjykata e Shkallës së Parë, meqë në shkresat e lëndës nuk ekzistojnë prova se i akuzuari ka qenë në posedim në pronësi apo në përdorim të armës, e cila është gjetë jashtë shtëpisë, në stog të kashtës, edhe në këtë rast e ka shkelë ligjin penal kur në mungesë të këtyre provave, të akuzuarin e ka shpallur fajtor. Gjykata e Shkallës së Parë ka shkelë ligjin penal në dëm të të akuzuarit edhe me rastin e shpalljes së të akuzuarit fajtor, gjegjësisht kur veprimet e të akuzuarit i ka cilësuar si veprë penale të rrëmbimit të personit nga neni 159 par.1 të KPPK, meqë siç rezulton nga shkresat e lëndës, por edhe nga gjendja faktike e vërtetuar drejt në këtë pjesë, nga Gjykata e Shkallës së Parë, përkitazi me këto veprime, i akuzuari në rastin konkret vullnetarisht e ka liruar personin e rrëmbyer edhe atë para se të jetë realizuar ndonjë kërkesë e tij, siç ishte ajo që ai ta merr bashkëshorten e tij E.. Prandaj, duke pasur parasysh këto rrethana, veprimet e të akuzuarit, Gjykata Supreme i cilësoi si veprë penale rrëmbimi i personit nga neni 159 par.3 të KPPK.

Duke e shqyrtuar aktgjykimin e kundërshtuar përkitazi me vendimin për dënimin vetëm sa i takon veprës penale rrëmbim i personit nga neni 159 Gjykata Supreme gjen se në këtë drejtim ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut

në Prizren është e pabazuar pasi që me ankesë nuk parashtrohet ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese, kurse ankesat e mbrojtësve të të akuzuarit janë të bazuara pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me veprë penale të cilësuar si rrëmbim i personit nga neni 159 par.3 të KPPK, me ç'rast sipas ligjit Gjykata për këtë veprë kryesin mund ta dënojë më butë ose ta lirojë nga dënimi. Bazuar në këtë Gjykata Supreme të akuzuarin duke e shpallur fajtor për veprë penale nga neni 159 par.3 të KPPK e gjykoi me dënim me burg në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muaj, në të cilin dënim ia llogarit edhe edhe kohën e kaluar në paraburgim prej datës 19.01.2005, kur i akuzuari është privuar nga liria e jo siç gabimisht ia ka llogaritur Gjykata e Shkallës së Parë prej datës 21.01.2005. Gjykata Supreme gjen se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe duke i marrë si të bazuara rrethanat lehtësuese të cilat i ka vlerësuar Gjykata e Shkallës së Parë, veçmas se kemi të bëjmë me një konflikt familjar, qëndrimin e të akuzuarit, gjendjen e tij familjare dhe duke pasur parasysh se është baba i tre fëmijëve, ndërsa bashkëshortja e tij tani E. jeton e ndarë nga fëmijët tek familja e babait, kështu që fëmijët kanë mbetur pa përkujdesje prindërore, llogarit se edhe me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimin i parashikuar me ligj. Ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut përkitazi me veprat penale nën 1 dhe 3 të dispozitivit të aktgjykimin të kundërshtuar për momentin tani është jo lëndore meqenëse në këtë pjesë aktgjykimi i kundërshtuar prishet dhe çështja i kthehet Gjykatës së Shkallës së parë për rigjykim.

Në rigjykim, për pjesën për të cilën aktgjykimin prishet, Gjykata e Shkallës së Parë, duhet që edhe njëherë, t'i administrojë provat e propozuara dhe provat e tjera për të cilat konsideron se janë të nevojshme për zbardhjen e kësaj çështje, e veçmas duke e dëgjuar në cilësi të dëshmitarit babain e të akuzuarit U. T., përkitazi me revolen e gjetur në stogun e kashtës. Gjykata e Shkallës së Parë po ashtu, konform dispozitës së nenit 55 par.1 të KPPK dhe nenit 161 par.5 të KPPK, duhet të vlerësojë se a ka propozim për ndjekje dhe pas vlerësimit të të gjitha provave si veç e veç dhe të gjitha së bashku, në pajtim me dispozitën e nenit 396 par.7 të KPPK, në këtë çështje penale, do të merr aktgjykim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e konform të dispozitës së nenit 426 dhe 424 par.5 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimin.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË  
Ap.nr. 248/2005, datë 27.07.2005

Procesmbajtësja,  
Mejreme Memaj

Anëtarët e kolegjit,  
Zait Xhemajli  
Doc.dr. Hamdi Podvorica

Kryetari i kolegjit  
Miftar Jasiqi

**Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Kodin Penal - neni 328 (2) KPPK mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve - ankesat për ndryshimin e dënimit - rrethanat lehtësuese në caktimin e dënimit - nenet 66, 42 KPPK- llogaritja e kohës së kaluar në paraburgim - neni 415 (1) 1) dhe neni 404 (1) 6) KPPK]**

*Prokurori i Qarkut në Prizren paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, duke bërë pretendimin ankimor se dënimi i Gjykatës së Qarkut ishte tejet i butë dhe propozoi që Gjykata të shqipton dënim efektiv me burg.*

*I pandehuri ishte akuzuar për marrje në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve, ishte shpallur fajtor, dhe ishte dënuar me dënim me kusht prej 2 vjet, si dhe me ndëshkime financiare shtesë dhe masa të sigurisë.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e Qarkut kishte çmuar në mënyrë të duhur rëndësinë e të gjitha rrethanave rënduese siç parashihet me nenin 66 dhe kishte zbatuar drejtë nenin 42 të KPPK-së. Gjykata Supreme ka vendosur se mos llogaritja e kohës së kaluar në paraburgim ishte shkelje e nenit 415 (1) 1) dhe nenit 404 (1) 6) të KPPK-së. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e prokurorit të qarkut është pjesërisht e bazuar.*

Ap.nr.352/2004

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Riza Loci, kryetar, Agim Krasniqi dhe mr.sc. Fejzullah Hasani, anëtarë, me bashkëpunëtoreshen profesionale Drita Rexhaj, procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarit I. K., nga fshati Krushicë komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), duke vendosur sipas ankesës të Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren P.nr.88/2004 datë 31.05.2004, në seancën e mbajtur konform dispozitës së nenit 410 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), më datën 14.12.2004, mori këtë

## A K T G J Y K I M

Me rastin e ankesës të Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren e sipas detyrës zyrtare, aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren P.nr.88/2004 datë 31.05.2004, ndryshohet vetëm përkritazi me vendimin për dënimin, ashtu që Gjykata Supreme të akuzuarit I. K., në dënimin e vërtetuar në kohëzgjatje prej

12(dymbëdhjetë) muajsh ia llogarit kohën e kaluar në paraburgim prej datës ..... deri më datën 31.05.2004.

Ndërsa, ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren refuzohet si e pabazuar.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren P.nr.88/2004 datë 31.05.2004, i akuzuari I. K. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 par.2 të KPPK dhe i është shqiptuar dënim me kusht, me ç'rast i është caktuar dënim me burg në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 2 (dy) vjetësh, nëse brenda këtij afati i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale. Kundër të akuzuarit është shqiptuar masa e sigurisë marrja e pushkës automatike me nr.serik 90345155 dhe 175 fishekë të kal. 7.62 mm, një granatë dore e tipit F-1 e prodhimit jugosllav, si mjete të kryerjes së veprës penale. I akuzuari është obliguar që t'i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës sipas llogarisë së Gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 50 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur Prokurori Publik i Qarkut në Prizren, për shkak të vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të dënohet me burg efektiv.

Mbrojtësi i të akuzuarit avokati Adem Jetishi, nga Prizreni, ka parashtuar përgjigje në ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren, ku propozon që ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata Supreme e caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në kuptim të nenit 410 të Kodit të KPPK, ku i akuzuari dha ca sqarime lidhur me thëniet e parashtresës së mbrojtësit të tij dhe në tërësi akceptoi thëniet e parashtuara në përgjigjen në ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren nga ana e mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit i njoftuar me rregull për seancë nuk ishte prezent, sikurse edhe Prokurori Publik i Kosovës, i cili me parashtresën e tij PPA.nr.352/2004 datë 04.08.2004, ka propozuar që ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren P.nr.88/2004 datë 31.05.2004, të pranohet si e bazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet përkritazi me vendimin për dënimin, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim me burg efektiv.

Gjykata Supreme i shqyrtoi shkresat e lëndës, studioi aktgjykimin e ankimuar dhe në kuptim të nenit 415 par.1 të KPPPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe thënieve në përgjigjen e ankesës, gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar.

Aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 415 par.1 pika 1 deri në 3 të KPPPK, në të cilat kjo Gjykatë kujdeset detyrimisht.

Duke vepruar sipas detyrës zyrtare e me rastin e ankesës së paraqitur, Gjykata Supreme konstaton se me rastin e shqiptimit të dënimit është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit, sepse me rastin e vërtetimit të dënimit të akuzuarit nuk i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim e në bazë të nenit 415 par.1 pika 4 lidhur me nenin 404 par.1 pika 6 të KPPPK. Prandaj, në këtë drejtim kjo Gjykatë të akuzuarit ia llogarit kohën e kaluar në paraburgim prej datës ..... deri më datën 31.05.2004.

Duke e vlerësuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin për dënimin, kjo Gjykatë konstaton se rrethanat e paraqitura dhe drejt të vlerësuar në kuptim të dispozitës së nenit 66 të KPPK, i pranon edhe kjo Gjykatë si të drejta sepse drejt është konstatuar se në veprimet e të akuzuarit nuk ekzistojnë rrethana rënduese, por përkundrazi me rastin e shqiptimit të dënimit në favor të akuzuarit nuk është marrë rrethanae posaçërisht lehtësuese se vetë i akuzuari e ka ftuar policinë dhe ua ka dorëzuar armët, rrethanë kjo që rezulton nga mbrojtja e të akuzuarit dhe nga shkresat e lëndës. Prandaj, dënimi i shqiptuar me kusht është në përputhje me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit. Për këto arsye kjo Gjykatë është e bindur se me një dënim të tillë kushtëzuar pritet të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 42 të KPPPK.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e në bazë të nenit 426 të KPPPK.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Ap.nr.352/2004, datë 14.12.2004

Procesmbajtësja,  
Drita Rexhaj

Kryetari i Kolegjit - gjyqtari  
Riza Loci

Anëtarët e kolegjit gjyqtarët:

Agim Krasniqi  
Mr.sc.Fejzullah Hasani

**[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Kodin Penal - neni 328 (2) KPPK mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve - ankesat për ndryshimin e dënimit - rrethanat lehtësuese në caktimin e dënimit - nenet 66, 42 KPPK]**

*Prokurori Publik i Kosovës paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, duke bërë pretendimin ankimor se dënimi i Gjykatës së Qarkut ishte tejet i butë dhe propozoi që Gjykata të shqiptoi dënim efektiv me burg.*

*I pandehuri ishte akuzuar për marrje në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve, ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me dënim me kusht prej 10 muaj burg, si dhe me ndëshkime financiare shtesë dhe masa të sigurisë.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e Qarkut kishte çmuar në mënyrë të duhur rëndësinë e të gjitha rrethanave rënduese siç parashihet me nenin 66 dhe kishte zbatuar drejtë nenin 42 të KPPK-së me qëllimin e vet qortues. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e prokurorit të qarkut është e pabazuar.*

Ap.nr.401/2004

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Riza Loci, kryetar, Agim Krasniqi dhe mr.sc. Fejzullah Hasani, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesionale Drita Rexhaj, procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarit H. R., nga Prizreni, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), duke vendosur sipas ankesës të Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren, paraqitur kundër aktgjykimin të Gjykatës së Qarkut në Prizren P.nr.87/2004 datë 12.07.2004, në seancën e mbajtur më datën 14.12.2004, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren, kurse aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren P.nr.87/2004 datë 12.07.2004, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, i akuzuari H. R. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 par.2 të KPPK dhe i është shqiptuar dënimi me kusht, me ç'rast i është caktuar dënimi me burg në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajsh, i cili nuk do të ekzekutohet në afat prej 2 (dy) vjetësh, po qe se i akuzuari brenda këtij afati nuk kryen vepër tjetër penale. Kundër të akuzuarit është shqiptuar masa e sigurisë marrja e armëve: pushkës automatike "AK-47" me nr.serik 073232-89,97 plumba të kal. 7.65 mm dhe një bajonetë. I akuzuari është obliguar që t'i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së Gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 50 € të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur Prokurori Publik i Kosovës, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet përkritazi me vendimin për dënimin dhe i akuzuari, për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor të dënohet me burg efektiv.

Në ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren, mbrojtësi i të akuzuarit avokati Iljaz Kadolli ka paraqitur përgjigjen në ankesë, me propozim që ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren, të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata Supreme e caktoi seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 410 të Kodit të KPPPK, ku nuk ishin prezent i akuzuari dhe mbrojtësi i tij të cilët kanë qenë të njoftuar me rregull, sikurse dhe Prokurori Publik i Kosovës i cili me parashtrësën e vet PPA.nr.400/2004 datë 31.08.2004, ka propozuar që ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren, të pranohet si e bazuar, dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet përkritazi me vendimin për dënimin dhe i akuzuari H. R., për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor të gjykohej me burg efektiv.

Gjykata Supreme i shqyrtoi shkresat e lëndës studioi aktgjykimin e ankimuar dhe në kuptim të nenit 415 par.1 të KPPPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe thënieve në përgjigjen e ankesës, gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar.

Aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe të ligjit penal nga neni 415 par.1 KPPPK, në të cilat kjo Gjykatë kujdeset detyrimisht.

Duke e vlerësuar aktgjykimin e ankimuar përkritazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Shkallës së parë i ka trajtuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe drejt i ka vlerësuar ato konform dispozitës së nenit 66 të KPPK, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sidomos duke pasur parasysh

rrethanën se i akuzuari e ka pranuar veprën penale, gjendjen e tij ekonomike se është i varfër, gjendjen e tij familjare se është baba i 5 fëmijëve e ushqyes i vetëm i familjes, pendimin e tij të thellë se kurrë më nuk do të bie ndesh me normat pozitive, se edhe kjo Gjykatë konstaton se në anën e të akuzuarit nuk ekzistojnë rrethana rënduese, sepse këto armë i kanë mbetë në pojtë ku i mbanë dhent, dhe pa kurrfarë hezitimi të njëjtat i ka dorëzuar pjesëtarëve të KFOR-it. Prandaj, dënimi i shqiptuar me kusht, me ç'rast i është caktuar dënimi me burg prej 10 (dhjetë) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 2 (dy) vjetësh, po qe se i akuzuari brenda këtij afati nuk kryen vepër tjetër penale, është në përputhje me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të të akuzuarit dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij, duke patur parasysh edhe sjelljen e tij të mëparshme se gjer më tani nuk ka ra në konflikt me ligjin. Edhe kjo Gjykatë është e bindur se me këtë dënim të kushtëzuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 42 të KPPPK.

Përgjigja e mbrojtësit të të akuzuarit në ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren u shqyrta nga kjo Gjykatë, e cila nuk kishte ndikim në vendimmarrje.

Nga sa u tha më lartë u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 423 të KPPPK.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË  
Ap.nr.401/2004, datë 14.12.2004

Procesmbajtësjja,  
Drita Rexhaj

Kryetari i Kolegjit - gjyqtari

Riza Loci

Anëtarët e kolegjit gjyqtarët:

Agim Krasniqi  
Mr.sc.Fejzullah Hasani

**[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Kodin Penal - neni 328 (2) KPPK mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paaautorizuar të armëve - ankesa për ndryshimin e dënimit - rrethanat lehtësuese në caktimin e dënimit - neni 41 e LPJ, neni 34 KPPK]**

*Prokurori i Qarkut në Prishtinë paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, duke bërë pretendimin ankimor se dënimi i Gjykatës së Qarkut ishte tejte i butë dhe propozoi të shqiptoi një dënim më të rëndë.*

*I pandehuri ishte akuzuar për marrje në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të paaautorizuar të armëve, ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me gjobë prej 400 € si dhe me ndëshkime financiare shitesë dhe masa të sigurisë.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e Qarkut kishte tejçmuar rrethanat lehtësuese. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e prokurorit të qarkut është pjesërisht e bazuar.*

Ap.nr.464/2004

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Agim Krasniqi, kryetar, Avdi Dinaj dhe Riza Loci, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Drita Rexhaj, procesmbajtëse, në çështjen penale të të akuzuarit B. S., nga fshati Rimanishtë, komuna e Prishtinës, për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paaautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPPK, lidhur me ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut Prishtinë dhe përgjigjenn ndaj ankesës të mbrojtësit të të akuzuarit, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prishtinë P.nr.269/2004 datë 20 gusht 2004, në seancën e kolegjit të mbajtur në pajtim me dispozitën e nenit 410 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK), më 8.2.2005, mori këtë

**A K T G J Y K I M**

Me aprovimin e ankesës së Prokurorit Publik të Qarkut Prishtinë, aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prishtinë P.nr.269/2004 datë 20 gusht 2004, ndryshohet përkritazi me vendimin për sanksionin penal, ashtu që Gjykata Supreme të akuzuarin B. S., për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, e gjykon me dënim në të holla në shumën prej 1.000 €, të cilën është i detyruar ta paguajë në afat prej 15 ditësh e në rast mospagese, ky do t'i shndërrohet në

dënim burgu, ashtu që çdo ditë e filluar do t'i llogaritet në shumën prej 15 €.

**A r s y e t i m i**

Gjykata e Qarkut Prishtinë me aktgjykimin P.nr.269/2004 datë 20 gusht 2004, të akuzuarin Bislam Sylja e ka shpallur fajtor për veprën penale mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paaautorizuar të armëve, parashikuar nga neni 328 par.2 të KPPK dhe e ka gjykuar me dënim në të holla në shumën prej 400 €, të cilat është i detyruar t'i paguajë në afat prej 15 ditësh e në rast mospagese, ky dënim do t'i shndërrohet në dënim burgu, ashtu që çdo 15 € e filluar do t'i llogaritet në një ditë burgimi. E ka obliguar t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së Gjykatës dhe 50 euro në emër të shumës paushalle.

Ndaj të akuzuarit është shqiptuar masa e sigurisë, marrja e një pushke automatike AK 47 me nr.serik 030172 të kal. 7.62 mm dhe 40 fishekë, si mjete të kryerjes së veprës penale.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka paraqitur Prokurori Publik i Qarkut Prishtinë, vetëm përkritazi me vendimin për dënimin, me propozim që kjo Gjykatë aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë ashtu që të akuzuarit, për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, t'i shqiptojë një sanksion më të lartë.

Mbrojtësi i të akuzuarit, avokati Ramiz Krasniqi, në përgjigjen ndaj ankesës së Prokurorit Publik të Qarkut ka propozuar që ajo të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata Supreme seancën e mbajti konform dispozitës së nenit 410 të KPPPK, me të cilën i akuzuari, ngeli pranë propozimve të bëra në përgjigjen në ankesë, ndërsa, mbrojtësi i të akuzuarit av. Ramiz Krasniqi dhe Prokurori Publik i Kosovës edhe pse të njoftuar me rregull për datën e mbajtjes së seancës nuk morën pjesë në te, por ai, me propozimin me shkrim PPA.nr. 463/2004 datë 22 tetor 2004, ka propozuar që ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut të aprovohet si e bazuar.

Gjykata Supreme i shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e ankimuar konform dispozitë së nenit 415 të KPPPK dhe, pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë, kjo Gjykatë e Shqyrtoi atë edhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 376 të LPP dhe gjeti se nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin prishjen e tij. Po ashtu, as gjendja faktike e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë nuk kontestohet, prandaj kjo nuk ka qenë objekt shqyrtimi nga ana e kësaj Gjykate.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për sanksionin penal, Gjykata Supreme gjen se ankesa e paraqitur është e bazuar. Si rrethana lehtësuese, të cilat Gjykata e Shkallës së Parë ia ka njohur të akuzuarit, kanë qenë: mosha e re, se ai më parë nuk ka qenë i gjykuar, sjelljet korekte para Gjykatës, ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, Gjykata e Shkallës së Parë i ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese dhe ka shqiptuar një sanksion penal që nuk është në përpjestim me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si ekzekutor, duke pasur parasysh se tek i akuzuari është gjetur arma dhe municioni të cilat fare nuk u lejohen qytetarëve, gjë që paraqetn rrezikshmëri të lartë shoqërore.

Prandaj, duke i pasur parasysh këto rrethana, kjo Gjykatë të akuzuarit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i parashikuar me dispozitat e nenit 34 të KPPK.

Nga sa u tha më lart e në pajtim me dispozitën e nenit 426 të KPPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË  
Ap.nr.464/2004, datë 8.2.2005

Procesmbajtësja,

Drita Rexhaj

Anëtarët e kolegjit

1) Avdi Dinaj

2) Riza Loci

Kryetari i kolegjit,

Agim Krasniqi

176

bosh